



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Dibër

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar dhe i Përputhshmërisë

të ushtruar në

BASHKINË DIBËR

Tiranë, Shkurt 2024

PËRMBAJTJA

SHKURTIME.....	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	9
II. HYRJE.....	12
1. Objekti i Auditimit.....	12
2. Qëllimi i auditimit.....	12
3. Identifikimi i çështjes.....	12
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	12
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	13
6. Kriteret e vlerësimit	13
7. Standardet e auditimit	15
8. Metodot e auditimit	16
9. Dokumentimi i auditimit.....	17
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	19
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Dibër.....	19
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	20
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	20
2.1.2 Auditim mbi Auditin e Brendshëm	25
2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	33
2.3. Vlerësimi mbi raportimin financiar	57
2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	82
2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit ...	125
2.6. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit	131
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	134
A. MASA ORGANIZATIVE	134
B.1. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)	145
B.2 MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.....	149
C. MASA DISIPLINORE.....	150
V. ANEKSET	153

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MEK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Dibër dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230-231 “investime”, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Dibër nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022, etj.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 10 Akte Konstatimi të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i 19 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 17 raste me fond limit 401,806 mijë lekë pa TVSH, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, 21, 77, si dhe neni 39, 74 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).	Pika 2.4.3., faqe 82-125	E lartë	Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.
2	Nga auditimi i 17 procedurave publike për investimet e realizuara për vitin 2022, rezultoi se në 15 raste, procedurat janë kryer pa fonde në dispozicion, ku janë angazhuar për vitin buxhetor më pak se 20% të financimit. Këto veprime, rrisin riskun e rritjes së borxhit të Bashkisë Dibër. Procedurat e prokurimit pa fonde në dispozicion, janë veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).	Pika 2.4.3., faqe 82-125	E lartë	Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të shmangë angazhimet për procedura prokurimi pa fonde në dispozicion, kjo për të shmangur rritjen e borxhit të bashkisë.
3	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, kanë rezultuar në 10 raste vonesa të pa argumentuara të afatit për vlerësimin e ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duke sjell vonesa në lidhjen e kontratës për kryerjen e shërbimit apo punimeve të planifikuara për tu kryer përgjatë vitit 2022. Vonesa për vlerësimin e ofertave, është veprim në kundërshtim me nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.	Pika 2.4.3., faqe 82-125	E lartë	Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, të marrin masa për shmangien dhe mos përsëritjen e vonesave të paargumentuara në fazën e vlerësimit të ofertave, duke eliminuar tejkalimin e afateve ligjore në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.
4	Nga auditimi i 19 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022 – 31.12.2022, me vlerë totale të lidhjes së kontratave prej 297,242 mijë lekë , kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së të gjitha kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Kualifikimi në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta, është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2	Pika 2.4.3., faqe 82-125	E lartë	Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<i>"Qëllimi", neni 3 "Parimet të përgjithshme", neni 87 "Kriteret për shpalljen e ofertës fituese" pika 3, ", Neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", Neni 98, "Anulimi i një procedure prokurimi".</i>			që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.
5	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik me objekt <i>"Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton i lagjes Kallavere Peshkopi, Bashkia Dibër 2022", "Rikonstruksion shkolla 9 – vjeçare "Irfan Hajrullai" Peshkopi, Bashkia Dibër 2022"</i> dhe <i>"Sistemim asfaltim i rrugës së Lagjes Llixha, Bashkia Dibër 2022"</i> , ka rezultuar se KVO ka kualifikuar OE fitues më të cilët është lidhur kontrata në mos përmbushje të kriterëve kualifikuese, ndërkohë ka s'kualifikuar OE me oferta më ulëta ose më të favorshme për arsye të cilat nuk qëndrojnë ose për devijime të vogla të cilat në thelb nuk cenojnë zbatimin e punimeve. Nga vendimmarrjet e gabuara të KVO, AK Bashkia Dibër, ka kryer shpenzime pa ekonomicitet në vlerën 8,291 mijë lekë , veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2 <i>"Qëllimi"</i> , neni 3 <i>"Parimet të përgjithshme"</i> , neni 87 <i>"Kriteret për shpalljen e ofertës fituese"</i> pika 3, ", Neni 92, <i>"Shqyrtimi i ofertave"</i> .	<i>Pika 2.4.3., faqe 82-125</i>	E lartë	Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë vlerësimet e gabuara të kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për personat përgjegjës për shpenzimet pa ekonomicitet në vlerën 8,291 mijë lekë .
6	1. Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin A. A., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim. Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit, duhet të jetë 7,038,360 lekë dhe jo 1,510,836 lekë, sa është llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues. Objekti është për leje 5 kat, nga të cilat kati i parë për aktivitet biznesi dhe 4 katet tjera sipas projektit do ndërtohen 20 apartamente. Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes mbi bazë preventivi dhe taksim 2% dhe 2.5%, në kundërshtim me Ligjin nr. 95/2018, <i>"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"</i> , i ndryshuar, neni 9, pika 2, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes, e cila në paketën fiskale për vitin 2022 është 6% për ambientet për banim dhe 6% për ambientet e dedikuara për biznes. Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 5,527,524 lekë, e pallogaritur, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Dibër. 2. Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin L. S., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim. Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 98,490 lekë dhe jo 24,020 lekë e llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues. Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes, duke zgjedhur vlerën më të vogël sipas preventivit, dhe jo vlerën sipas koston së ndërtimit sipas EKB për m ² , në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 <i>"Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit"</i> i ndryshuar. Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 74,470 lekë, e pallogaritur, e cila përbën të ardhur të paarkëtuar për Bashkinë Dibër. 3. Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin I. S., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim. Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 254,738 lekë dhe jo 176,461 lekë e llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues. Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes, duke zgjedhur vlerën më të vogël sipas koston së ndërtimit sipas EKB për m ² , dhe jo sipas preventivit i cili ka vlerë më të lartë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 <i>"Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit"</i> i ndryshuar.	<i>Pika 2.5., faqe 125-131</i>	E lartë	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Taksave, të marrin masa për nxjerrjen e njoftimit detyrimit ndaj subjekteve zhvillues A. A., L. S., I. S., M. S. dhe V. M., për të bërë të mundur arkëtimin e shumës 5,735,388 lekë si rezultat i përlllogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga të cilat për shtetasin A. A. vlera 5,527,524 lekë , për shtetasin L. S. vlera 74,470 lekë , për shtetasin I. S. vlera 78,277 lekë , për shtetasin M. S. vlera 32,835 lekë , për shtetasin V. M. vlera 22,282 lekë , shuma të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuar për buxhetin e Bashkisë Dibër.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 78,277 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, e cila përbën të ardhur të munguara për Bashkinë Dibër. 4.Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin M. S., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim. Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 179,989 lekë dhe jo 147,154 lekë e llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues. Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes, duke zgjedhur vlerën më të vogël sipas koston së ndërtimit sipas EKB për m², dhe jo sipas preventivit i cili ka vlerë më të lartë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar. Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 32,835 lekë, e pallogaritur, e cila përbën të ardhur të munguara për Bashkinë Dibër. 5.Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin V. M., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim. Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 103,874 lekë dhe jo 81,592 lekë e llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues. Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes, duke zgjedhur vlerën më të vogël sipas preventivit, dhe jo sipas koston së ndërtimit sipas EKB për m², në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar. Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 22,282 lekë, e pallogaritur, e cila përbën të ardhur të munguara për Bashkinë Dibër.			
7	Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 7 raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në <i>e-leje</i>, i kanë miratuar ato në mos përmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin, pasi janë evidentuar mangësi që lidhen me treguesit e distancave ndërmjet ndërtimeve në 1 rast, në 1 rast mungon plani i rilevimit, në 2 raste projekti arkitektonik është i pa plotë, në 1 rast kemi shtesë kati ndërkohë që është trajtuar si ndërtim çatie, në 3 raste mungojnë VNM-të, në 2 raste mungon mendimi i institucioneve, në 1 rast nuk është bërë ndryshimi i statusit të tokës nga arë në truall, në 1 rast mungon harta treguese dhe certifikata për vërtetim pronësie, në 2 raste mungon MNZ, në 1 rast mungon projekti i instalimeve hidrosanitare, elektrike dhe ngrohje ftohjes, në 1 rast mungon deklarata e bashkëpronarit për dhënie dakordësie për zhvillimin e ndërtimit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar Neni 10 pika 1 germa (ç), Neni 10/1 pika 6, Neni 14 pika 1, Neni 15 pika 1 germa (b, e.), pika 1/1 germa (i, iii, iv), Neni 34 pika 2, Neni 37, pika 3.	Pika 2.5., faqe 125-131	E lartë	Nga Bashkia Dibër, të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.
8	Lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezultoi se për vitin 2022 nuk ka paguar asnjë qytetarë me vlerë totale 2,507,750 lekë dhe nga vitet e mëparshme janë debitorë në vlerë totale 10,090,807 lekë, që përbën në total 12,598,557 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër. Ky veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27. Ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c. Ligjin nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”. VKM nr. 860, datë 10.12.2014	Pika 2.2.6., faqe 43-44	E lartë	Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë me Drejtorinë e të ardhurave dhe strukturat të tjera të bashkisë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 12,598,557 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e Bashkisë Dibër të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	“ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5.			kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
9	Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve është në vlerën 5,235,170 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 11,403,160 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër. Gjendja e debitorëve e familjarëve është në vlerën 12,743,314 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 47,713,042 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër. Në total borxhi tatimor në Bashkinë Dibër rezulton në vlerë 59,116,202 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2022, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës subjektet debitorë për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93.	Pika 2.2.6., 44-48	E lartë	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën: 1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 47,713,042 lekë; 2. Biznese Debitorë në vlerë 11,403,160 lekë. a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrë bllokimit e llogarive bankare. b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme). c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar. d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal. e- Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Dibër, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq. f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.
10	Vlera e gjobave nga IMTV për vitin 2022, është 1,230,000 lekë, nga të cilat nuk është paguar vullnetarisht asnjë gjobë. Gjithashtu, nuk janë ndërmarrë masa nga Drejtoria e IMTV për të njoftuar drejtoritë përkatëse që këto gjoba të kontabilizohen, ashtu dhe nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria Ekonomike nuk ka marrë masa për tu kontabilizuar këto gjobat. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5 dhe Ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22 dhe VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kapitulli 1 , pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”.	Pika 2.2.6., faqe 48-49	E lartë	Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 1,230,000 lekë për vitin 2022 . Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.
11	Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse, rezultojnë 17 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 18 pika karburanti), nga të cilat 14 pika kanë licenca me afat më të shkurtër se 5 vjet	Pika 2.2.6., faqe 49-51	E lartë	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	dhe me pagesa pjesore dhe 4 pika kanë licenca 5-vjeçare, 8 subjekte për 9 pika karburanti janë të autorizuar, për vitin 2022 dhe kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore, ndërsa për 9 subjekte janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale progresive 7,200,000 lekë (sipas tabelës II.6.8) e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dibër dhe 3,750,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dibër për vitin 2022. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, Neni 20-Autorizimet pika 2.			paguar detyrimet ndaj Bashkisë Dibër me vlerë 7,200,000 lekë.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilance) të shtetit 2022, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzion për një **“Opinion të modifikuar, me rezerve”**, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundim se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të vitit 2022.
- Në auditimin e përputhshmërisë në fushën e shpenzimeve operative (602), investimeve (231), menaxhimit e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazë testimesh të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Dibrë, bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali materiale por jo të përhapura, që janë baza për dhënien e një **“Opinion të modifikuar”**, pasi
- Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera të larta, rezultuan shkelje të akteve ligjore e nënligjore në aplikim të kriterëve të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara, si dhe shkelje në shpalljen e OE fitues jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK, si dhe vonesa në afatet e përcaktuara për vlerësimin e ofertave nga KVO.
- Në auditimin për lejet e ndërtimit, në 5 raste taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlogaritur gabim, me pasojë të ardhura të munguara në vlerën 5,735,388 lekë.
- Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizikë/juridik dhe abonentët familjarë, leje legalizimi për ndërtim pa leje nuk janë ndjekur procedurat për arkëtimin e debitorëve në vlerën 71,714 mijë lekë.
- Debitor për licencën e tregtimit me pakicë të karburanteve në vlerën totale 7,200,000 lekë, ku detyrimi për vitin 2022 rezulton në vlerën 3,750,000 lekë.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Dibrë për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200¹, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, **shprehim një opinion të modifikuar me rezervë**² për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Dibrë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin e modifikuar.

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

² Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Dibër, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISSAI 1700.7).

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 17,300 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin vlerën e tyre reale, si vijon:

- Llogaria nr.214 *“Instalime teknike, makineri e pajisje”* përmban zëra, që nuk klasifikohen si të tillë dhe klasifikimi i pasaktë ka ndikuar në llogaritjen e amortizimit vjetor, ku për llogaritjen e tij është përdorur norma 5% dhe jo 20%, për pasojë ky grup aktivesh është mbivlerësuar me 2,593,019 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar;

- Llogaria nr.215 *“Mjete transporti”* paraqitet e mbivlerësuar me 6,022,902 lekë;

- Llogaria nr.218 *“Inventar ekonomik”*, paraqitet e mbivlerësuar në shumën 18,590,982 lekë;

- Llogaria nr.231 *“Investime për Aktive Afatgjata materiale”* paraqitet e mbivlerësuar në shumën 196,290,869 lekë.

Gjithashtu, shënimet shpjeguese dhe pasqyrat statistikore nuk janë paraqitur të plota si dhe gjatë vitit 2022 nuk ka pasur proces inventarizimi fizik për aktivet e qëndrueshme, ç’ka sjell vështirësi për testimin e pohimit të ekzistencës për to.

II. Opinion i auditimit të përputhshmërinë.

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Dibër, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Dibër, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Dibër, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinion të modifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin:

Opinionin e dhënë mbi përputhshmërinë e mbështesim në konstatimet e mëposhtme:

- Në 19 procedura prokurimi të audituara, në 17 raste me fond limit **401,806 mijë lekë**, janë konstatuar shkelje në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, pasi nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

- Në 19 procedura prokurimi të audituara nga Bashkia Dibër, ose 100% e kampionit të zgjedhur me vlerë kontrate **291,815 mijë lekë**, OE/BOE e kualifikuar nuk përmbushin kriteret e vendosura.

- Në 3 procedura prokurimi të zhvilluara nga Bashkia Dibër, me vlerë kontrate **75,771 mijë lekë**, OE/BOE e kualifikuar nuk përmbushin kriteret e vendosura, ndërkohë që janë s’kualifikuar ofertat më të ulëta ose më të favorshme në mënyrë të padrejtë, duke shkaktuar shpenzime pa ekonomikitet për buxhetin e Bashkisë Dibër në vlerën **8,291 mijë lekë**.

- Në 10 procedura prokurimi të audituara, rezulton se KVO ka kryer vlerësimin përtej afatit ligjor të përcaktuar në rregullat e LPP.

- Në auditimin për lejet e ndërtimit, në 5 raste taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlllogaritur gabim, me pasojë të ardhura të munguara në vlerën **5,735,388 lekë**.
- Për TNI për objektet në proces legalizimi për vitin 2022, nuk është kryer asnjë pagesë në vlerën 2,507,750 lekë, dhe progresivi me debitorë nga vitet e mëparshme është në vlerën 12,598,557 lekë.
- Debitorët e krijuar ndaj Bashkisë Dibër nga tatimpaguesit privat dhe familjar nga mos pagesa e detyrimeve deri në datën 31.12.2022 ka vlerën 59,116,202 lekë.
- Mos arkëtim i gjobave të IMTV për vitin 2022 në vlerën 1,230,000 lekë.
- Debitor për licencën e tregtimit me pakicë të karburanteve në vlerën totale 7,200,000 lekë, ku detyrimi për vitin 2022 rezulton në vlerën 3,750,000 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Dibër.

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Dibër, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të fushës.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Dibër

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 872/1, datë 10.10.2023 “Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Dibër”, në subjektin Bashkia Dibër nga data. 13.10.2023 deri në datën 20.11.2023, u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë”, për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. Sh. H. - Përgjegjës Grupi;
2. H. M.
3. K. N. dhe
4. E. K., anëtarë.

Titulli: Auditim Financiar dhe Përputhshmërie.

Marrësi: Raporti Përfundimtar i drejtohet subjektit të audituar, Bashkia Dibër.

1. Objekti i Auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Dibër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. R. S., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. M. Sh., Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e

pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rrethimeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Dibër, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;

- VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj;
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”;
- VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në fushën e prokurimeve publike:

- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar;

- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- Ligji Nr. 107-2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

8. Metodat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështetja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

▪ **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese**

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ **Kontrolli i vlerësimeve**

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ **Konfirmimi nga të tretët**

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ **Kontrolli sipas një treguesi**

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

▪ **Intervista**

▪ **Raporte dhe Informacione**

▪ **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e Pyetësorëve dhe Testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;

- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

- **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Dibër

Bashkia Dibër është një institucion i rëndësishëm, i cili funksion në bazë të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjes vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Pas reformës territoriale, kjo njësi vendore përbëhet nga 15 njësi, dhe konkretisht: *Njësia Administrative Peshkopi, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë Cidhën dhe Arras*. Në Bashkinë Dibër numri i popullsisë është 16100 banorë, me 6087 familje. Sipërfaqja e Bashkisë Dibër është 774 km².



Njësiti Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Peshkopi	Qyteti Peshkopi
Tomin	Fshatrat: Tomin, Brezhdan, Cetush, Dohoshisht, Pilafe, Pollozhan, Rrashnapojë, Selane, Ushтеленxë, Bahute, Staravec, Shimçan, Zimur, Zdojan
Melan	Fshatrat: Melan, Cerjan, Rabdisht, Zagrad, Begjunec, Trepçë, Grevë, Ilnicë, Bellovë, Pejke, Pjeçë, Trenë
Kastriot	Fshatrat: Kastriot, Brest i Sipërm, Brest i Poshtëm, Kishavec, Kandër, Kukaj, Vakuf, Fushë-Kastriot, Borovjan, Deshat, Limjan, Sohodoll, Sohodoll i Vogël, Vrenjt, Përgjegje
Lurë	Fshatrat: Fushë-Lurë, Borie-Lurë, Arth, Gurë-Lurë, Lurë e Vjetër, Arrëmollë, Krej-Lurë, Pregj-Lurë, Sumej, Vlashej
Maqellarë	Fshatrat: Maqellarë, Bllatë e Poshtme, Bllatë e Sipërme, Burim, Çernen, Fushë e Vogël, Katund i Vogël, Kërçisht i Sipërm, Kërçisht i Poshtëm, Klobçisht, Kovashicë, Majtarë, Pocest, Pesjak, Podgorc, Vojnik, Dovolani, Erebarë, Grezhdan, Herbel, Popinar, Gradec
Muhurr	Fshatrat: Muhurr, Bulaç, Fushë-Muhurr, Hurdhë-Muhurr, Rreth-Kale, Shqath, Vajmëdhej
Luzni	Fshatrat: Katund i Ri, Hotesht, Lishan i Poshtëm, Lishan i Sipërm, Arap i Sipërm, Arap i Poshtëm
Selishtë	Fshatrat: Selishtë, Kacni, Lukan, Murrë, Qafë-Murrë, Selishtë e Sipërme
Sllovë	Fshatrat: Sllovë, Kallë, Vleshë, Zall-Kalis, Dypjakë, Palaman, Sllatinë, Shumbat, Venisht, Trojak
Kala e Dodës	Fshatrat: Ceren, Kullas, Ploshtan, Radomirë, Shullan, Tejzë, Ujëmirë, Vasie
Zall-Dardhë	Fshatrat: Zall-Dardhë, Lashkizë, Lugjej, Menesh, Nezhaj, Qa, Soricë, Shënllëshën, Tartaj
Zall-Reç	Fshatrat: Zall-Reç, Bardhaj-Reç, Draj-Reç, Gur-Reç, Hurdhë-Reç, Kraj-Reç, Ndërshenë, Qafdraj, Tharkë
Fushë Cidhën	Fshatrat: Fushë Cidhën, Bllaçë, Laçe, Rrenz
Arras	Fshatrat: Arras, Gur i Zi, Lazrej, Kodër Leshaj, Mustafe, Sinë e Sipërme, Sinë e Poshtme, Cidhën, Grykë Nokë

Kuadri ligjor:

Bashkia Dibër e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuar në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.

Kryetar i Bashkisë Dibër është z. R. S..

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

III. 2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Plani Vjetor i Punës;
- Harta e proceseve të punës;
- Strategjia e Riskut për periudhën 2022;
- Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Pyetësori i vetëvlerësimit të Bashkisë Dibër;
- Plani i Kontrollit të Brendshëm;
- Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;
- Plani i Veprimit për arritjen e objektivave;
- Regjistri i riskut për periudhën 2022;
- Urdhër i brendshëm për krijimin e grupeve të GMS;
- Vendime të Grupit të Menaxhimit Strategjik etj.

Titulli i gjetjes: Në Bashkinë Dibër, për periudhën objekt auditimi, mungon dokumentacioni shkresor që pasqyron minutat e takimit dhe marrjen e vendimeve për mbledhjet që realizon GMS dhe si rrjedhojë e kësaj nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm.

Situata:

1. Mbi mjedisin e kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Me Urdhër nr. 169, datë 30.03.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Rregullores së Bashkisë Dibër për vitin 2022” është vendosur afati për hartimin e rregullores deri në datë 01.04.2022. Bashkia Dibër funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, me Vendim nr. 101, datë 21.04.2022, Është miratuar Kodi i Etikës, ku janë përcaktuar dhe rregullat mbi etikën. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi, komunikimi mbi rregulloren e brendshme është kryer verbalisht.

për miratimin e rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Dibër”. Grupi i punës ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi është Zëvendëskryetarët, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoritë, Sektorët Përkatës dhe Administratorët pranë Njësive Administrative. Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për sa i përket pjesës për Rregulloren e Brendshme të Njesisë Publike, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetet në legjislacionin përkatës, duke përmbajtur disa nga elementët thelbësore, që çdo rregullore

duhet të ketë.

Kodi i Etikës

Bashkia Dibër funksionon bazuar në Kodin e Etikës, Vendim Nr. 383, datë 15.07.2020, nr. 383 prot., datë 15.07.2020 që është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Dibër. Kodi është i bazuar në legjislacionin përkatës, në të cilin është mbështetur Njësia Publike për hartimin dhe përpilimin e tij.

Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:

Për vitin 2022, numri i punonjësve në Bashkinë Dibër, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2022, Vendim Nr. 64, datë 24.12.2021, “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe të Njësive për vitin 2022”, ka qenë si vijon:

1. Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Dibër me ndryshime nga projekto o sjellë nga Bashkia (*Projekt Vendim nr. 01, datë 11.11.2021 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe të Njësive për vitin 2022”*) me numër 466 të punonjësve duke shtuar 20 punonjës;
- 1.1 Në administratë numri i punonjësve të jetë 486 punonjës;
- 1.2 Në institucionet në varësi të Bashkisë Dibër numri i punonjësve të jetë 74 punonjës;
- 1.3 Funksionet e deleguara;
 - a) Arsimi – 209 punonjës;
 - b) Shërbimi pyjor – 10 punonjës;
 - c) Ujitja dhe Kullimi – 4 punonjës;
 - d) MNZSH – 21 punonjës;
 - e) Gjendja Civile në Njësitë Administrative dhe Bashki 14 punonjës;
 - f) QKB – 2 punonjës, në totale 260 punonjës;
- 1.4 Punonjës me kontratë pune të përkohshme mujore (4-8 mujore) për punë sezonale sipas nevojave të institucionit të jenë 10 punonjës.

Në total numri i punonjësve për vitin 2022, **830 punonjës**.

Me VKB nr. 14, datë 08.04.2022, “Për një shtesë në VKB nr. 64, datë 24.12.2021, “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe të Njësive për vitin 2022”, është miratuar shtesa e 20 punonjësve me kontratë pune të përkohshme 8 mujore për punë sezonale, dhe relacioni bashkëlidhur. Referuar shkresës nr. 14 prot., datë 18.01.2022, Vendim nr. 14, datë 18.01.2022 për pozicionet e punës trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, në muajin janar 2022 janë 92 punonjës me status, 706 punonjës me kontratë pune, 10 punonjës sezonal dhe 12 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm është 820. Ndërsa në dhjetor 2022 janë 104 punonjës me status, 712 punonjës me kontratë pune, 60 punonjës sezonal dhe 4 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm është 880.

Nr.	Viti 2022	Nëpunës Civil	Kontratë Pune	Nr. Përgjithshëm	Vakanca	Punonjës sezonal
1.	Janar 2022	92	706	820	12	10
2.	Dhjetor 2022	104	712	880	4	60

Nga auditimi konstatohet se, në këto raste të ndryshimeve të emërtimeve të drejtuesve sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” Kreu III, pika 27 dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, Kreu VII, pika 49, 52, 52. Në Bashkinë Dibër Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar dhe miratuar një program

trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka të planifikuara fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve për vitin 2022.

2. Mbi menaxhimin e riskut

Regjistri i Riskut, viti 2022

- Nga Bashkia Dibër përcaktohen objektiva sasiore (në vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, u konstatua se nga Bashkia Dibër nuk ka plane operationale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (me afat 5 vjeçar) të Bashkisë Dibër, sipas përcaktimit në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

- Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

- Në Bashkinë Dibër, ka pasur një strukturë të miratuar dhe një koordinator të riskut miratuar me Urdhrin nr. 7, datë 07.01.2022, është caktimin e koordinorit të menaxhimit Financiar e Kontrollit të Riskut të Bashkisë Dibër për vitin 2022, zj. U. K. (Pozicioni i punës Sekretare e Përgjithshme).

- Në Bashkinë Dibër nuk është krijuar regjistri i riskut.

- Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut, ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe të vendoset kuadri i përgjithshëm i procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie, e cila përgatitet nga NA, duhet të miratohet nga titullari i njësisë, duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel ose Word.

- Në Bashkinë Dibër, edhe Drejtoria Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes së të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Ekonomike dhe hartimi i Pasqyrave Financiare, gjithashtu edhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe me Agjentët Tatimorë.

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit, në kundërshtim me parimin nr. 8, si dhe nuk ka një sistem efikas të kontrollit të brendshëm.

3. Mbi veprimtaritë e kontrollit

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Referuar Urdhrit nr. 8, datë 07.01.2022, “Ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Dibër për vitin 2022”, ndryshuar me Urdhrin nr. 8/1, datë 06.04.2022, GMS është e përbërë nga 19 anëtarë.

Referuar Urdhrit nr. 7, datë 07.01.2022, është caktimin e koordinorit të menaxhimit Financiar e Kontrollit të Riskut të Bashkisë Dibër për vitin 2022, zj. U. K. (Pozicioni i punës Sekretare e Përgjithshme).

Vendime të GMS

Në Bashkinë Dibër **nuk janë të dokumentuara në formë shkresore minutat e takimit për**

mbledhjet që ka kryer GMS për vitin 2022. Nisur nga ky fenomen, vihet re mos përgatitja e disa dokumenteve si plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm, të cilat janë rezultat i mbledhjeve që duhet të realizojë GMS dhe vendimeve që merren në to.

Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 27, pika 1, ku cilësohet se:

Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë së sektorit publik

1. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik.

Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

Deklarata e Cilësisë për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm, viti 2022

Deklarata e Cilësisë për vitin 2022 në Bashkinë Dibër, është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE me shkresën nr. 852 prot., datë 28.02.2023.

Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, viti 2022

Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për Bashkinë Dibër, është hartuar dhe miratuar sipas formatit standard të manualit MFK.

Përgjithësisht pyetësori është realizuar duke u mbështetur në manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe ligjin Nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Vlerësimi i riskut është bërë sipas katër seksioneve, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi, monitorimi. Në çdo seksion janë analizuar parimet në të cilat mbështetet njësia publike, duke dhënë edhe përgjigjet e arsyetuara për secilën prej tyre. Disa nga parimet janë angazhimi për integritet dhe vlerat etike; Titullari/Nëpunësi Autorizues demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje; Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë; Njësia Publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave; Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale; Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve lidhur me këto objektiva; Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave; Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime; Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm; Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli; Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë; Njësia Publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave; Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor; Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm; Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm; dhe Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, viti 2022

Për vitin 2022, është hartuar dhe përpiluar sipas manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit, bazuar në Neni 18, Ligji Nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. referuar shkresës nr. 852 prot., datë 28.02.2023. Është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE dhe përmban rubrikat si përmbledhja ekzekutive, baza ligjore, organizimi i sistemeve të MFK-së, prioritetet dhe rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Vihet re se mungojnë rubrikat, gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e

sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen.

Harta e Proceseve të Punës

Drejtoria e Ekonomisë në Bashkinë Dibër për vitin 2022 nuk ka hartuar hartën e proceseve të punës, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

Plani për Kontrollin e Brendshëm për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Dibër.

Ky veprim është në kundërshtim me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.3, ku cilësohet se:

Plani i Kontrollit të Brendshëm është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

Plani i Veprimit për arritjen e objektivave për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Dibër.

Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 8, pika a, ku cilësohet se:

Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

Gjurma standarde e Auditit për prokurimet me vlerë nën 1.000.000 lekë pa TVSH dhe mbi 1.000.000 lekë pa TVSH në Bashkinë Dibër nuk është hartuar gjurma e auditit për prokurimet me vlerë nën 1.000.000 lekë pa TVSH dhe mbi 1.000.000 lekë pa TVSH, veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16; Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, pika 3.3. Aktivitetet e Kontrollit, Hapi “Gjurmët e auditimit”.

4. Informacioni dhe komunikimi

Mjetet e komunikimit në Bashkinë Dibër dhe subjektet në varësi janë shkresat dhe email-et. Në aspektin organizativ dhe funksional çdo drejtori raporton te Kryetari dhe Nënkryetari i Bashkisë Dibër. Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Dibër, ka të specifikuar në nenin 21, për mënyrën e realizmit të komunikimit të brendshëm në Bashkinë Dibër, ku theksohet se komunikimi zyrtar realizohet nëpërmjet sistemit elektronik (internetit). Komunikimi dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve zyrtare brenda Bashkisë bëhet gjithmonë duke përdorur postën elektronike (e-mail) dhe dërgesa në institucionet e tjera bëhet me shërbim postar. Çfarë evidentohet nga praktika, punonjësit përdorin më tepër postën elektronike personale, ndërkohë që duhet bërë e mundur që të mund të përdorin postën elektronike të Bashkisë për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale. Bashkia Dibër garanton për publikun transparencën e veprimtarisë së saj, ku çdo akt i Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të internetit (web-it) dhe afishohet në vendet e caktuara nga Bashkia për njoftimet publike.

5. Monitorimi

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse. Një formë e monitorimit, është pyetësori i vetëvlerësimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 8, pika 8 a) dhe Neni 27, pika 1, gjithashtu dhe Manuali i Menaxhimit

Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Ndikimi: Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të diskutimit të çështjeve kryesore dhe mangësive serioze që dalin brenda njësisë dhe i parashtrihen Grupit të Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave. Si pasojë e kësaj vihet re edhe neglizhenca për të mos hartuar Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm duke përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të cilat ndihmojnë për të dhënë siguri të arsyeshme, lidhur me risqet që kufizohen brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Gjithashtu nuk është hartuar dhe plani i veprimit për arritjen e objektivave, i cili ndihmon në krijimin e një pamje më të qartë të çështjeve të njësisë publike dhe organizimin e punës në mënyrë të tillë që objektivat e paracaktuara të arrihen brenda një afati kohor specifik.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe manualit për MFK.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e regjistrit të rriskut të secilës strukturë dhe të të gjithë institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit.

Nga Titullari i njësisë vendore të hartohen rregulla të shkruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përkatëse të kësaj njësie gjatë marrjen dhe dorëzimin e detyrës nga punonjësit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Sh. M., ish Kryetar i Bashkisë Dibër;
2. Z. R. S., Kryetar i Bashkisë Dibër;
3. Zj. U. K., në cilësinë e koordinatorit të menaxhimit Financiar e Kontrollit të Riskut;
4. Zj. M. L., Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

III. 2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.

Auditimi i pikës 1 të programit të auditimit nr.872/1, datë 10.10.2023, u krye në bazë të legjislacionit dhe dokumentacionit sa më poshtë:

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet auditimi:

- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e Sigurimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Dokumentacioni i shqyrtuar:

- Struktura dhe organizimi i Njësisë së Auditit;
- Plani vjetor dhe strategjik i auditit të brendshëm;
- Raporti i auditit të brendshëm për vitin 2022;
- Dokumentacione në lidhje me trajnimet e vijueshme të bëra nga NJAB;
- Dosjet fizike të misionëve të auditimit të realizuara përgjatë vitit 2022;
- Dokumentacione të tjera mbështetëse.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi si më poshtë:

1. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për drejtimin me qëllim të përmirësimit të veprimtarisë së njësisë publike dhe të arritjes së objektivave. Njësitë e Auditimit të Brendshëm (NJAB), sipas pikës b të nenit 3 të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015, të ndryshuar “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, duhet të krijohen në institucione, që shpenzojnë fonde publike. Nga shqyrtimi i dokumentacioneve, të vëna në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se, në Bashkinë Dibër është krijuar NJAB me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 64, datë 24.12.2021 dhe forma e organizimit të saj është sektor, formë kjo e parashikuar në pikën 2, të VKM-së nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar. Për auditimin e organizimit të NJAB-së, grupi i auditimit shqyrtoi së pari strukturën e NJAB-së në Bashkinë Dibër, ku rezultoi si më poshtë:

Tabela nr. 1 “Struktura e NJAB-së përgjatë vitit 2022”

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi Bazë	Niveli i Diplomës	Vite pune gjithsej	Vitet e punës në DAB	Certifikimi	Trajnime nga NJQAB
1	E. M.	Përgjegjës	Ekonomik	Master Profesional	5	2	Në proces	PO
2	H. D.	Specialist	Ekonomik	Master Profesional	7	4	Në proces	PO
3	E. D.	Specialist	Ekonomik	Bachelor	1	1	Jo	JO

Burimi: NJAB në Bashkinë Dibër, përpunuar nga grupi i auditimit.

- Nga tabela më sipër rezulton, se gjatë vitit 2022 NJAB e Bashkisë Dibër është plotësuar me 3 (tre) anëtarë, të cilët kanë si fushë të studimit në shkencat ekonomike, kjo ne përputhje me pikën a, të nenit 11 të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;

Titulli i Gjetjes: Mangësi në organizimin e Njësies së Auditimit.

Situata: Nga verifikimi i organizimit të Njësies së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në Bashkinë Dibër rezultoi se:

- Prej muajit shkurt të vitit 2022 struktura është plotësuar me 3 (tre) anëtarë, të cilët përgjatë vitit 2022 kanë qenë të pa certifikuar, në kundërshtim me pikën 3 VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
- Një prej anëtarëve të NJAB-së (E. D.) është rekrutuar në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të posaçme, për të qenë anëtar i NJAB-së, pasi nuk zotëron diplomë universitare të nivelit të dytë, në kundërshtim me pikën 2 a të nenit 11 të ligjit nr.114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, si dhe nuk ka pasur eksperiencën e nevojshme prej 3 vite, por vetëm 1 vit, në kundërshtim me pikën 2 ç , të nenit 11, të Ligjit nr.114/2015.
- Drejtuesi i NJAB-së, nuk ka pasur pesë vite përvojë pune në momentin e emërimit si Drejtues i NJAB-së dhe nuk është certifikuar përgjatë vitit 2022, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2b, të nenit 11, të Ligjit nr. 114/2015.
- Dy nga tre punonjësit e NJAB-së, për vitin 2022 kanë kryer trajnimet e vijueshme për 40 orë/vit, ndërsa një anëtar i NJAB-së, znj. E. D. nuk ka realizuar asnjë orë trajnimi, në kundërshtim me nenin 5 të “Rregullores së trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, të miratuar me Urdhrin nr. 3, datë 08.01.2016.

Kriteri: Pika 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar; Pikat 2a, 2b, 2ç të nenit 11 të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, ku përcaktohet.

Neni 5 i “Rregullores së trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, të miratuar me Urdhrin nr. 3, datë 08.01.2016.

Ndikimi: Mungesa në strukturën organizative të kësaj drejtorie sjell pasoja në performancën e Bashkisë Dibër, duke rrezikuar përmbushjen të objektivave të përcaktuara.

Shkaku: Struktura e paplotë e NJAB-së e paplotë dhe anëtarë të NJAB-së që nuk përmbushin kriteret ligjore për të qenë pjesë e saj.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që struktura e e njësisë së auditit të brendshëm të plotësohet me punonjës, të cilët përmbushin të gjitha kriteret e pasaçme për punësimin si auditues i brendshëm.

Karta e Auditimit është hartuar nga Drejtuesi i Njësisë së Auditit të Brendshëm dhe miratuar te titullari i Bashkisë Dibër me anë të shkresës me nr. 186 prot., datë 01.10.2018 dhe ne vijim nuk është përditësuar. Nga verifikimi i përmbajtjes së kartës së auditimit, rezultoi se ajo është hartuar sipas, formatit të miratuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me UMFE nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm”, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016;

2. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

1.Përgatitja e Planit Strategjik 2023-2024 dhe të planit vjetor të vitit 2023.

Përgatitja e planit vjetor dhe strategjik të auditimit, është një nga detyrat e përcaktuara në pikën c të nenit 7, të Ligjit nr.114/2015, të ndryshuar, që duhet të kryejë drejtuesi i NJAB-së. Për periudhën objekt auditimi, Drejtuesi i NJAB-se të Bashkisë Dibër ka hartuar planin strategjik për vitin 2023-2025 dhe planin vjetor 2023, të cilët janë dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (DHAB), pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës nr. 4459/1, datë 14.10.2022, të Kryetarit të Bashkisë Dibër Z. R. S.. Dërgimi i planeve pranë strukturës përgjegjëse të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave është bërë brenda afatit të parashikuar në kapitullin 3.2 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me UMFE nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”, ku përcaktohet se: “Plani vjetor i dërgohet zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda datës **20 Tetor** të çdo viti”.

Nga verifikimi i bërë planit vjetor për virin 2022 dhe planit strategjik për vitin 2023-2025 rezultoi se ato janë në përputhje me Formatet Standard, të Kapitullit III, të Manualit i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar.

2.Plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të NJAB-së.

Në funksion të vlerësimit të brendshëm të cilësisë nga NJAB e Bashkisë Dibër ka plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit, në përputhje me pika 7.1.1. të Kapitullit VII, “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm”, të Manualit i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar. Pyetësori i vetëvlerësimit (Aneksi 3 “Pyetësori i Vetëvlerësimit të NJAB-së”) përmban 40 pyetje. Nga verifikimi i saktësisë së plotësimit të tyre rezultoi se për pyetjet 27, 32 dhe 40 për të cilat janë dhënë përgjigjet “përputhshmëri e plotë” ose

“përputhshmëri e pjesshme nuk janë të sakta ato duhet të ishin “përputhshmëri në disa fusha”.
Më të detajuara, pyetjet dhe përgjigjet e dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit janë pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr 2. “Pyetjet e vlerësuara jo drejtë në pyetësorin e vetëvlerësimit të NJAB”.

Nr. i pyetjes	Pyetjet	Arsyetimi mbi Vlerësimin e kryer	Vlerësimi	Komente të grupit të auditimit KLSH
1	NJAB është ngritur në përputhje me kërkesat e ligjit për auditimit e brendshëm dhe aktet nënligjore?	NJAB me 3 auditues të pacertifikuar.	Përputhshmëri e pjesshme.	Kjo pyetje nuk është vetëvlerësuar saktë nga NJAB pasi: NJAB ka të gjithë anëtarët e pacertifikuar, Drejtuesi i NJAB-së është pa eksperiencën e kërkuar dhe nuk është i certifikuar, nga anëtarët e NJAB nuk zotëron diplomë të nivelit të dytë universitar dhe i vetmi kriter që përmbushte nga NJAB është kriteri në lidhje me numrin e anëtarëve të NJAB-së. Përgjigja sipas KLSH:së: <i>Përputhshmëri në disa fusha.</i>
10	Drejtuesi i NJAB dhe audituesit e brendshëm janë emëruar në përputhje me kriteret e punësimit të përcaktuara në kuadrin rregullator.	Drejtuesi dhe një specialist janë në proces certifikimi.	Përputhshmëri e pjesshme.	Drejtuesi i NJAB-së nuk është i certifikuar dhe anëtarët e tjerë janë të pacertifikuar dhe një prej tyre nuk disponon një diplomë të nivelit të dytë universitar. Përgjigja sipas KLSH:së: <i>Përputhshmëri në disa fusha.</i>
11	NJAB përmbush kërkesat ligjore për trajnimin e vijueshëm profesional.	Drejtuesi he një specialist janë në proces certifikimi por marrin pjesë në trajnimin e vijueshëm profesional çdo vit.	N/A	Në lidhje me këtë përgjigje nga NJAB nuk është shënuar përgjigja përkatëse, dhe argumenti nuk është për të tre anëtarët e NJAB-së, pasi një prej tyre nuk rezulton të këtë bërë 40 orët e trajnimit të vijueshëm profesional. Përgjigja sipas KLSH:së: <i>Përputhshmëri në disa fusha.</i>
22	Ndryshimet në Planin Vjetor argumentohen, shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm(nëse ka), miratohen nga titullari dhe janë pjesë e dosjes. Ky dokument dërgohet zyrtarisht në DH/AB.	Gjatë vitit 2022 nuk ka patur ndryshim të planit strategjik.	Përputhshmëri e plotë.	Në lidhje me këtë përgjigje të plotësuar nga NJAB rezulton se për shkak të mospërmbushjes së planit vjetor të vitit 2022, nuk është realizuar plani strategjik e për rrjedhojë duhet të reflektoheshin ndryshimet dhe në planin strategjik. Përgjigja sipas KLSH:së:

				Përputhshmëri në disa fusha.
23	Angazhimet e auditimit kryhen sipas parashikimeve në Planin vjetor.	Për vitin 2022 ishin planifikuar 7 misione auditimi dhe janë realizuar 5 misione nga të planifikuarat dhe një mision më urdhër të titullarit nr. 243, datë 16.05.2022. Sektori i taksave nuk u auditua, pasi u auditua nga KLSH.	Përputhshmëri e plotë	Për sa kohë plani i angazhimeve nuk është realizuar, pavarësisht arsyetimit, përgjigja e kësaj pyetje nuk është e saktë. Pra nuk kemi realizim të angazhimeve në përputhshmëri të plotë. Përgjigja sipas KLSH:së: Përputhshmëri në disa fusha.

Burimi: NJAB, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga tabela më sipër rezulton se, 5 pyetje nuk reflektojnë në përgjigjet e dhëna situatën e NJAB-së, gjithashtu disa pyetje nuk kanë të shënuara përgjigjet përkatëse, konkretisht pyetjet: 11; 17; 18; 1921; 24; 29; 34; 37; 38; 40. Në këto pyetje nuk është plotësuar me “X” njëra nga kolonat në lidhje me përputhshmërinë.

Nga sa më sipër rezulton se paraqitja e pyetësorit të vetëvlerësimit nuk është bërë në përputhje me situatën reale të NJAB-së për vitin 2022.

Verifikimi i hartimit të planit vjetor dhe strategjik.

NJAB e Bashkisë Dibër, në planin strategjik 2022-2024 ka identifikuar 21 subjekte si objekt auditimi dhe fushat që do të auditohen sipas planit janë: Sistemet e kontrollit të brendshëm, sistemet e proceseve organizative, përfshirë personelin, buxhetimin dhe kryerjen e shpenzimeve, sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Subjektet e përfshira në planin strategjik 2022-2024 për t’u audituar janë:

- Sektori i prokurimeve;
- Sektori i pronave;
- Sektori i tatim taksave;
- Drejtoria e kopshteve dhe çerdheve;
- Drejtoria ekonomike;
- Drejtoria e shërbimeve publike dhe mirëmbajtjes së objekteve;
- Njësitë administrative(Kala e Dodës, Luzni, Lurë, Fushë Cidhën, Selishtë, Muhurr, Slllovë, Melan, Zall –Dardhë)
- Qendra Balnear Peshkopi;
- Qendra Kulturore;
- Klubi shumësportësh “Korabi”
- Ujësjellës Kanalizime SHA.

Nga verifikimi i paraqitjes së planit vjetor të auditimit rezultoi se:

Plani vjetor i auditimit nuk ka miratimin e titullarit të NJAB-së për shkak se nuk pa pasur një të tillë në momentin e hartimit të tij, por është e nënshkruar nga dy anëtarët e NJAB-së.

Pasqyrën nr. 3, e planit strategjik 2022-2024 “Plani vjetor i auditimit për vitin 2022” nuk është paraqitur saktë, pasi Njësitë Administrative për t’u audituar (Kala e Dodës, Luzni dhe Lura) janë vendosur në një rresht, kur në fakt ato janë subjekte të ndryshme dhe duhen evidentuar secila në një rresht të tabelës duke plotësuar për secilën llojin i auditimit, që do të realizohet, pjesët e tjera të planit vjetor dhe strategjik janë të plotësuar sipas formateve standard të Kapitullit III, të Manualit i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes: Mos respektim i të gjithë hapave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, për çështjet që lidhjen me procesin e planifikimit.

Situata: Nga verifikimi i procesit të planifikimit vjetor dhe strategjik të veprimtarisë së auditit të brendshëm u konstatuan disa mangësi si më poshtë:

- NJAB përpara procesit të planifikimit nuk ka plotësuar pyetësorët standard që kërkohen sipas Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar. Konkretisht nuk është plotësuar “Pyetësori formati standard 1”, “Pyetësori vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm”, Pyetësori formati standard 2”, “Pyetësori për planin strategjik – Të kuptosh procedurat e Auditimit të Brendshëm”, si dhe “Pyetësori formati standard nr. 3” “Identifikimi i sistemeve të njësive”.

Subjektet e planit strategjik, të përzgjedhura për t’u përfshirë në planin vjetor nuk kanë qenë ato të vlerësuara me risk të lartë, por mes tyre ka pasur dhe subjekte të vlerësuara me risk të mesëm dhe të ulët, kjo **në kundërshtim me pikën** “Identifikimi subjekteve”, të kapitullit “*Formati Standard 5: Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJA*”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me UMFE nr. 4, datë 10.01.2020, ku përcaktohet se: “*Plani strategjik i veprimtarisë së NJAB bazohet në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve. Në vitin e parë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të lartë, në vitin e dytë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e parë dhe në vitin e tretë do të parashikohen të auditohen subjektet e vlerësuara me risk më të ulët se në vitin e dytë por duhet respektuar frekuenca jo më shumë se 5 vjet*”. Subjektet e përcaktuara për auditim në vitin e parë të planit strategjik, ose thënë ndryshe në planin vjetor të vitit 2022, të paraqitura në pasqyrën nr.3 të Planit, që janë me risk të mesëm dhe të ulët janë: Klubi shumësportësh Peshkopi vlerësuar me “*Risk të mesëm*”; Klubi futbollit “Korabi” vlerësuar me “*Risk të mesëm*” dhe Njësitë Administrative Kala e Dodës, Luzni, Lurë të vlerësuara me “*Risk të ulët*”.

Nga forma e paraqitjes së pasqyrës nr.3 “Plani vjetor i auditimit për vitin 2022” rezulton një rresht tek kolona subjektet për t’u audituar, ku shënohet: “Kontrolle të ndryshme në çdo kohë”, për të cilin planifikohet një auditim i kombinuar përputhshmërie dhe financiar, kjo e pabazuar në analizën e risqeve, si kusht paraprak për të qenë pjese e planit vjetor.

Kriteri: Formatet Standard të Kapitullin nr. 3 të “Manualit i Auditimit të Brendshëm”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar.

-Pika “Identifikimi subjekteve”, të kapitullit “*Formati Standard 5* të Manualit të AB.

Ndikimi: Mos plotësimi i formularëve paraprak në lidhje me vlerësimin e risqeve, bën që vlerësimi i risqeve për subjektet e synuara të mos jetë real dhe për pasojë mund të lihen jashtë fokusit të auditimit subjekte, që mund të kenë risk të lartë të auditimit. Procesi i vlerësimit të risqeve mbetet proces “*Formal*”.

Shkaku: Mos respektimi i kërkesave të Manualit i Auditimit të Brendshëm”, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar, në lidhje me planifikimin.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtuesi i Njësive së Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për të realizuar një proces planifikimi të plotë siç parashikohet në Manualin e Auditit të Brendshëm, duke e dukumentuar këtë proces nëpërmjet plotësimit të të gjithë formularëve standard të kërkuar prej tij dhe në përzgjedhjen e subjekteve për auditim t’i kushtohet rëndësi e shtuar subjekteve të vlerësuara me “*risk të lartë*” të auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Anëtarët e NJAB-së që kanë hartuar planin vjetor dhe strategjik Z. H. D. dhe Znj. E. D..

Realizimi i planit vjetor të auditimit për vitin 2022.

Nga verifikimi i raportit të veprimtarisë audituese për vitin 2022 rezultoi se janë realizuar 6 misione auditimi, numër që përputhet me numrin e misioneve të planifikuara, por njëri prej misioneve të planifikuara nuk është kryer, konkretisht Sektori i Tatim Taksave kurse Njësia Administrative Tomin është audituar me Urdhrin e Titullarit nr.243, datë 16.05.2022. Në lidhje me ndryshimin e planit të auditimit **nuk është dërguar shkresë** për të argumentuar ndryshimin e planit vjetor pranë DHAB-së siç përcaktohet dhe në kapitullin 3.5 të Manualit të AB, ku përcaktohet se: *“Të gjithë planet vjetorë dhe strategjikë të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t’i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra”*. Misionet e auditimit të realizuara përgjatë vitit 2022 janë si më poshtë:

- 1.Njësia Administrative Tomin (jo pjesë e planit vjetor të vitit 2022).
- 2.Klubi Shumësportësh “Korabi”;
- 3.Klubi i Futbollit “Korabi”;
- 4.Qendra Kulturore Peshkopi;
- 5.Njësia Administrative Luzni;
- 6.Njësia Administrative Kala e Dodës;
7. Njësia Administrative Lurë.

Në lidhje me veprimtarinë audituese të vitit 2022 nga NJAB është hartuar Raporti i Veprimtarisë, i cili është dërguar pranë NJHAB-së me anë të shkresës përcjellëse nr.800/1, datë 24.02.2023, **përtej afatit** të parashikuar në kapitullin 4. 3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Njësia e auditimit të brendshëm përgatit raportin vjetor të veprimtarisë dhe pasi merr opinionin e KA ia dërgon për miratim titullarit të njësisë publike. Një kopje e këtij raporti i dërgohet në rrugë zyrtare dhe në format elektronik brenda datës 15 Shkurt të çdo viti strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave”*.

Nga verifikimi i bërë saktësisë në formës së paraqitjes së raportit vjetor të NJAB-së rezultoi se, forma e **raportit vjetor nuk është në përputhje** me formën e paraqitur në pjesën “Struktura e raportit vjetor të njësive të auditimit të brendshëm”, të paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, të ndryshuar.

Gjetjet/Rekomandimet dhe Zbatimi i rekomandimeve të lëna.

Në auditimet e kombinuara të realizuara përgjatë vitit 2022, rezulton se numri i gjetjeve dhe rekomandimeve për çdo mision auditimi të vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.3: “Rekomandimet e dhëna në subjektet e audituara për vitin 2022 dhe statusi i tyre”

Subjekti i audituar	Nr. Gjetjeve	Nr rek.	Të zbatuara	Në Proces	Pjesërisht	Pazbatuar	Totali raportuar për zbatim rek
Njësia Administrative Tomin	6	6		6			6
Klubi Shumësportësh “Korabi”	4	4		3			3
Klubi i Futbollit “Korabi”.	2	2		2			2
Qendra Kulturore Peshkopi.	12	12	5		6	1	12
Njësia Administrative Luzni.	9	9		6			6
Njësia Administrative Kala e Dodës.	9	9		6			6

Totali	42	42	5	23	6	1	35
---------------	-----------	-----------	----------	-----------	----------	----------	-----------

Burimi: NJAB, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga tabela më sipër rezulton se në raportin vjetor të veprimtarisë së NJAB-së ka një mosrakordim mes të dhënave të paraqitura në lidhje me numrin e gjetjeve dhe rekomandimeve dhe numrit të zbatueshmërisë së tyre, konkretisht këto diferenca rezultojnë në subjektet:

- Klubi Shumësportësh “Korabi”
- Njësia Administrative Luzni.
- Njësia Administrative Kala e Dodës.

Arsyet e diferencave, janë për shkak se periudhat e auditimit përfshijnë më shumë se një vit dhe gjetjet e rekomandimet e njëjta për vite të ndryshme, të periudhës objekt auditimi numërohen për çdo vit, ndërsa në lidhje me zbatimin raportohet vetëm njëherë për gjetjet dhe rekomandimet e njëjta për vite të ndryshme.

Në raportimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se **nuk ka një kategororizim** të tyre sipas fushave të gjetjeve.

Nga NJAB rezulton se **nuk është bërë një raport në lidhje me monitoronim** e zbatimit të rekomandimeve të lëna për vitin 2022, por vetëm është vendosur statusi i tyre në raport, pa e shoqëruar me evidenca, që të faktojë statusin e deklaruar të tyre, ky veprim është në **kundërshtim** me pikën 13.2 “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, Kapitulli IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kur nuk është planifikuar angazhim auditimi në vitin në vazhdim, audituesit duhet t’i mundësojnë një raport të shkurtër titullarit të njësisë, për progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të rëna dakord më parë. Në këto raste rishikimi i zbatimit të rekomandimeve mund të realizohet në auditimin e radhës të subjektit publik si pikë e veçantë e programit të auditimit”*.

Zbatimi i procedurave dhe evadimi i materialeve të auditimit, ruajtja dhe arkivimi i tyre.

Nga grupi i auditimit për të verifikuar evidentimin e punës audituese dhe plotësinë e dosjeve të auditit për misionet e realizuara për vitin 2022 u kontrolluan të gjitha dosjet e auditiveve.

Titulli i Gjetjes: Mangësi në dokumentacionet dhe evidencat audituese.

Situata: Nga verifikimi i dosjeve të auditimit u konstatua se dosjet janë të paplota dhe nuk përmbajnë dokumentet e kërkuara në Kapitullin VI të Manualit të AB. Në të gjitha dosjet e auditimit, mungojnë dokumentet standarde si më poshtë:

- Dokumenti Standard “Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit”
- Dokumenti Standard “Vlerësimi i risqeve për sisteme/fusha të veçanta të llogarisë”
- Dokumenti Standard “Vlerësimi i përgjithshëm i riskut”
- Dokumenti Standard “Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit”
- Dokumenti Standard “Plani i veprimtimit i sugjeruar”
- Dokumenti Standard “Kundërshtitë (observacionet)”
- Dokumenti Standard “Reagimet (feedback) e auditimit”
- Dokumenti Standard “Plani i veprimtimit i dërguar nga subjekti i audituar”.
- Dokumentit Standard “Autorizimi” në 4 dosje auditimi i mungon data, konkretisht në subjektet: Njësia Administrative Kala e Dodës, Njësia Administrative Luzni, Klubi Shumësportësh Peshkopi dhe Klubi i Futbollit “Korabi”;
- Dokumenti standard “Programi i angazhimit të auditimit” mungon në subjektin: Njësia Administrative Luzni dhe në të gjitha rastet e tjera kur ka qenë pjesë e dosje nuk ka pasur të shënuar datën.

Dosjet e auditimit gjithashtu kanë mangësi në evidencat mbështetëse të rezultateve të auditimit, në evidencat e vlerësimit të risqeve për subjektet.

Nga dosjet e auditimit, rezultoi se:

- 2 misione auditimi janë realizuar në të njëjtën periudhë kohore, konkretisht Njësitë Administrative Kala e Dodës dhe Luzni;

4 muajt e parë të vitit rezultojnë pa asnjë veprimtari audituese.

Kriteri: Formatet Standard të Dokumenteve në Kapitullin VI të “Manualit i Auditimit të Brendshëm”, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, të ndryshuar.

Ndikimi: Mos dokumentimi i punës audituese, nuk argumenton gjetjet audituese dhe rekomandimet e lëna. Mbivendosja e më shumë se një misioni auditimi në të njëjtën periudhë kohore, ndikon në cilësinë e veprimtarisë audituese, në kushtet kur NJAB ka burime të kufizuara (3 anëtarë).

Shkaku: Moszbatimi i procedurave të akteve ligjore në dokumentimin e veprimtarisë audituese dhe planifikim jo i mirë i periudhës gjatë së cilës do të kryhen veprimtaritë audituese.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtuesi i Njësisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa, që në bashkëpunim më anëtarët e tjerë të NJAB-së të realizojnë dokumentimin e punës audituese dhe të bëjë një shpërndarje të punës audituese, që të shmangen mbivendosjet e auditimeve në terren në të njëjtën kohë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Drejtuesi i NJAB-së dhe anëtarët e NJAB-së.

Ruajtja dhe arkivimi i dosjeve të auditimit.

Nga auditimi i dosjeve, u konstatua se për çdo angazhim auditimi, grupi i punës ka krijuar një dosje të veçantë. Nga auditimi u konstatua se, nuk është kryer inventarizimi i dokumentacionit që përmbajnë dosjet, sipas Formatit Standard nr. 1, në Kapitullin VI, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar.

2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër, pika 2, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2022, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2022-2024;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2022;
- Vendimet e KB “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Dibër” për vitin 2022;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2022 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave për vitin 2022 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë Dibër;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 115/2021, datë 24.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024";
- VKB nr. 01, datë 13.01.2022, “Buxheti i Bashkisë Dibër viti 2022”, konfirmuar e Prefektit të Qarkut Dibër me shkresë nr. 54/1, datë 21.01.2022.

1. Programimi i PBA-së 2022-2024

Për hartimin e PBA-së 2022-2024 nga Bashkia Dibër janë ndjekur dhe zbatuar hapat e më poshtëm:

- VKB nr. 03, datë 13.01.2022, “Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afat mesëm të PBA 2022-2024 për Bashkinë Dibër” me relacionin bashkëlidhur, verifikuar ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut me nr. 53/1 prot., datë 21.01.2022;
- Urdhër nr. 8, datë 07.01.2022, “Ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Dibër për vitin 2022”, ndryshuar me Urdhrin nr. 8/1, datë 06.04.2022;
- Dërgimi i miratimit të draftit projekt dokumentit të PBA 2022-2024 me shkresën nr. 1833 prot., datë 01.06.2021 në MFE.

Titulli i Gjetjes: *Probleme në lidhje me publikimin e Projekt Buxhetin Afatmesëm të vitit 2022-2024.*

Situata:

1. Për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Dibër nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024", kreu I, pika 13;
2. Kryetari i Bashkisë Dibër nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024", kreu I, pika 5 dhe 6;
3. Kryetari i Bashkisë Dibër nuk ka përgatitur dhe propozuar për miratim në Këshillin Bashkiak Tavanet Përgatitore të PBA 2022-2024, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024", kreu I, pika 3;
4. Kryetari i Bashkisë Dibër nuk ka dërguar brenda datës 1 Qershor 2021 me shkrim dhe në rrugë elektronike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë projekt-dokumentin e PBA 2022-2024, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar, në kundërshtim me

Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024", kreu I, pika 9.

Kriteri: Udhëzimi MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024", kreu I, pika 3, 5, 6, 9 dhe 13.

Ndikimi: Mangësi e menaxhimit për të publikuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur të njësisë vendore.

Shkaku: Analizat e punës për publikimin e PBA për 2022-2024 nuk janë bërë të plota, duke mos qenë transparent.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për publikimin në faqen zyrtare të saj, Projekt Buxhetet Afatmesme, të miratojë udhëzimin plotësues për përgatitjen e PBA-së, të miratojë tavanet përgatitore dhe të dërgojë projekt-dokumentin e PBA-së në MFE.

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura

Për vitin 2022 në Bashkinë Dibër buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 22 programeve, përkatësisht: Aparati, Arsimi Bazë, Shërbime Publike, Menaxhim Rruge, Ujësjellës Kanalizime, Fond Kontigjence, etj. Buxheti i vitit 2022, është miratuar me VKB nr. 01 datë 13.01.2022, me shkresën nr. 54/1, datë 21.01.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Rezulton se buxheti i viteve 2022-2024 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Tabela nr. II.2.1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022

Planifikimi i të ardhurave 2022		Planifikimi i shpenzimeve 2022	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	161,065	Art. 600 Paga	464,147
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2022	33,619	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	82,211
Donacione	8,087		
Total të ardhurat e veta	202,771	Art. 602 Shpenzime operative	258,113
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	81,591	Art. 604 Transferime korrente të brendshme	4,000
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).	43,862	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	5,090
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2022	458,190	Art. 230-231 Investime	213,929
Transferte specifike e çelur për llogari të vitit 2022	260,138	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	19,062
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	843,781		
TOTALI TË ARDHURAVE	1,046,552	TOTALI SHPENZIMEVE	1,046,552

Burimi: Bashkia Dibër

Tabela nr. II.2.2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2022

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	161,065	8,085	169,150	Art. 600 Paga	451,927	12,221	464,148
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2022	36,427		36,427	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	80,699	1,513	82,212
Total të ardhurat e veta	197,492	8,085	205,577	Art. 602 Shpenzime operative	238,071	20,042	258,113
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	81,591		81,591	Art. 604 Transferime korrente të brendshme	4,000	15,843	19,843
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike	43,863		43,863	Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	5,090		5,090
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2022	425,819	32,372	458,191	Art. 230-231 Investime	204,030	9,900	213,930
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2022	257,333		257,333	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	22,281	-19,062	3,219
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit	808,606	32,372	840,978				
TOTALI TË ARDHURAVE	1,006,098	40,457	1,046,555	TOTALI I SHPENZIMEVE	1,006,098	40,457	1,046,555

Burimi: Bashkia Dibër

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022

Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **2,041,374** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **1,893,326** mijë lekë, ose në masën **93%**. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. II.2.3: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Dibër për vitin 2022, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve Bashkia pa njësitë vartëse	Plani 2022	Fakti 2022	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta (fakti)	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti (fakti)
1	Artikulli - 600 Paga	433,062	430,939	100%	41,479	389,460
2	Artikulli – 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	76,810	72,129	94%	4,190	67,939
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	219,194	166,491	76%	45,338	121,153
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	23,062	19,061	83%		19,061
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (PAK)	21,130	19,737	93%		19,737
6	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndhima ekonomike)	1,054,193	1,048,335	99%		1,048,335
7	Artikulli - 230 Projekte	2,090	2,000	96%		2,000
8	Artikulli - 231 Investime	211,833	134,634	64%	24,005	110,623
	TOTAL	2,041,374	1,893,326	93%	115,012	1,778,314

Burimi: Bashkia Dibër

VKB nr. 01 datë 13.01.2022, me shkresën nr. 54/1, datë 21.01.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, me VKB nr. 35, datë 10.05.2022, “Për një shtesë në zërin e investimeve të planifikuara për vitin 2022, Bashkia Dibër”, VKB nr. 42, datë 03.06.2022, “Për një ndryshim në pasqyrën financiare të investimeve të Bashkisë Dibër”, VKB nr. 48, datë 16.06.2022, “Për një ndryshim në pasqyrën e investimeve të Bashkisë Dibër, për sistemin e kunetave për Rugën e lagjes Kamen”, VKB nr. 56, datë 15.07.2022, “Për një ndryshim në pasqyrën e investimeve të Bashkisë Dibër nga skema e Granteve për një Zhvillim Rajonal Kohëvizion - Aplikimi nr. RDPA4FA001 “Ekonomia e Gjellbër si një mundësi Smart për Radomirën” dhe bashkëfinancimin e TVSh nga ana e bashkisë Dibër me kod projekti G106002”, VKB nr. 4, datë 16.09.2022, “Për miratimin ndryshimit të zërave buxhetore në Buxhetin e Bashkisë Dibër për vitin 2022” dhe VKB nr. 121, datë 22.12.2022, “Për trajtimin e shtesës së fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar specifike për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022”.

Sipas përcaktimit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47³, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44⁴, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c, “...Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar”.

3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit

Treguesit e buxhetit për vitin 2022, është planifikuar në shumën 2,041,374 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 1,893,326 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 93%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 115,012 mijë lekë ose në masën 6% të buxhetit faktik.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet

³ Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

⁴ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore pasqyruar në anekset bashkëlidhur.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 44 dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Bashkia Dibër ka përgatitur vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2022 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 1485 prot., datë 11.04.2023.

Titulli i Gjetjes: *Mos zbatim i plotë i kuadrit ligjor për raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit.*

Situata: Bashkia Dibër për vitin 2022 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2022, ndërsa 3 raportet periodike të monitorimit nuk janë hartuar për vitin 2022. Kryetari i Bashkisë Dibër në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit nuk janë të plota pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Shtojca 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojca 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

Ndikimi: Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të buxhetit të vitin 2022.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe drejtori i Drejtorisë Ekonomike, të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen tre raporte katër mujor për monitorimin e zbatimit të buxhetit, të cilat të dërgohen gjithashtu në MFE. Kryetari i Bashkisë të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve

Në Bashkisë Dibër vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 501,101,774 lekë, si në raportimin në MFE ashtu dhe në rakordimet me Degën e Thesarit. Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura Bashkia Dibër ka nuk hartuar një plan dhe të paraqitet në raportimin e monitorimit vjetor të buxhetit dërguar në MFE.

Tabela nr. II.4.1: Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Dibër viti 2022

Lekë

Nr.	EMËRTIMI	Vlera e detyrimit 31.12.2021	Shtesa gjatë vitit 2022	Likuidime gjatë vitit 2022	Detyrimi në 31.12.2022
1	Detyrime të prapambetura për shpenzimet operative	8,911,892	78,445,130	30,966,101	56,390,921
2	Detyrime të prapambetura për investime	88,923,465	801,688,614	476,164,268	414,447,811
3	Detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore	101,618,041	-	71,354,999	30,263,042
TOTALI		199,453,398	880,133,744	578,485,368	501,101,774

Burimi: Bashkia Dibër, përpunoi grupi i auditimit

Titulli i Gjetjes: Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara dhe moslikuidimi i vendimeve gjyqësore.

Situata: Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën mësipërm, rezultojnë se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE, rakordohet me degën e thesarit për vlerën 501,101,774 lekë, gjithashtu, përputhet me vlerën e në dokumentet analitike që bashkia disponon dhe rezultojnë që **detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 të jenë në vlerën 501,101,775 lekë.**

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, "Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore...", neni 40, pika 3, "Projektbuxheti vjetor përfshin...informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore...detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës". Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101 "Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim".

Ndikimi: Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penalitetesh të panevojshme dhe pasaktësi në vlera dhe mangësi në raportime të detyrimeve të prapambetura.

Shkak: Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, vlera jo të besueshme dhe mungesë raportimesh në MFE për detyrimet e prapambetura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Dibër të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 501,102 mijë lekë, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Dibër

Në UMFE nr. 26, datë 27.03.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore", trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive.

Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Dibër, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2022 ka vlerën 1,026,093,136 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022, ka vlerën 158,152,210 lekë, sipas raportimit në MFE me shkresë nr. 651, datë 28.02.2023. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 15.41%, shifër që e klasifikon Bashkinë Dibër në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Dibër

Titulli i Gjetjes: Mos likuidim i vendimeve gjyqësore sipas radhës së paraqitjes së tyre.

Situata:

1. Të dhënat e paraqitura në aneksin nr. II.4.1 rezultojnë se vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore nga dokumentet analitike të bashkisë rezultojnë në vlerën 101,618,041 lekë janë paguar detyrime në vlerën 71,354,999 lekë dhe deri në 31.12.2022 rezultojnë **detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore në vlerë 30,263,042 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore" neni 40, pika 3;
2. Bashkia Dibër në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", pika 5 dhe pika 8.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore" neni 40, pika 3 dhe Udhëzimi i MFE nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", pika 5 dhe pika 8.

Ndikimi: Identifikimi, regjistrimi i vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura si dhe likuidimi i tyre ndikon në vlerësimin e situatës financiare të Bashkisë Dibër.

Shkaku: Bashkia Dibër nuk zbaton radhën e regjistrimit në bashki të vendimeve gjyqësore për likuidim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike të hartojë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojë me rigorozitet radhën e regjistrimit të tyre në bashki kur të kryejë likuidimet e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Sh. M., ish Kryetar i Bashkisë Dibër;
2. Z. R. S., Kryetar i Bashkisë Dibër;
3. Zj. Ç. Z., Drejtore e Drejtorisë Ekonomike;
4. Z. M. Sh., Përgjegjës i Sektorit të Financës;
5. Zj. A. T., Përgjegjëse e Sektorit të Financës;

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 2, nënpika 2.6, u auditua *burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre bazuar në kuadrin rregullator në fuqi*.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Dibër bëhet mbështetur në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;

- VKB-në nr. 63, datë 24.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022 Bashkia Dibër”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresë nr. 1245/1 prot., datë 06.01.2022.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Dibër për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifave vendore;
- Dokumentacioni i Drejtorisë së Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifave vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar pagesat e kontratave të qirave të aseteve është:

- Kontratat e aseteve të dhëna me qira;
- Dosjet përkatëse të subjekteve që kanë marrë asete me qira;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion lidhur me monitorimet e kontratave dhe likuidimet e pagesave të qirave.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Dibër është miratuar me VKB-në nr. 63, datë 24.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022 Bashkia Dibër”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresë nr. 1245/1 prot., datë 06.01.2022.

Tabela nr.II.6.1: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Dibër, viti 2022 000 lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	FAKT	%
I	Të ardhura nga Tatimet	2,100	650	31%
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	2,100	650	31%
II	Të ardhura nga Taksat	67,051	42,663	64%
2	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	15,451	10,091	65%
3	Taksa mbi token Bujqësore	5,300	835	16%
4	Taksë mbi regjistrimin e Automjete	25,000	19,767	79%
5	Taksa e ndikimit të ndërtimit mbi infrastrukturën	15,000	8,961	60%
6	Taksë Tabele, reklame	900	1,040	116%
7	Taksë hoteli	4,000	933	23%
8	Taksë Parkimi	1,000	768	77%
9	Taksë për hapësira publike	400	268	67%
III	Të ardhura nga Tarifave	28,080	20,316	72%

10	Tarifë Pastrimi	21,450	16,182	75%
11	Tarifë shërbim te tjera publike	1,400	1,058	76%
12	Tarifë leje transport.	1,700	1,429	84%
13	Tarifë ndriçimi rrugor	3,330	1,647	49%
14	Tarifë certifikimi mishi	200		0%
IV	Të ardhura të tjera	63,834	71,320	112%
15	Qira trualli	8,500	5,120	60%
16	Qira kullote	500		0%
17	Të ardhura tendera		772	
18	Gjoha		134	
19	Taksë Vule	4,000	2,061	52%
20	Qira ndërtese	1,700	1,336	79%
21	Dhurata, sponsorizim & Grant		20,768	
22	Të ardhura të tjera	49,134	41,129	84%
	GJITHSEJ (I+II+III+IV)	161,065	134,946	84%

Burimi: Bashkia Dibër

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Dibër për vitin 2022 janë realizuar në masën **71% (pa përfshirë zërin dhurata, sponsorizime dhe grante)** nga 161,065 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 114,178 mijë lekë (diferencë 46,887 mijë lekë).

Gjithsej;

- 1 zë është realizuar në masën mbi ose 85%,
- 12 zëra janë realizuar në masën mbi ose 50%,
- 2 zëra është realizuar në masën mbi ose 25%,
- 4 zëra nën masën 25%.

Titulli i gjetjes: Nivel i ulët i realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore referuar planit vjetor të të ardhurave.

Situata: Për vitin 2022 në Bashkinë Dibër niveli i realizimit të të ardhurave është 71%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Kriteri:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 2;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 41, germa ç/I;
- Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022";
- Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Dibër është miratuar me VKB-në nr. 63, datë 24.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022 Bashkia Dibër”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresë nr. 1245/1 prot., datë 06.01.2022.

Ndikimi: Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ndikon në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë.

Shkakuj: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër nuk ka qenë efektive në punën e saj për të mbledhur të ardhurat e parashikuara nga tatimpaguesit fizik/juridik si dhe ato familjarë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër të angazhohet në marrjen e masave për një planifikim sa më të saktë duke bashkëpunuar me struktura të bashkisë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c⁵ dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5⁶.

Në Bashkinë Dibër struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në procesin e legalizimeve për vitin 2022 rezulton se, janë legalizuar 54 objekte me vlerë totale 2,507,750 lekë. (sipas të dhënave aneksin II.6.1)

Titulli i gjetjes: *Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve).*

Situata: Lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2022 nuk ka paguar asnjë qytetarë me vlerë totale 2,507,750 lekë dhe nga vitet e mëparshme janë debitorë në vlerë totale 10,090,807 lekë, që përbën në total 12,598,557 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.

Ligji nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”.

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Dibër, nga mos arkëtimi i vlerës prej 12,598,557 lekë për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkakuj: Mos marrje e masave efektive nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

Rëndësia: E lartë

⁵ Ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi”.

⁶ VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë me Drejtorinë e të ardhurave dhe struktura të tjera të bashkisë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 12,598,557 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e Bashkisë Dibër të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Dibër kryhet në programin Excel. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Tabela nr.II.6.2: Numri i bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Dibër 2022

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	756	68	56	768
2	Biznesi Madh	91	19	0	110
	Gjithsej	847	87	56	878

Burimi: Bashkia Dibër

Menaxhimi i borxhit

Titulli i gjetjes: Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Dibër dhe masat e marra për uljen e tij.

Situata:

Subjektet Debitore

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve për vitin 2022 është 5,235 mijë lekë, ndërkohë që debitorët progres për subjektet fizik/juridik në fund të vitit 2022 rezultojnë, 1,771 subjekte në vlerën 11,403,160 lekë, sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. II.6.3: Bizneset debitorë progresiv deri në 31.12.2022

lekë

Nr	BIZNESE	Nr. Biznese	Viti 2021	Pakësim	Shtesa gjatë 2022	Viti 2022
1	Taksa ndërtese	478	4,134,227	230,530	2,836,224	6,739,921
2	Taksë table	0	0	0	0	0
3	Taksë pastrimi	478	1,476,400	760,500	648,922	1,364,822
4	Taksë ndriçimi	337	615,000	77,700	641,300	1,178,600
5	Tarifë gjelbërimi	478	344,400	45,490	283,840	582,750
6	Kamatëvonesa		1,594,088	881,905	824,884	1,537,067
	TOTAL	1,771	8,164,115	1,996,125	5,235,170	11,403,160

Burimi: Bashkia Dibër, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi konstatohet se, në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve është në vlerën 5,235,170 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është **11,403,160 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër** (Për më shumë informacion shiko aneksin nr. II.6.2).

Taksat dhe Tarifat Familjare

Në Bashkinë Dibër familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifat e pastrimit, ndriçimit dhe të gjelbërimit, paraqiten në tabelat si më poshtë:

Tabela nr. II.6.4: Familjarët debitorë progresiv deri në 31.12.2022

lekë

Nr	FAMILJARE	Nr. Familje	Viti 2021	Pakësim	Shtesa gjatë 2022	Viti 2022
1	Taksa e tokës bujqësore	4,466	9,176,356	0	4,465,094	13,641,450
2	Tarifë pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi	2,963	17,963,934	0	5,499,130	23,463,064
3	Taksë ndërtese (objekt banimi)	1,523	7,829,438	0	2,779,090	10,608,528
	TOTAL	8,952	34,969,728	0	12,743,314	47,713,042

Burimi: Bashkia Dibër, përpunoi grupi i auditimit

Konstatohet se, në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve e familjarëve është në vlerën 12,743,314 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 47,713,042 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër.

Tabela nr. II.6.5: Familjarët debitorë progresiv deri në 31.12.2022

000 lekë

Nr.	Emërtim i taksës/tarifës vendore	Kategoria e taksapaguesit	Numri i debitorëve	Vlera progresive e debitorëve në datën 31.12.2021, raportuar nga subjekti në auditimin e mëparshëm (të kryer gjatë vitit 2022)	Vlera progresive e debitorëve në datën 31.12.2021, raportuar nga subjekti në auditimin e radhës (të kryer gjatë vitit 2023)	Pagesat e kryera gjatë vitit 2022 për llogari të gjendjes së debitorëve progresiv në datën 31.12.2022	Vlera e debitorëve të rinj, krijuar vetëm gjatë vitit 2022, nga mos pagesa e detyrimeve të vitit 2022	Detyrimi progresiv i debitorëve më 31.12.2022
1	Taksa ndërtese	Privat	478	4,134,227	4,134,227	230,530	2,836,224	6,739,921
2	Taksë table	Privat	-	-	-	-	-	-
3	Taksë pastrimi	Privat	478	1,476,400	1,476,400	760,500	648,922	1,364,822
3	Taksë ndriçimi	Privat	337	615,000	615,000	77,700	641,300	1,178,600
3	Tarifë gjelbërimi	Privat	478	344,400	344,400	45,490	283,840	582,750
3	Kamatëvonesa	Privat	-	1,594,088	1,594,088	881,905	824,884	1,537,067
3	Taksa e tokës bujqësore	Familjar	4,466	9,176,356	9,176,356		4,465,094	13,641,450
3	Tarifë pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi	Familjar	2,963	17,963,934	17,963,934		5,499,130	23,463,064
3	Taksë ndërtese (objekt banimi)	Familjar	1,523	7,829,438	7,829,438		2,779,090	10,608,528
	TOTAL		10,723	43,133,843⁷	43,133,843	1,996,125	17,978,484	59,116,202

Burimi: Bashkia Dibër, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, vlera totale borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Dibër paraqitet:

1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 47,713,042 lekë;
2. Biznese Debitorë në vlerë 11,403,160 lekë.

Në total borxhi tatimor në Bashkinë Dibër rezulton në vlerë 59,116,202 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër.

⁷ Të dhënat e marra nga anekset e Raportit të Auditimit të vitit 2022 nga KLSh. Përkatësisht Aneksi Pasqyra A4, A6, A7, A 11 dhe A 13.

Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23⁸.

Sipas Aneksit 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Dibër klasifikohet në kategorinë e pestë.

Në Bashkinë Dibër gjithsej janë 119,037 Ha tokë bujqësore nga të cilat janë të shfrytëzueshme 5,300 Ha, nga këto janë ndarë 143.03 Ha tokë, 421 familjeve si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.II.6.6: Debitorët për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022, në lekë

Nr.	Njësia Administrative	Tokë bujqësore gjithsej në Ha	Nr. Familje që kanë marrë AMTP	Sipërfaqe e ndarë sipas kategorive	Detyrimi progresiv për vitin 2021	Detyrimi për vitin 2022	Pagesa për vitin 2022	Detyrimi progresiv për vitin 2022	Sipërfaqja e tokës së pandanë
1	Qyteti Peshkopi	80.00	25	4.83	-				75.17
2	Nj.A. Tomin	2,691.00	78	21.60	981,926	600,044		1,581,970	2,669.40
3	Nj.A. Melan	1,531.00	33	6.63	654,865	412,000		1,066,865	1,524.37
4	Nj.A. Kastriot	2,361.00	29	7.95	719,459	600,000		1,319,459	2,353.05
5	Nj.A. Lurë	561.00	21	5.11	263,684	89,000		352,684	555.89
6	Nj.A. Maqellarë	3,067.00	102	41.36	4,210,781	1,160,000		5,370,781	3,025.64
7	Nj.A. Muhurr	877.00	15	6.40	247,390	218,520		465,910	870.60
8	Nj.A. Luzni	923.00	4	1.76	58,497	288,550		347,047	921.24
9	Nj.A. Selishtë	599.00	19	6.36	174,737	130,000		304,737	592.64
10	Nj.A. Sllovë	1,753.00	42	20.34	426,778	146,700		573,478	1,732.66
11	Nj.A. Kala e Dodës	778.00	3	1.74	204,000	150,000		354,000	776.26
12	Nj.A. Zall-Dardhë	782.00	24	7.94	217,506	90,000		307,506	774.06
13	Nj.A. Zall-Reç	712.00	2	1.64	222,190	90,000		312,190	710.36
14	Nj.A. Fushë Çidhën	1,019.00	7	2.46	542,904	253,350		796,254	1,016.54
15	Nj.A. Arras	1,303.00	17	6.91	251,639	236,930		488,569	1,296.09
Shuma		19,037.00	421	143.03	9,176,356	4,465,094	-	13,641,450	18,893.97

Burimi: Bashkia Dibër, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të tabelës më sipër në Bashkinë Dibër për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022 janë debitorë 421 familjeve me vlerë të detyrimit 4,465,094 lekë, ndërsa vlera progresive deri me 31.12.2022, **që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Dibër është në vlerën 13,641,450 lekë.**

Masat e marra për uljen e borxhit

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i

⁸ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 2.

ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.⁹

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, pika 89, i ndryshuar. Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresën nr. 1802 prot, datë 25.05.2022 ka dërguar listën e personave debitorë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (Drejtoria Vendore Dibër), për mos likuidimin e detyrimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, me shkresën nr. 4742 prot., datë 13.10.2022, kërkesë informacioni mbi procedurat e administrimit dhe pagesave të detyrimeve të kryefamiljarëve, drejtuar të gjithë Njësive Administrative. Me shkresë nr. 4742/ prot., datë 13.10.2022, njoftim dhe kërkesë për të paguar taksën dhe tarifën vendore drejtuar subjekteve debitorë, si dhe me shkresën nr. 5210 prot., datë 09.11.2022, Urdhër bllokimi për Llogaritë Bankare të Tatimpaguesve, drejtuar Degës së Thesarit Dibër, R. Bank, B.K.T., A. Bank dhe C. Bank.

Nga auditimit konstatohet se, Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2022, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës subjektet debitorë për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Dibër.

Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga debitorët.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

1.Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 47,713,042 lekë;

2.Biznese Debitorë në vlerë 11,403,160 lekë.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrë bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

⁹Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 89, 90, 91, 93.

e- Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Dibër, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Mbi realizimit e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Dibër ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Dibër u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 25 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 21 masa për “Pezullim të punimeve”, 17 masa për “Prishje të objekteve të kundërligjshëm” si dhe 17 masa “Dënim me gjobë”. Vlera e gjobave për vitin 2022 është 1,230,000 lekë. Por si nga Drejtoria e IMTV dhe Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria Ekonomike nuk ka informacion për debitorët progresiv. Për vitin 2022 nuk kanë paguar të 17 subjektet, sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. II.6.7: Gjobat e vendosura nga IMTV për vitin 2022, në lekë

NR	Emër Mbiemër	Nr. Vendimi	Datë Vendimi	Vlera
1	S.V.	107	10.02.2022	50,000
2	K.B.	109	31.03.2022	50,000
3	H.H.	110	08.04.2022	200,000
4	A.L.	111	08.04.2022	100,000
5	B.E.	112	08.04.2022	50,000
6	L.M.	113	29.04.2022	50,000
7	D.R.	114	13.05.2022	100,000
8	B.M.	115	03.06.2022	50,000
9	Q.H.	116	06.06.2022	50,000
10	Xh.B.	117	27.06.2022	50,000
11	N.C.	118	29.06.2022	30,000
12	L.N.	119	03.07.2022	200,000
13	E.C.	120	05.08.2022	50,000
14	L. S.	121	05.08.2022	50,000
15	M.S.	122	05.08.2022	50,000
16	T.L.	123	04.10.2022	50,000
17	S.A.	124	08.11.2022	50,000
TOTAL				1,230,000

Burimi: Bashkia Dibër, përpunoi grupi i auditimit

Drejtoria e IMTV nuk ka ndjekur hapat e nevojshëm për të dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për të gjithë gjobat e vendosura të këtij viti, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4.

Titulli i gjetjes: *Mos pagesë e gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Dibër*

Situata: për vitin 2022 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 1,230,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet se, për gjobat e vendosura nga IMTV për vitin 2022 nuk janë ndërmarrë masa nga Drejtoria e IMTV për të njoftuar drejtoritë përkatëse që këto gjoba të kontabilizohen, ashtu dhe nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria Ekonomike nuk ka marrë masa për tu kontabilizuar këto gjobat. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kapitulli 1¹⁰, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5.

Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Dibër nga mos pagesa e gjobave të vendosura nga IMTV.

Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit nga IMTV për ndjekjen e hapave ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **1,230,000 lekë për vitin 2022**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Në territorin e Bashkisë Dibër për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë për vitin 2022, janë 17 subjekte me 18 pika që ushtrojnë këtë aktivitet. Grupi i auditimit, auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi¹¹ dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore për vitet 2022.

Titulli i gjetjes: *Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse.*

Situata: Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 17 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 18 pika karburanti), nga të cilat 14 pika kanë licenca me afat më të shkurtër se 5 vjet dhe me pagesa pjesore dhe 4 pika kanë licenca 5-vjeçare, 8 subjekte për 9 pika karburanti janë të autorizuar dhe kanë paguar

¹⁰ ... regjistrimet kontabël kryhen në kohën e lindjes së një të drejte për të arkëtuar ose të një detyrimi për t’u paguar nga njësia ekonomike, të drejta dhe detyrime këto që sjellin në të ardhmen arkëtime ose pagesa, por që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë të ardhura ose shpenzime.

¹¹Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

detyrimet sipas kërkesave ligjore, ndërsa për 9 subjekte janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale progresive 7,200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dibër dhe 3,750,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dibër për vitin 2022, sipas tabelës më poshtë.

Tabela nr. II.6.8: Subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë debitorë
lekë

NR	SUBJEKTI	NIPT	Afati i përdorimit të licencës	Data fillimi Licencës	E vlefshme deri më	Detyrimi 2022	Pagesa	Debitor 2022	Debitor për licencën
1	"Sh."	J.	1 Vit	04.05.2020	04.05.2021	200,000	200,000		
			4 Vjet	12.05.2021	11.05.2025	800,000	800,000		
2	"D."Shpk	K.	1 Vit	16.07.2020	16.07.2021	200,000	200,000		
			4 Vjet	14.09.2021	01.07.2025	800,000	800,000		
3	"M."Sh.p.k	J.	1 Vit	22.06.2020	22.06.2021	200,000	200,000		
			4 Vjet	14.12.2021	22.06.2025	800,000	800,000		
4	"K." Sh.p.k(Pilafe)	J.	1 Vit	16.07.2020	15.07.2021	200,000	200,000		
			4 Vjet	14.06.2021	12.06.2025	800,000	800,000		
5	K.	J.	1 Vit	05.03.2020	05.03.2021	200,000	200,000		
			4 Vjet	05.03.2021	05.03.2025	800,000	800,000		
6	G.	K.	5 Vjet	25.03.2021	25.03.2026	1,000,000	800,000		200,000
7	"D." shpk	J.	1 Vit	10.02.2020	10.02.2021	200,000	200,000		
			4 Vjet	10.03.2021	09.03.2025	800,000	800,000		
8	"S." shpk	K.	1 Vit	24.06.2021	24.06.2022	200,000	200,000		
			1 Vit	27.06.2022	26.06.2023	200,000	200,000		800,000
9	"A." shpk	L.				200,000		200,000	1,000,000
10	"K." shpk	J.	1 Vit	18.09.2021	18.09.2022	200,000	200,000		
			1 Vit	18.09.2022	17.09.2023	200,000	200,000		800,000
11	"B." shpk	J.	1 Vit	16.09.2021	15.09.2022	200,000	200,000		
						58,333		58,333	1,000,000
12	"M." shpk	J.	1 Vit	19.07.2021	18.07.2022	200,000	200,000		
						83,333		83,333	1,000,000
13	"O." shpk	L.	1 Vit	24.06.2021	24.06.2022	200,000	200,000		
			1 Vit	25.06.2022	24.06.2023	200,000	200,000		800,000
14	"H." shpk	L.	1 Vit	04.10.2021	03.10.2022	200,000	200,000		
						33,334		33,334	800,000
15	"A." shpk	J.	1 Vit	19.07.2021	18.07.2022	200,000	200,000		
			1 Vit	19.07.2022	20.07.2023	200,000	200,000		800,000
16	"T."shpk	K.	5 Vjet	17.02.2020	16.02.2025	100,000	100,000		
17	"I.N."shpk	K.	5 Vjet	03.08.2020	02.08.2025	100,000	100,000		
18	R.Xh.	K.	5 Vjet	19.03.2021	18.03.2026	100,000	100,000		
						9,875,000	9,300,000	375,000	7,200,000

Burimi: Bashkia Dibër, përpunoi grupi i auditimit

Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte sipas dokumentacionit që bashkia disponon dhe janë të pa pajisur me autorizim, bie në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i

ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*”. Neni 20-Autorizimet pika 2. “*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11¹², jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*”.

Kriteri: Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte sipas dokumentacionit që bashkia disponon dhe janë të pa pajisur me autorizim, bie në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, Neni 20-Autorizimet pika 2.

Ndikimi: Mos pagesa e detyrimeve për autorizimin ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër për vitin 2022 në vlerën 375,000 lekë dhe vlera 7,200,000 lekë për autorizimet vlera progresive.

Shkaku: Mos zbatim i detyrimeve ligjore nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Dibër me vlerë 7,200,000 lekë.

Leje minerare

Në territorin e Bashkisë Dibër në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe Inproduktive, nga ku konstatohet se nga Bashkia Dibër, nuk është vepruar për hartimin e kontratave për të dhënë me qira sipërfaqet pyjore dhe kullosore me 10 subjektet fizike të mësipërme, edhe pse këto subjekte janë pajisur me leje shfrytëzimi të miratuar ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MIE).

Në vijim paraqiten subjektet e pajisur me leje minerare nga MIE.

Tabela nr. II.6.9: Subjektet që ushtrojnë aktivitet nxjerrje prodhim minerale dhe inertesh

Nr	Nr. Leje	Data QKB	Emri i subjektit	Nipt	Bashkia	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit	S=km2
1	450/1	24.02.1999	K. shpk	K.	Dibër	Vanas	Krom	0.02
2	537	05.01.2000	H. shpk	K.	Dibër	Shtrunges, Selishte	Krom	0.005
3	1324/2	19.08.2013	B. shpk	L.	Dibër	Obj. Kapat e Dik Nelit, Selishta Jugore	Krom	2
4	1331/2	20.03.2009	K.T. Shpk	K.	Dibër	Vrenjt - Radomire	Gips- Anhidrit	1.033
5	1477/1	04.03.2013	P. - X shpk	L.	Dibër	Eshte ne rajonin Selishte, objekti Kacni	Krom	2.165
6	1596	21.11.2012	F.K. (D.P. shpk NK)	M.	Dibër	Objekti Zall Gjoçaj	Krom	0.375

¹²Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 11 Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë”.

7	1779	13.11.2015	R. A shpk	L.	Dibër	Objekti Fush Bulqizë	Krom	1.02
8	1797	19.04.2016	M. shpk	K.	Dibër	Sheshi I Çukes	Krom	0.785
9	1841	21.09.2017	G.	L.	Dibër	Objekti Gura e Zezë	Krom	0.789
10	1843	21.09.2017	K. shpk	L.	Dibër	Objekti Fush Lurë	Krom	0.025

Titulli i gjetjes: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2022

Situata: Për vitin 2022 referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Dibër ushtrojnë aktivitetin 10 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, asete të Bashkisë Dibër. Nga bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimit të mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Dibër. Rastet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet nxjerrje prodhim minerale dhe inertesh, që nga të dhënat e Bashkisë Dibër, ka lidhur kontratë qiraje me nr. 5130 Rep., nr. 946/1 Kol., datë 08.06.2012 me subjektin “E.” ShPK, me objekt administrimin e një pasurie të paluajtshme, tokë me sipërfaqe 4950 m², në të cilën me Vendim të Këshillit të Komunës Fushë Cidhën nr. 19, datë 01.08.2010 ka ndërtuar një Nyje Zhavorri për Larje Inertesh dhe prodhim Asfalto-Betoni, me një afat 30 vjet, duke filluar nga data 01.03.2011. Subjekti paguan detyrimet në Bashkinë Dibër, por sipas verifikimit në AKBN nuk është i pajisur me leje minerare.

Kriteri: Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Ndikimi: Përdorimi i fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Dibër në kundërshti me ligjin, që sjell tjetërsimin e aseteve të saj, pa pasur asnjë të drejtë mbi pronësinë apo kontratë mbi përdorimin e tyre. Përdorimi i fondit pyjor në mungesë të kontratave të qirave, gjithashtu sjell të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Dibër.

Shkak: Mos njohja dhe zbatimi i dispozitave ligjore të përdorimit të fondit pyjor dhe ligjit të sektorit minerar.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të merren masa në mënyrë të menjëhershme që të bllokohet aktiviteti ekonomik i këtyre gurore (sipas tabelës II.6.9), deri në momentin e përfundimit të procedurave ligjore, në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve përkatëse të gurore të sipërcituara. Gjithashtu, para momentit të zhbllokimit, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat ligjore për heqjen nga fondi pyjor, Bashkia Dibër të bëjë një vlerësim për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor, dhe t’jua faturojë subjekteve përkatëse private me aktivitet gurore.

Asetet e dhëna me qira

Dhënia e aseteve të bashkisë me qira bëhet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore;
- VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;
- VKM nr. 391, datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Bashkia Dibër në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi¹³ për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 1 kontrata për dhënie me qira të aseteve në territorin e Bashkisë Dibër. Kjo kontrata është lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes, për afat kohor deri në 1 vit. Kontrata nr. 1, datë 14.09.2021, “Për prodhimin/vjeljen/grumbullimin e prodhimeve të dyta (bimëve mjekësore), nga fondi pyjor kullosor publik në pronësi të Bashkisë Dibër”, është lidhur midis Bashkisë Dibër dhe subjektit E. Gj., për ambient magazinimi për prodhimin/vjeljen/grumbullimin e prodhimeve të dyta (bimëve mjekësore), nga fondi pyjor kullosor publik në pronësi të Bashkisë Dibër, me vlerë 83,400 lekë, me afat 1 vjeçar. Ky detyrim është paguar nga subjekti sipas kontratës së lidhur me datë 20.10.2021.

Për krijimin e të ardhurave prej dhënies me qira Bashkia Dibër ka lidhur 4 kontrata për dhënie me qira të aseteve që ka në pronësi për antena të telefonisë celulare, në territorin e Bashkisë Dibër. Rezulton se, kanë paguar detyrimin të gjithë subjektet dhe nuk ka debitorë. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore. Në mënyrë të përmblodhur kontratat paraqiten në tabelat në vijim:

Tabela nr.II.6.10: Kontratat e lidhura nga Bashkia Dibër për antena të telefonisë celulare
lekë

Nr.	Qiradhënësi	Qiramarrësi	Data nënshkrimit të kontratës	Afati përfundimit të afatit të kontratës	Sipërfaqja m2	Vlera kontratës	Vlera e detyrimit për vitin 2022
1	Bashkia Dibër	T.A. sha	14/02/2019	01/11/2026	200	160,000	-
2	Komuna Lurë	A. sha	03/12/2013	27/03/2022	300	300,000	-
3	Bashkia Dibër	T.A sha	03/05/2017	16/06/2020	60	240,000	-
4	Bashkia Dibër	T.A sha	20/04/2016	19/01/2025	300	300,000	-

Burimi: Bashkia Dibër

Konkluzion: të ardhura të munquara për buxhetin e Bashkisë janë:

- ◇ Nga taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 12,598,557 lekë progresive deri në 31.12.2022, ndërsa për vitin 2022 është në vlerën 2,507,750 lekë;
- ◇ Nga familjet për taksat dhe tarifat e tokës, ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, etj., në vlerën 47,713,042 lekë progresive deri në 31.12.2022, ndërsa për vitin 2022 është në vlerën 12,743,314 lekë;
- ◇ Nga bizneset debitoare, në vlerën 11,403,160 lekë progresive deri në 31.12.2022, ndërsa për vitin 2022 është në vlerën 5,235,170 lekë;
- ◇ Nga taksa mbi tokën bujqësore, në vlerën 13,641,450 lekë progresive deri në 31.12.2022, ndërsa për vitin 2022 është në vlerën 4,465,094 lekë;
- ◇ Nga gjoba të vendosura nga IMTV në vlerën totale 1,230,000 lekë për vitin 2022;
- ◇ Nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në vlerën 375,000 lekë për vitin 2022 dhe 7,200,000 lekë detyrim për licencën 5-vjeçare.

¹³ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Sh. M., ish Kryetar i Bashkisë Dibër;
2. Z. R. S., Kryetar i Bashkisë Dibër;
3. Z. B.M., Përgjegjës Sektori i Sektorit të Administrimit të të Ardhurave;
4. Z. L. C., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
5. Z. K. I., Kryeinspektor;
6. Z. L. T., Kryeinspektor;
7. Z. G. M., Drejtor i Drejtorisë së Pronave;
8. Zj. Ç. Z., Drejtore e Drejtorisë Ekonomike;
9. Z. M. Sh., Përgjegjës i Sektorit të Financës;
10. Zj. A. T., Përgjegjëse e Sektorit të Financës;
11. Z. A. C., Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Ujërave dhe Pyjeve;
12. Z. V. T., Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave.

Pika 2.6. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve.

Sipas informacioneve të marrë rezulton se në Bashkinë Dibër janë gjithsej 5,950 asete të kaluara këto me VKM nga viti 2008 deri në vitin 2013. Sipas të dhënave nga sektori i administrimit të aseteve dhe sektori ardhurave, sektori Pyjor, rezultojnë se janë gjithsej sipas pasqyrës në Bashkinë Dibër 131,005.5 ha.

Nr.	Njesite Administrative	Ssipërfaqja ne m2	Sipërfaqja ne ha sipas Njesive
1	Qyteti Peshkopi	1002397	1002.4
2	Nj.A. Tomin	25995077	25995.1
3	Nj.A. Melan	8796953	8797.0
4	Nj.A. Kastriot	17507899	17507.9
5	Nj.A. Lurë	5097924	5097.9
6	Nj.A. Maqellarë	20995093	20995.1
7	Nj.A. Muhurr	6284171	6284.2
8	Nj.A. Luzni	14973176	14973.2
9	Nj.A. Selishtë	6879391	6879.4
10	Nj.A. Sllovë	785865	785.9
11	Nj.A. Kala e Dodës	1948210	1948.2
12	Nj.A. Zall-Dardhë	8442495	8442.5
13	Nj.A. Zall-Reç	4280590	4280.6
14	Nj.A. Fushë Çidhën	331685	331.7
15	Nj.A. Arras	7684590	7684.6
	Totali	131,005,516	131,005.5

Nga të dhënat e sektorit të administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, rezulton se janë sipërfaqe e përgjithshme e fondit pyjor dhe kullor në përdorim të Bashkisë Dibër 26,309.15 ha ose 20% e sipërfaqes totale figuron pyje e kullota.

Nga të dhënat nga sektori i të Ardhurave rezulton se janë në administrim të Bashkisë Dibër sipërfaqe tokë bujqësore nga fondi për Bujqësinë gjithsej 18,893.9.15 ha ose 14% e sipërfaqes totale figuron tokë bujqësore e pa ndarë (Sipas tabelës më poshtë).

Nr	Njësia Administrative	Toke bujq. gjithsej	Nr. Fam. Që kanë marr AMTP	Sipërfaqja e tokësndarë në fakte Ligji 7501	Kategoria e tokës ndarë sipas ligjit 7501/ në hektar					Sipërfaqja e ndarë sipas kategorive	Sipërfaqja e tokës se pandanë	Sip. e tokësdhënë me qira
		Ha ne 1991			III	IV	V	VI	VII			
1	Qyteti Peshkopi	80	25	4.83			4.83			75	75.17	
2	Nj.A. Tomin	2691	78	21.6			21.6			2669	2669.4	
3	Nj.A. Melan	1531	33	6.63			6.63			1524	1524.37	
4	Nj.A. Kastriot	2361	29	7.95			7.95			2353	2353.05	
5	Nj.A. Lurë	561	21	5.11			5.11			556	555.89	
6	Nj.A. Maqellarë	3067	102	41.36			41.36			3026	3025.64	
7	Nj.A. Muhurr	877	15	6.4			6.4			871	870.6	
8	Nj.A. Luzni	923	4	1.76			1.76			921	921.24	
9	Nj.A. Selishtë	599	19	6.36			6.36			593	592.64	
10	Nj.A. Sllovë	1753	42	20.34			20.34			1733	1732.66	
11	Nj.A. Kala e Dodës	778	3	1.74			1.74			776	776.26	
12	Nj.A. Zall-Dardhë	782	24	7.94			7.94			774	774.06	
13	Nj.A. Zall-Reç	712	2	1.64			1.64			710	710.36	
14	Nj.A. Fushë Çidhën	1019	7	2.46			2.46			1017	1016.54	
15	Nj.A. Arras	1303	17	6.91			6.91			1296	1296.09	
Shuma		19037	421	143.03			143.03			143.03	18894	

Pra në total pyje, kullota dhe tokë bujqësore në të 15 njësitë administrative janë 45,203 ha ose 34% e totalit të aseteve të Bashkisë Dibër ndërsa 85,802 janë asete, rrugë, shkollë, çerdhe, ndërtesa, troje, institucione etj.

Sipas paketës fiskale është miratuar dhënia me qira ndërtesa (Pika a, b, c), tarifë në sektorin e pyjeve dhe kullotave (pika 2.8 dhe 2.8.3) tarifë dyshme për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik për ushtrimin e veprimtarisë.

Sipas informacionit të administruar, rezulton se në për vitin 2022, janë mbajtur 26 proces-verbale konstatimi (si me poshtë pasqyra).

Nr .	Data e proces verbalit konstatimit	Sipërfaqja e djegur Ha	Lenda drusore e gjetur	Demtuesi	Flet hyrjet e daljet
1	24.03.2022	1.5	0	Ska autor	-
2	04.11.2022	1.5	0	Ska autor	-
3	04.11.2022	1	0	Ska autor	-
4	04.11.2022	4	0	Ska autor	-
5	04.11.2022	6	0	Ska autor	-
6	03.11.2022	0.8	0	Ska autor	-
7	03.11.2022	3	0	Ska autor	-
8	03.11.2022	2	0	Ska autor	-
9	30.07.2022	0.3	0	Ska autor	-
10	18.07.2022	1.5	0	Ska autor	-
11	31.07.2022	4	0	Ska autor	-
12	22.03.2022	7.5	0	Ska autor	-
13	22.03.2022	7.5	0	Ska autor	-
14	24.03.2022	5	0	Ska autor	-
15	04.11.2022	0	10	Ska autor	-
16	28.10.2022	0	2	Ska autor	Drejtoria e Shërbimeve
17	20.10.2022	0	10	Ska autor	-
18	20.10.2022	0	118 (dëmtuar)	Ska autor	-
19	17.11.2022	0	0	Ska autor	-
20	03.10.2022	4	0	Ska autor	-
21	14.10.2022	0	0	Ska autor	-
22	31.07.2022	4	0	Ska autor	-

23	23.06.2022	0	5	Ska autor	-
24	30.07.2022	0.3	0	Ska autor	-
25	18.07.2022	1.5	0	Ska autor	-
26	23.06.2022	0	4	Ska autor	-
	Totali	55.4	118 +31 m3		-

Titulli i gjetjes: Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve.

Situata: Për vitin 2022 rezulton se nuk kanë lidhur kontrata për dhënie me qira të aseteve, si të atyre që janë me certifikatë regjistrimi nga ASHK dhe të aseteve që janë në përdorim me pretendimin “Se nuk ka kërkesa” por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se nga sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave nuk kanë asnjë rast të konstatuar në sipërfaqet kullosore në të 15 njësitë administrative, pra administrimi jo në shkallen e duhur, mbahet vetëm në evidencë në pasqyra financiare pa shfrytëzim real për të ndikuar në rritjen e të ardhurave, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve kryesisht të pyjeve dhe kullotave.

Sipas informacioneve të mara nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave rezulton se sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave administrohet nga 10 punonjës, sipas Vendimit Nr.14 datë 18.01.2022 të protokolluara në shkresën Nr.14 .Prot datë 18.01.2022 është miratuar struktura e Sektorit Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave nga Bashkia Dibër. Nga të dhënat rezulton se janë përgatitur programe vjetore, por të pa aprovuar dhe të pa protokolluar në Bashkinë Dibër. Në programin e punës ku përshkruhet “Për administrimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor publik në pronësi të Bashkisë Dibër rezulton:

-Programi nuk ka studim të mirëfilltë për problematikat që kanë dhe në pikat e programit nuk parashikohen afatet përkatëse sipas pikave të programuara.

-Nuk ka grup pune për të nxjerrë tematikat shqetësuese që janë evidente në program.

- Në 11 pikat e programit, përshkruhet termi “Brenda vitit pa lënë afate kohore dhe nuk ka nxjerrë përgjegjësi për detyrat e pa realizuara “si është vijueshmëria e programit dhe realizimi sipas pikave të programit”.

- Për mbrojtjen e pyjeve, biodiversitetin, mjedisi natyror dhe faunës së egër, rezulton se në pikën 2 të programit ku shprehimisht thuhet “Personeli i strukturës inspektuese /kontrolluese të ushtrijë kontrole të vazhdueshme për zbatimin e ligjshmërisë në fushën e pyjeve e të gjuetisë, kullotave e të bimëve aromatike mjekësorë dhe të bëjnë procedimet e fakteve e të vendosë para përgjegjësisë ligjore shkelësit e ligjit “rezulton se nuk ka asnjë rast ose autor të identifikuar gjatë vitit 2022.

- Nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave për aktivitetin e vitit 2022, në 26 raste janë mbajtur proces verbale të zjarrit në pyje “dëmtim pa autor” në një rast janë evidentuar 250 m linear rrugë e hapur “dëmtim pa autor”, dhe në një rast janë prerë 183 m³ dru zjarri “dëmtim pa autor”. Inspektorët e ruajtjes së pyjeve kanë mbajtur vetëm evidenca të situatës, pa evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës për dëmtimin e pyjeve dhe kullotave, duke mos marrë asnjë masë administrative në kundërshtim me nenin 10 “Dënim administrativ”, neni 46 Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar, neni 50 njoftimi i të tretëve i ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Kriteri: Ligji Nr. 57/2020 Për Pyjet dhe Kullotat (neni 16 dhe 38) i ndryshuar; ligji Nr.48/2016 “Për disa ndryshime dhe shtresa në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, “Neni 9 “Strukturat e shërbimit pyjor” pika 1 dhe 2; VKM 433, datë 8.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive e të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit ...” dhe sipas Rregullores të Bashkisë Dibër të aprovuar me vendimin nr.31.datë 05.02.2020 “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e

administratës së Bashkisë Dibër dhe njësive administrative” nenet 112, 113, 114 për “AMPK” Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, e ndryshuar me Rregulloren me Vendimin Nr. 101 datë 21.04.2022, e ndryshuar në nenin 116, 117, 118.

Ndikimi: Përdorimi i fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Dibër në kundërshtim me ligjin, që sjell tjetërsimin e asetëve të saj, pa pasur asnjë të drejtë mbi pronësinë apo kontratë mbi përdorimin e tyre. Përdorimi i fondit pyjor në mungesë të kontratave të qirave, gjithashtu sjell të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Dibër.

Shkaku: Mos njohja dhe zbatimi i dispozitave ligjore të përdorimit të fondit pyjor dhe fondit kullosor.

Rëndësia: E Lartë,

Rekomandimi 1: Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore dhe të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për të regjistruar dhe pajisur me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit.

Rekomandimi 2: Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për menaxhimin e asetëve të veta të kullotave, për të rritur të ardhurat sipas planifikimit në paketën fiskale të vitit 2022, në kapitullin dhe 2.8.2 dhe 2.8.3 “Tarifat dysHEME për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushritarinë” e kontratave.

Rekomandimi 3: Bashkia Dibër dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, të marrin masa dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore për ruajtjen, identifikimin e dëmtuesve dhe menaxhimin e kontrollin e pyjeve, duke mos funksionojë vetëm si drejtori evidentuese, por të menaxhojë asetet sipas ligjit të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parësë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi

Auditimi i drejtimit 3 të programit të auditimit nr. 872/1 prot, datë 10.10.2023, u krye në bazë të legjislacionit dhe dokumentacionit sa më poshtë:

- Pasqyrat financiare të vitit 2022;
- Libri i madh i llogarive;
- Ditari i Bankës;
- Ditari i Arkës;
- Ditari i Magazinës;
- Ditari i Pagesave
- Ditari i Veprimeve të ndryshme;
- Akt rakordimet me Degën e Thesarit Dibër;
- Inventarët;
- Dokumentacione të tjera justifikues.

Auditimi i këtij drejtimi u mbështet në bazën ligjore:

- Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin e sistemit financiar dhe kontrollin”;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi si më poshtë:

I. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike dhe Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

Për vlerësimin e Raportimit Financiar për vitin 2022, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi nga grupi u auditimit u verifikuan pasqyrat financiare të përgatitura nga Bashkia Dibër, nga ku rezultoi se pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) nr. 05, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”*”, të përbëra si vijon:

- Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar;
- Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);
- Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow), sipas metodës direkte;
- Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Format nr. 5 –Shënimet shpjeguese;

Pasqyrat statistikore:

- Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit;
- Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike);
- Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto);
- Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave .

Nga verifikimi i formës dhe formatit të raportimit të Pasqyrave Financiare rezultoi se, për nga forma, pasqyrat janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas formatit në aneksin nr. 2, të UMF nr. 5, datë 21.02.2022 dhe është plotësuar informacioni i kërkuar mbi njësinë, periudhën e raportimit, hartuesin e Pasqyrave Financiare, etj.

Në informacionet e pasqyruara në shënimet e kërkuara të pasqyrave rezulton se nga Bashkia Dibër është raportuar në nivel individual dhe **nuk janë përgatitur Pasqyra Financiare të Konsoliduara**, në nivel të vetëqeverisjes vendore për të gjitha njësitë e varësisë, për të dhënë një pamje të plotë të informacionit kontabël për periudhën raportuese në lidhje me aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare.

Bashkia Dibër ka 4 njësi publike vartësie(njësi ekonomike) të cilat janë si më poshtë:

- Njësia Ekonomike, Qendra Balneare Peshkopi,
- Njësia Ekonomike, Qendra Kulturore Dibër,
- Njësia Ekonomike, Shumësportesh Dibër,

- Njësia Ekonomike, Klubi i Futbollit Dibër.

Mos hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara është veprim në kundërshtim me shkronjën b, të pikës 101 të UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Pasqyrat Financiare të vitit 2022, rezultojnë të nënshkruara nga Zëvendës Kryetari i Bashkisë Dibër z. R. D., të cilit me anë të Urdhrit nr.94 “Delegim kompetencash për veprimet financiare”, datë 10.02.2023 i janë deleguar përgjegjësitë për veprimet financiare. Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Dibër me anë të shkresës përcjellëse nr.1316, datë 29.03.2023, në përputhje me kërkesat e pikës të 118 të Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.03.2018.

Në lidhje me rakordimet me degën e thesarit Dibër ka rezultuar se, në lidhje me pasqyrat financiare sipas Degës së Thesarit rezultojnë diferenca në paraqitjen e seksionit “Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre”, të cilat paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 1 “Diferencat në rakordimet mes Bashkisë Dibër dhe Degës së Thesarit Dibër për grupin “Mjete monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare” të Bilancit Kontabël”

Nr.	Ref e llogarisë	Shuma	
		PF Dibër	Sistemi i Thesar(SIFQ)
1	Disponibilitete në thesar	180,291,864	
2	Vlera të tjera	20,417,200	
Totali		200,709,064	

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se shuma 200,709,064 lekë në grupin “Mjete monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare”, paraqitet vetëm në pasqyrat e përgatitura prej Bashkisë Dibër, ndërsa në sistemin e Thesarit ky grup paraqitet 0 (zero), në lidhje me këto diferenca të cilat për pasojë bëjnë dhe mos rakordim të seksionit “Aktive Neto(A-B),” nga ana e Bashkisë Dibër **nuk janë kryer veprime** për sistemimin e menjëhershëm të tyre. Sistemimet e diferencave janë bërë gjatë vitit 2023, por **nuk ka dokumentacion** që faktin arsyet e diferencave të rezultuara në rakordimin e datës 09.03.2023, nga Dega e Thesarit Dibër janë konfirmuar shumat e disponibiliteteve në Thesar, që do të transferohen për vitin 2023, të cilat rakordojnë dhe konfirmojnë tepricat përfundimtare të “Mjete monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare”, të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022.

Pasqyrat Financiare janë depozituar pranë degës së Thesarit Dibër me anë të shkresës përcjellëse nr. 1316, datë 29.03.2023, të nënshkruar nga Zëvendës Kryetari i Bashkisë Dibër, z. R. D..

Pasqyra e Pozicionit Financiar e datës 31.12.2022

Aktivët:

I.Aktivët Afatshkurtra

Aktivët afatshkurta më datë 31.12.2022, paraqiten në vlerën **1,208,251,803 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 200,709,064 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 24,077,168 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 647,437,368 lekë.
- Llogaritë e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 408,028,203 lekë

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”

-Kjo klasë llogarie përbëhet nga llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar, e cila në fund të vitit 2022 është paraqitur në shumën 180,291,864 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 212,427,724 lekë dhe nga llogaria nr. 50 “Letra me vlerë”, e cila në fund të vitit 2022

paraqitet në shumën 20,417,200 ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 12,128,600 lekë, shumat e këtyre dy llogarive rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 224,556,324 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 200,709,064 lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

Rakordimi i llogarive me degën e thesarit

Për verifikimin e saktësisë së paraqitjes së llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare të vitit 2022, në shumën 180,291,864 lekë, nga grupi i auditimit u shqyrtua akt rakordimi me Degën e Thesarit Dibër, në të cilin kjo llogari analizohet si më poshtë:

Tabela nr. 2 “Llogaria analitike nr.520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin ushtrimor 2022”

Nr.	Përshkrimi	Shuma
I	Të ardhura që trashëgohen	23,920,817
II	Grant që trashëgohet	77,508,613
III	Totali që trashëgohet nga 2022 në 2023(I+II)	101,429,431
IV	Kreditorë për mjete në ruajtje 466	78,862,434
V	Mjete monetare dhe ekuivalentët e MM(III+IV)	180,291,865

Burimi i të dhënave: Bashkia Dibër, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se posti “Disponibilitete në thesar” është paraqitur drejtë, në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2023.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”

Llogaritë e klasës 3, në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Bashkisë Dibër përbëhen nga llogaria kontabël “Materiale”, “Inventar i imët” dhe “Mallra” të cilat i përkasin administratës së bashkisë dhe institucioneve nën varësi të Bashkisë Dibër, të cilat në total paraqiten në fund të vitit ushtrimor 2022 në shumën 24,077,168 lekë. Në mënyrë të detajuar llogaritë e klasës 3 paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3 “Inventari qarkullues”

Ref. llogarive	E M Ë R T I M I	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 22-21
Totali	2.Gjendje Inventari qarkullues	24,077,168	17,289,377	6,787,791
31	Materiale	12,480,846	8,259,264	4,221,582
32	Inventar i imët	10,338,860	8,690,670	1,648,190
35	Mallra	1,257,462	339,443	918,019

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Diferenca e kësaj klase llogarie me vitin e mëparshëm, përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 6,787,791 lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 6,787,791 lekë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se llogaritë e klasës 3 kanë dy destinacione fizike: Njësitë administrative (referuar si: *Institucionet*) dhe administrata e Bashkisë Dibër (referuar si: *Magazina*).

Për vitin 2022, është kryer inventarizimi i aktiveve afatshkurtra, bazuar në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Dibër nr.649 datë 15.11.2022, “Për ngritjen e komisionit për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të AQT dhe aktiveve qarkulluese për vitin 2022” nga inventarizimi fizik i aktiveve qarkulluese të administratës dhe në njësitë administrative (institucione) ka rezultuar si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4 “Evidenca mbi gjendjen faktike dhe kontabël të llogarive të klasës 3”

Nr.	Vendndodhja	31 “Materiale”		35 “Mallra”		32 “Inventar i imët”		Totali	
		Gj. Kont	Gj. Fizik	Gj. Kont	Gj. Fizik	Gj. Kont	Gj. Fizik	Gj. Kont	Gj. Fizik
1	Institucionet					8,867,676	8,867,676	8,867,676	8,867,676
2	Magazina	12,480,846	12,480,846	1,257,462	1,257,462	1,471,184	1,471,184	15,209,492	15,209,492

Totali	12,480,846	12,480,846	1,257,462	1,257,462	10,338,860	10,338,860	24,077,168	24,077,168
---------------	-------------------	------------	------------------	-----------	-------------------	------------	-------------------	------------

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër, rezulton se gjendja kontabile dhe fizike e kësaj klase llogarie përputhet me gjendjen e rezultuar nga inventarizimit fizik i realizuar në të dy vendndodhjet, ku ato bëjnë pjesë.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” dhe “Të tjera aktive afatshkurtra”

Llogaritë e klasës 4 në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet në total në shumën 647,437,368 lekë dhe përbëhet nga:

Tabela nr.5 “Detajimi i llogarive të klasës 4 në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022”

Ref llog	Emërtimi	2022	2021	Diferenca 22-21
	3.Llogari të Arkëtueshme	647,437,368	561,393,558	86,043,810
423429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	5,880,928	5,880,928	-
468	Debitorë të ndryshëm	92,341,800	89,156,027	3,185,773
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	549,214,640	466,356,603	82,858,037
	4.Të tjera aktive afatshkurtra	408,028,203	282,143,863	125,884,340
486	Shpenzime të periudhave të ardhme	408,028,203	282,143,863	125,884,340

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

- **Llogaria 423429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”**, në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022, paraqitet në shumën 5,880,928 lekë, shumë e cila është e njëjtë me atë të një viti më parë. Në mënyrë analitike kjo llogari paraqitet si në tabelën nr.6 të Aneksit nr. 3.

Titulli i gjetjes 1: Mos azhurnim në paraqitjen e llogarisë 423429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”

Situata: Nga verifikimi mbi saktësinë e paraqitjes së llogarisë nr.423429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, rezultoi se shuma 5,880,928 lekë përfaqëson detyrime të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në auditimin e vitit 2016, në lidhje me ish komunat dhe punonjësit e administratës.

Këto të drejta datojnë prej vitit 2016 dhe nga ana e Bashkisë Dibër **nuk janë marrë masa konkrete** për arkëtimin dhe vlerësimin e drejtë të tyre siç përcaktohet në pikën b të paragrafit 85 të SKK 5, ku përcaktohet se: “Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, njësi ekonomike do të vlerësojë shumën e rikuperueshme të aktivitetit...”. Nga Bashkia Dibër, nuk është bërë asnjë vlerësim për këtë klasë llogari, që të bëhet paraqitja e drejtë e saj, por, kjo shumë vijon të mbartet çdo vit e njëjtë në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Kriteri: Pika b e paragrafit 85 të SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, i përmirësuar.

Ndikimi/Pasoja: Mos vlerësimi i kësaj llogarie bën që shuma e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, të datës 31.12.2022 të mos tregojë të drejtat reale të njësisë, për të cilat njësi ka shpresa arkëtimi, kjo gjë sjell një mbivlerësim të AAJM-ve.

Shkaku: Mos vlerësimi në datën e raportimit të mundësive për arkëtimin e të drejtave.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtori ekonomik i Bashkisë Dibër, në bashkëpunim me strukturat e tjera të saj, të marrin masa për arkëtimin e të drejtave dhe pasi të jenë ezauruar të gjitha përpjekjet për vjeljen e saj, nga Drejtori ekonomik të

vlerësohet gjendja reale të llogarisë nr. 423429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, dhe ta paraqesë saktë shumën në Pasqyrat Financiare.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori Ekonomik, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare të vitit 2022, z. M. Sh..

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, pasqyron vlerën e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore ndaj Bashkisë Dibër dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 92,341,800 lekë, në krahasim me një vit më parë kjo shumë është rritur me 3,185,773 lekë, në mënyrë analitike kjo llogari paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.7 “Llogaria analitike nr.468”

2016						2022			Totali
Taksë Qera Trualli	Taksë qera ndërtese	Detyrime vendore	APP	Qera trualli	Institucion e Buxhetore	Taksa e tarifa vendore	Letra me vlerë	Debitorë kopshte e çerdhe	
4,201,092	1,819,728	7,104,359	1,250,000	58,710,570	889,140	11,403,160	5,220,631	1,743,120	92,341,800

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se debitorët total të vitit 2016 janë në shumën 73,974,889 lekë ose 80% e totalit të llogarisë 468, ndërsa debitorët e vitit 2022 janë në shumën 18,366,911 lekë ose 20% ndaj totalit dhe për këtë llogari **nuk është bërë vlerësim i mundësive** për arkëtimin e të drejtave, të mbaruara që prej vitit 2016.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet në shumën 549,214,640 lekë, dhe krahasuar me një vit më parë kjo shumë është rritur me 82,858,037 lekë. Kjo llogari paraqitet detyrimin, që shteti i ka Bashkisë Dibër për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Për vitin 2022 kjo llogari përbëhet nga pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore (të punëdhënësit dhe punëmarrësit), detyrimet për tatimin mbi të ardhurat(TAP), që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit 2022, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Gjithashtu ajo përmban detyrimet ndaj furnitorëve si dhe kreditorët e ndryshëm, llogari që paraqiten në pasiv të Bilancit Kontabël. Në mënyrë të detajuar kjo llogari paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 8 “Detajimi i llogarive të klasës 423429 në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022”

Ref Llog	Emërtimi	Shuma
42	Detyrime ndaj personelit	33,434,726
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa (TAP)	2,579,794
435	Sigurime Shoqërore	9,753,652
436	Sigurime Shëndetësore	1,342,964
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	94,075,301
467	Kreditorë të ndryshëm	408,028,203
Totali		549,214,640
Llogaria 4342 në Aktiv të BK		549,214,640
Diferenca		

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se, shuma e paraqitur në aktiv të Bilancit Kontabël nën zërin “Operacione me shtetin (Të drejta)” është sa shuma aritmetike e llogarive përkatëse (sipas tabelës më sipër) në pasiv të Bilancit Kontabël, kjo në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhme” në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet në shumën 408,028,203 lekë dhe është rritur me 125,884,340 lekë në krahasim me një vit më parë. Vlera e kësaj llogarie përfaqëson detyrime për shpenzime që do të kryhen në periudhat e ardhme, por të financuara në vitin ushtrimor. Kjo llogari, bazuar në pikën 42 të UMF nr.8/2018 ka si

kundërparti gjendjen e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila në pasiv të bilancit në fund të vitit 2022 paraqitet në të njëjtën shumë, pra 408,028,203 lekë.

Nga llogaritë analitike të kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga detyrime për:

- Procese gjyqësore;
- Shpenzime operative dhe
- Investime

Nga Bashkia Dibër, me anë të shkresës nr. 651, datë 28.02.2023 është raportuar në Degën e Thesarit Dibër në lidhje me detyrimet e prapambetura në shumën totale 408,028,203 lekë, shumë kjo e konfirmuar dhe nga Dega e Thesarit Dibër. Shuma e konfirmuar nga të dy palët është paraqitur dhe në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, të datës 31.12.2022 në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhme” dhe në kundërpartinë e saj llogaria nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, në pasiv.

Nga grupi i auditimit për verifikimin e saktësisë së paraqitjes së kësaj shume u analizua pasqyra e lëvizjeve të shpenzimeve të periudhave të ardhme për tre grupet e saj: “Shpenzime për investime”, “Shpenzime operative” dhe “Shpenzime për vendime gjyqësore”, nga ku rezultoi se shuma e llogarie analitike të llogarisë 468 nuk rezulton të jetë e barabartë me shumën e llogarisë sintetike të paraqitur në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022, diferenat paraqiten më poshtë:

Tabela nr. 9: “Lëvizja e llogarisë 468 dhe paraqitja sipas Degës së Thesarit Dibër”

Sipas llogarive analitike të llogarisë 468						II.Dega Thesar	Diferenca(I-II)
Nr.	Përshkrimi	Shuma më fillim të vitit	Shtesa 22	Pakësime 22	I.Gjendja në fund 22		
1	Detyrime investime	89,997,289	671,278,326	412,242,994	349,032,621	350,034,351	-1,001,730
2	Detyrime për vendime gjyqësore	90,326,771	11,291,271	71,354,999	30,263,043	30,263,042	1
3	Detyrime për shp. operative	8,911,892	49,785,019	30,966,101	27,730,810	27,730,810	0
Totali		189,235,952	732,354,616	514,564,094	407,026,474	408,028,203	-1,001,729
Në Bilancin Kontabël 31.12.22		282,143,863			408,028,203	408,028,203	
Diferenca		92,907,911.1			1,001,729.1		

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se “Detyrimet për investime”, bazuar në ndryshimet përgjatë vitit 2022 duhet të ishin në shumën 349,032,621 lekë, ndërsa nga Dega e Thesarit Dibër dhe nga Bashkia Dibër kjo shumë është raportuar e mbivlerësuar me 1,001,730 lekë, pra në shumën 350,034,351 lekë duke sjellë për pasojë një mbivlerësim të klasës së llogarisë nr. 468 “Shpenzime të periudhave të ardhme” në shumën 1,001,729 lekë.

AKTIVET AFATGJATA

Aktivët Afatgjatë Jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët Afatgjatë Jo materiale”, përbëhen nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 29,436,281 lekë në fund të vitit 2022 dhe në shumën 34,630,920 lekë në fund të vitit 2021. Shumë kjo e paraqitur e njëjtë dhe në Pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)”. Në mënyrë të detajuar lëvizjet e kësaj llogarie paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.10: “Lëvizja e llogarisë Studime dhe kërkime”

Në lekë

Ref Llog	Teprica në fillim			Shtesa gjatë vitit		Pakësime gjatë vitit		Teprica në fund		
	Kosto historike	Am.akum	Teprica në fund	Kosto historike	Amortizim	Kosto historike	Amortizim	Kosto historike	Amortizim	Teprica neto
20	56,390,670	21,759,750	34,630,920	0	5,194,638	0	0	56,390,670	26,954,388	29,436,282
202	56,390,670	21,759,750	34,630,920	0	5,194,638	0	0	56,390,670	26,954,388	29,436,282

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, përgjatë vitit 2022 nuk ka pasur shtesa dhe pakësime, por pakësimi nga një vit më parë vjen si rezultat i llogaritjes së amortizimit vjetor me normën 15% mbi Vlerën Kontabël Neto (VKN) të një viti më parë.

Në mënyrë analitike, llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”, paraqitet në tabelën nr. 11 “Llogaritë analitike të Studime dhe Kërkime”, të Aneksit nr. 3,

Titulli i gjetjes 2: Mangësi në mbajtjen dhe paraqitjen e evidencave analitike të llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”

Situata: Nga verifikimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime” rezultoi se:

- Analitiku i kësaj llogarie përbëhet, nga 78 Projekte të Bashkisë Dibër me kosto historike në shumën 56,390,670 lekë, nga të cilat 38 projekte nuk kanë të përcaktuar vitin në të cilin janë krijuar, emërtimet në disa raste janë të padetajuara, duke mos mundësuar përcaktimin e saktë të destinacionit apo qëllimit të kryerjes së tyre dhe në një rast emërtimi mungon. Për projektet, që kanë të përcaktuar vitin e krijimit rezulton se, i përkasin periudhës 2009-2013 dhe grupi tjetër ka shënimin: “Të mbartura nga 2016”. Për këto aktive nuk ka një regjistër kontabël, ku të specifikohen për secilin prej tyre të dhënat si: përshkrimet e studimeve dhe projekteve, vitin e krijimit, shtesat e bëra ndër vite, etj. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 26 të Udhëzimit të MFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku përcaktohet se: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, dhe me pikën 30, të Udhëzimit të sipërcituar ku përcaktohet se: “.... Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.
- Në lidhje me këtë llogari, amortizimi vjetor është bërë me normën 15%, siç përcaktohet në pikën 36 d, të UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, por norma e amortizimit është llogaritur në grup mbi VKN-në e një viti më parë dhe mungon pasqyra analitike e amortizimit për çdo zë të veçantë, siç kërkohet në pikën 30 të UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Në lidhje me 78 projektet, pjesë e llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime” mungon një analizë e detajuar e tyre dhe nuk është kryer verifikim për të përcaktuar statusin e tyre nëse janë finalizuar apo jo dhe në rastet e finalizimit, të kryhen procedurat e mbylljes për këto llogari, siç përcaktohen në kapitullin 3.2 të UMFE nr.8/2018.
- Pika 26, 30 e UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Kapitulli nr.3.2 i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë

Kriteri:

09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Ndikimi/Pasoja: Mosanalizimi zë për zë i llogarive analitike të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, bën që llogaria të paraqitet e mbivlerësuar, ndërsa aktivet për të cilat janë kryer studimet dhe janë finalizuar projektet paraqiten me kosto të nënvlerësuar, gjë e cila ndikon më tej dhe në shumat e amortizimit vjetor, që do të njihen si shpenzime në vijim.

Shkaku: Mos mbajtja e kartelave analitike, për çdo zë dhe mungesa e analizës dhe verifikimit për çdo element të kësaj pasqyre.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e çdo zëri të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime”, që të mundësohet përcaktimi i statusit të tyre dhe nga Drejtori ekonomik pas evidentimit të projekteve të finalizuara dhe statusit të çdo zëri, të kryhen regjistrimet kontabile në lidhje me kapitalizimet në aktivet përkatëse apo çregjistrimet sipas rastit.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori Ekonomik, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare të vitit 2022, z. M. Sh..

AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, sipas Bilancit Kontabël, të datës 31.12.2022 paraqiten në shumë totale 4,149,006,785 lekë, ndërsa një vit më parë në shumën 4,273,858,283 lekë, me një pakësim të AAM-ve në shumën 124,851,498 lekë.

Tabela nr.12: “Klasa e llogarive 21”

Ref. llogarive	EMËRTIMI	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 22-21
21	2.Aktive Afatgjata materiale	4,149,006,785	4,273,858,283	124,851,498
210	Toka, T,roje, Terene	28,394,404	28,394,404	-
211	Pyje, Plantacione	1,268,000	1,268,000	-
212	Ndertesa e Konstruksione	819,762,408	856,562,972	36,800,564
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	3,063,938,252	3,142,695,485	78,757,233
214	Instalime teknike, makineri e paisje	79,755,787	83,953,460	4,197,673
215	Mjete Transporti	38,145,047	38,237,481	92,434
218	Inventar ekonomik	117,742,887	122,746,481	,003,594

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Sipas informacionit të marrë nga pasqyra statistikore 7b, rezulton se Vlera Kontabël Neto gjatë vitit 2022 ka ndryshuar si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.13: “Lëvizjet e llogarisë 21 gjatë vitit 2022”

Në lekë

Ref e llog	Emërtimi	I.VKN në fillim	II. Shtesa 2022	III.Baza për llogaritje e amortizimit(I+II)	Am vjetor ¹⁴	NA	VKN ne fund te periudhës
210	Toka, troje, Terrene	28,394,404		28,394,404	-	0%	28,394,404
211	Pyje,Kullota Plantacione	1,268,000		1,268,000	-	0%	1,268,000
212	Ndërtime e Konstruksione	856,562,972	6,344,826	862,907,798	43,145,390	5%	819,762,408
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	3,142,695,485	82,502,673	3,225,198,158	161,259,906	5%	3,063,938,252
214	Instalime teknike, makineri	83,953,460		83,953,460	4,197,673	5%	79,755,787
215	Mjete transporti	38,237,481	1,915,200	40,152,681	2,007,634	5%	38,145,047
218	Inventar ekonomik	122,746,481	1,193,400	123,939,881	6,196,994	5%	117,742,887
Totali		4,273,858,283	91,956,099	4,365,814,382	216,807,597		4,149,006,785

Burimi i të dhënave: Pasqyrës statistikore 7/b, Përpunuar nga grupi i auditimit.

¹⁴ Llogaritur si diferencë e kolonës “Amortizim i akumuluar në fund të periudhës” me kolonën “Amortizim i akumuluar në fillim të periudhës”, pjesë të pasqyrës Formati 7/b.

Nga dy tabelat më sipër rezulton se Vlera Neto Kontabël e zërave të kësaj klase llogarie përputhet me vlerat e paraqitura në formatin e pasqyrës statistikore 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”.

Llogaritë në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Llogaria nr.210 “Toka, troje, terrene” në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet me vlerë neto 28,394,404 lekë dhe është e pa ndryshuar krahasuar me një vit më parë. Në mënyrë analitike kjo llogari paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.14: “Llogaria analitike”Toka, Troje, terrene”

Viti i njohjes	212 "Toka troje, terrene"	vlera
2008	Shpronësim Trualli Shkolla e Mesme + Konvikti	27,500,000
2013	Rruga për tek Gjinnazi i Ri	894,404
Totali		28,394,404

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se llogaria 210 “Toka, Troje dhe terrene” përbëhet nga 2 zëra të njohur përkatësisht në vitin 2008 dhe 2013. Në lidhje me këto dy zëra nuk është bërë amortizimi i tyre, kjo në përputhje me paragrafin 58 të SNK 16 “Aktivet Afatgjata Materiale”, ku përcaktohet se: “Me pak përjashtime të tilla si guroret dhe vendet e përdorura për mbushje, toka ka jetë të dobishme të pakufizuar dhe prandaj **nuk amortizohet**”.

Llogaria nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione” paraqitet me vlerë neto 1,268,000 lekë në fund të vitit 2022 dhe është e pa ndryshuar prej viti 2017. Llogaria analitike e llogarisë nr.211 përbëhet nga fidanë të ndryshëm, që rezultojnë të kontabilizuara që prej vitit 2017, në mënyrë të detajuar paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.15: “Llogaria analitike nr.211”

NR	Emërtimi	VITI	Kosto historike
1	Fidanë dekorativë	2017	1,070,000
2	Fidanë dekorativë vjeshte	2017	80,000
3	Fidanë dekorativë blini	2017	60,000
4	Fidanë dekorativë panje	2017	40,000
5	Fidanë dekorativë gledicje	2017	18,000
Totali			1,268,000

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën kontabël neto 819,762,408 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 856,562,972 lekë. Sipas formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 1,362,498,404 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2021 1,356,153,578 lekë, pra me shtesë në shumën 6,344,826 lekë.

Në mënyrë analitike llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” përbëhet nga 252 zëra ndërtesash dhe konstruksionesh. Llogaria analitike e kësaj llogarie paraqitet si në tabelën nr. 16 të aneksit nr. 3.

Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 3,063,938,250 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 3,142,695,485 lekë. Sipas formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 4,024,612,085 lekë, me shtesa në vitin 2022 në shumën 82,502,673 lekë, dhe gjendje në fund të vitit në shumën 4,107,114,758 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur ndryshimet e pozicioni i kësaj llogarie paraqitet i në tabelën më poshtë:

Analitiku i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përbëhet nga 181 objekte.

Tabela nr.17: “VKN e llogarisë nr.213 sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit”

Emërtimi	Sipas llogaritjeve të KLSH
Kosto historike në fillim të periudhës	4,024,612,085
Amortizim i Akumuluar	881,916,600
VKN në fillim të periudhës	3,142,695,485
Shtesa gjatë vit	82,502,673

Pakësime gjatë vitit	-
Kosto historike në fund të vitit	4,107,114,758
Amortizimi i vitit	161,259,908
Amortizimi i Akumuluar në fund	1,043,176,508
VKN në fund të periudhës	3,063,938,250

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga verifikimet e bëra mbi këtë klasë llogarie ka rezultuar se:

- Vlerat përkatëse të kësaj llogarie në pasqyrat 7a dhe 7b janë paraqitur saktë.
- Amortizimi vjetor është llogaritur me normën 5% mbi VKN në fillim të periudhës dhe shtesave të bëra gjatë vitit %, kjo në përputhje me pikën të UMF nr.8/2018, të ndryshuar;

Llogaria nr.214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 79,755,787 lekë ndërsa në fund të vitit 2020 në vlerën neto 83,953,460 lekë. Sipas pasqyrës statistikore Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2022 dhe në fund të vitit 2021 kosto historike paraqitet e njëjta, ç’ka do të thotë që gjatë vitit 2022 nuk ka pasur shtesa as pikësime, konkretisht në shumën 97,914,537 lekë.

Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet në vlerën kontabël neto 38,145,047 lekë. Sipas Pasqyrës Statistikore Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fillim të vitit 2022 kosto historike e kësaj llogarie paraqitet në shumën 79,289,743 leke ndërsa në fund të vitit 2022 në shumën 81,204,943 lekë pra shtesat gjatë vitit kanë qenë në shumën vitit 2019 paraqitet në koston historike prej 62,836,745 lekë dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 62,836,745 lekë, e pa ndryshuar. Nga Bashkia Dibër, për këtë llogari mbahet regjistër kontabël.

Llogaria nr.218 “Inventar ekonomik”, në Bilancin kontabël të datës 31.12.2022 kjo llogari paraqitet në shumën 117,742,887 lekë.

Inventarizimi i aktiveve për vitin ushtrimor 2022

Në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Kryetari i Bashkisë Dibër është nxjerrë urdhri nr.649, datë 15.11.2022 “Për ngritjen e komisionit për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe Qarkulluese për vitin 2022.” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 vetëm për aktivet e klasës “Inventar qarkullues”, ndërsa për aktivet Afatgjata materiale (AQT) nuk është ndërmarrë asnjë proces inventarizimi fizik nga ana e Bashkisë Dibër.

Në relacionet e hartuara nga komisionet përkatëse për kategorinë e aktiveve qarkulluese, nuk paraqiten diferenca mes gjendjes kontabile dhe fizike.

Titulli i gjetjes 3: Pasaktësi në paraqitjen dhe vlerësimin e llogarive të klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”

Situata: Nga verifikimi i bërë për saktësinë e paraqitjes së llogarive të klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale(AAM)” kanë rezultuar disa pasaktësi, që paraqiten si më poshtë:

Për llogarinë nr.210 “Toka, troje, terrene” rezultoi se:

- Nuk është kryer rivlerësim i tyre, veprim ky në kundërshtim me paragrafin 22 të SKK 5 ku përcaktohet se: *“Frekuenca e rivlerësimeve varet nga ndryshimet në vlerat e drejta të AAM-së që rivlerësohen. Kur vlera e drejtë e një aktivi të rivlerësuar ndryshon materialisht nga vlera kontabël, atëherë nevojitet të kryhet një rivlerësim tjetër ... Për këtë*

kategori është i mjaftueshëm një rivlerësim në çdo tre ose pesë vite”.

Për llogarinë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, rezultoi se:

- Bashkia Dibër nuk ka një regjistër kontabël për Ndërtesat dhe konstruksiionet, siç përcaktohet në pikën 30 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, *për pjesën më të madhe të tyre nuk zotërohet informacion mbi vitin e momentin fillestar të njohjes, dhe shtesat e pakësimit për secilin zë më vete.*

- Amortizimi për këtë klasë llogarie bëhet në grup dhe jo për çdo zë më vetë, dhe shtesat e vitit 2022 amortizimi është llogaritur i plotë për 12 muaj, pasi nuk detajohet në mënyrë specifike muaji i saktë kur ka ndodhur shtesa.

- Në listën analitike të llogarisë “Ndërtesa dhe Konstruksiione” **3 zëra janë pa emërtim, shuma e të cilave është 4,415,705 lekë.** Mos emërtimi i këtyre zërave, dhe mungesa e informacioneve të detajuara sipas formatit të regjistrit kontabël të AAM nuk mundëson dhënien e një pamje të plotë në lidhje me këtë klasë llogarie dhe e bën të pamundur identifikimin fizik të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 26, 28, 30 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nga Bashkia Dibër nuk është ndërmarrë asnjë procedurë për rivlerësimin e tyre, për të mundësuar paraqitjen me vlerë reale. Kostot me të cilat këto zëra rezultojnë në listën analitike janë sa kostove fillestare në momentin e njohjes, veprim ky në kundërshtim me paragrafin 22 të SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”.

Për llogarinë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezultoi se:

- Për shtesat e bëra për këtë klasë llogarie gjatë vitit 2022, amortizimi është bërë për vitin e plotë duke mos i'u referuar datës së saktë të njohjes së tyre në kontabilitet.

- Amortizimi mbi këtë klasë llogarie është bërë në grup dhe jo për çdo zë;

- Në lidhje me llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” nuk është mbajtur regjistër kontabël;

- Lista e detajuar me zërat e kësaj llogarie përbëhet nga 418 objekte, nga ku për 47 prej tyre nuk përcaktohet momenti i njohjes fillestare, në një rast mungon emërtimi, por paraqitet shënimi “Pa Analizë”.

- Në listën analitike të llogarisë nr.213 ka gjithashtu dhe 17 zëra, me kosto historike, në total 10,752,249 lekë, të njohura në vitin 2016 si “Shërbime mirëmbajtje”, për të cilat nuk paraqiten detaje nëse plotësojnë kushtet për t'u njohur si AAM më vete apo duheshin konsideruar shpenzime ushtrimore, as shënimet shpjeguese nuk reflektojnë detaje mbi njohjen e tyre. Veprimi i njohjes së tyre si zë më vete duke mos rritur koston e aktivitetit për të cilin janë bërë ose mosnjohja si shpenzim ushtrimor është në kundërshtim me paragrafin 43 të SKK 5 “AAM”, ku përcaktohet se: *“Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëposhme i shtohen koston e AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar (duke përfshirë këtu aftësinë e tyre për të marrë pjesë në gjenerimin e përfitimeve të ardhshme ekonomike). Kostot*

që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor”.

Për llogarinë nr.214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”, rezultoi se:

- Lista analitike e kësaj llogarie përmban zëra të cilat nuk duhen kategorizuar si “Instalime teknike, makineri dhe pajisje”, lista përmban elementë si: tavolina, dollapë, pjesë për laboratorët e shkollave, depozita, kompjuterë, etj, të cilat nuk konsiderohen si aktive (makineri, instalime dhe pajisje) afatgjata për të cilat duhet aplikuar norma e amortizimit 5%. Klasifikimi i pasaktë i elementëve të kësaj kategorie ka ndikuar dhe llogaritjen e amortizimit, ku rezultoi të jetë përdorur norma e amortizimit e vjetor 5% dhe jo 20%, në kundërshtim me pikën 36, të UMFE nr.8/2018. Si rezultat i aplikimit të pasaktë të normës së amortizimit vjetor, shpenzimet e amortizimit për këtë klasë llogarie janë nënvlerësuar me 12,593,019 lekë, ndërsa vlera kontabël neto e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të datës 31.12.2022 e llogarisë “Instalime teknike”, makineri e pajisje” paraqitet e mbivlerësuar me 12,593,019 lekë;

- Për këtë klasë llogarie nuk ka një regjistër kontabël siç përcaktohet në pikën 30 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku të specifikohet për çdo zë gjendja fillestare shtesat dhe pakësimet;

- Përllogaritja e amortizimit vjetor për këtë llogari është bërë duke aplikuar normën e pasaktë të amortizimit, në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe jo mbi çdo zë por në grup.

- Nga ana e bashkisë Dibër nuk është kryer ndonjë proces verifikimi fizik mbi zërat e kësaj llogarie për të konfirmuar ekzistencën dhe kushtet e tyre.

Për llogarinë nr.215 “Mjete transporti”, rezultoi se:

- Nga Bashkia Dibër për amortizimin e kësaj llogarie është përdorur norma vjetore e amortizimit 5% dhe jo 20%, në kundërshtim me pikën 36 të UMF nr. 8/2018, si rezultat i mos aplikimit të normës së duhur të amortizimit, shpenzimet e amortizimit vjetor paraqiten të nënvlerësuar me 6,022,902 lekë, ndërsa Vlera Kontabël Neto e llogarisë 215 “Mjete Transporti” në Pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqitet e mbivlerësuar me diferencën e mosllogaritjes saktë të amortizimit;

- Në lidhje me këtë klasë llogarie nga ana e Bashkisë Dibër nuk është ndërmarrë asnjë proces inventarizimi, në listën analitike ka mjete, që kanë si vit të njohjes së tyre periudha shumë të hershme, konkretisht për 9 mjete transporti nuk është identifikuar viti i njohjes, 1 mjet rezultoi të jetë regjistruar 42 vite më parë; 6 mjete mbi 30 vite, 5 mjete mbi 20 vite. Ç’ka tregon se nga ana e Bashkisë Dibër nuk janë marrë masa për verifikimin e tyre fizik për të konfirmuar funksionimin e tyre real dhe për të siguruar paraqitjen e saktë të vlerës në pasqyrat financiare.

Për llogarinë nr.218 “Inventar ekonomik”, rezultoi se:

- Norma e përdorur e amortizimit për këtë klasë llogarie është 5% dhe jo 20%, në kundërshtim me pikën 36, të UMFE 8/2018 e për pasojë në

pasqyrat financiare të vitit 2022 kemi një nënvlerësim të shpenzimeve të amortizimit dhe mbivlerësim të llogarisë nr. 218 “Inventar Ekonomik”, në shumën 18,590,982 lekë;

- Në lidhje me këtë klasë llogarie nuk ka një regjistër kontabël sipas specifikimeve të bëra në pikën 11 të UMF, dhe amortizimi i llogarisë bëhet në grup duke aplikuar normën e amortizimit mbi VKN e llogarisë sintetike.

- Kriteri:**
- Pika 26, 28, 30 të UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”
 - Pika 36 i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.
 - Paragrafi 22 i SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.
- Ndikimi/Pasoja:**
- Aplikimi i pasaktë i normave të amortizimit vjetor, nënvlerëson shpenzimet vjetorë të amortizimit dhe nënvlerëson vlerat e AAM-ve të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022.
 - Mos mbajtja e regjistrave kontabël në lidhje me aktivet afatgjata materiale, vështirëson procesin e identifikimit fizik të tyre dhe nuk mundëson krahasimin e vlerës kontabile me atë fizike, duke vënë në dyshim pohimin e ekzistencës së tyre.
 - Mos rivlerësimi i AAM-së, bën që aktivet të mos paraqesin në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022, vlerën e drejtë.
- Shkaku:** Mosrivlerësimi i AAM-ve mos mbajtja e regjistrave kontabël për secilën klasë llogarie dhe aplikimi i pasaktë i normave vjetore të amortizimit.
- Rëndësia:** E lartë.
- Rekomandimi:**
- Titullari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për të kryer inventarizimin fizik të AAM-ve dhe në rast se është e nevojshme të kryhen procedurat e nxjerrjes nga përdorimit për aktivet e papërdorshme.
 - Drejtori ekonomik i Bashkisë Dibër të marrë masa për krijimin e regjistrave kontabël në lidhje me çdo klasë të AAM-ve dhe të kryejë veprimet konatabile për korrigjimin e regjistrimeve të gabuara në lidhje me amortizimet, sipas SKK-ve në fuqi.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori Ekonomik, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare të vitit 2022, z. M. Sh..

Investime

Llogaritë e klasës 4 “Investime” përbëhen nga dy llogari: “Investime për AAJM” dhe “Investime për AAM” të cilat në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.18: “Llogaritë e klasës 4 të Bilancit Kontabël të datës 31.12.2022”

Ref. Llogarisë	Përshkrimi	2022	2021	Diferenca
	4.Investime	1,275,277,614	789,127,785	486,149,829
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	43,625,665	41,625,665	2,000,000
231	Per Aktive Afatgjata materiale	1,231,651,949	747,502,120	484,149,829

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

-Llogaria nr.230 “Për aktive afatgjata jo materiale” paraqet në bilancin kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet në vlerën 43,625,665 lekë dhe krahasuar me një vit më parë është rritur në

shumën 2,000,000 lekë. Lista analitike e kësaj llogarie paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.19: "Lista analitike e llogarisë nr. 230"

Nr	Përshkrimi	AAM	Vlera
1	Shërbim Projekt zbatimi I objektit Rikonstrukcion I Rrugës kryesore Ish NBSH ish SMT	Rrugë	1,380,286
2	Shërbime projektimi zbatimi sistemim asfaltim rrugës Peshkopi Rabdisht	Rrugë	476,857
3	Shërbim projektimi zbatimi për hartimin e projektit me objekt Ndërtimi I rrugës se Lurës	Rrugë	8,976,000
4	Hartimi I projektit me objekt: Sistemim asfaltim rrugëve fshatave Shumbat,Dypjeke,Silove	Rrugë	2,000,000
5	Shërbim projekt zbatim Ndërtimi I Ujësjetës të Gramës	Ujësjetës	878,070
6	Hartimi i projektit me objekt Rikonstrukcion kryesor i furnizimi me ujë nga burimet e Radomires	Ujësjetës	19,547,999
TOTALI			33,259,212

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga verifikimi i llogarisë analitike dhe shifrës në Bilancin kontabël të datës 31.12.2022 rezulton se shuma e llogarive analitike të detajuara është 33,259,212 lekë, ndërsa diferenca nga vlera e paraqitur në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 **prej 10,366,453 lekë është e paanalizuar**, sipas arsyesimit të dhënë nga subjekti të evidentuar dhe në raportin e auditimit të KLSH-së të vitit 2022, rezulton se kjo vlerë është mbartur prej kontabilizimit jo të saktë të bërë në pasqyrat financiare të vitit 2018, ku "Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara" të regjistruara në vitin 2017 janë regjistruar në vitin 2018 në llogarinë 203 "Koncesione, licenca e të tjera të ngjashme", pa pakësuar llogarinë 230 "Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara". Nga Bashkia Dibër, **nuk janë marrë masa për sistemimin** e këtij veprimi dhe pse është evidentuar dhe në raportin e auditimit të KLSH-së për vitin 2021.

Nga shuma prej 33,259,212 lekë, 12,833,143 lekë janë për rrugë dhe pjesa e mbetur për 20,426,069 lekë janë për ujësjetës.

Në vitin 2022 kjo llogari nuk ka pasur pakësime, pra projekte të përfunduara dhe ka pasur vetëm një shtesë në shumën 2,000,000 lekë të paraqitur në rreshtin 4 të tabelës më sipër, që lidhet me AAM "Rrugë".

Llogaria nr.231 "Për Aktive Afatgjata materiale", ka të bëjë me shpenzime për rritjen e Aktiveve Afatgjata të Trupëzuara dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 1,231,651,949 lekë prej 2,838,228 lekë ose 484,149,829 lekë më shumë se një vit më parë. Llogaria analitike e kësaj llogarie paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.20: "Llogaria analitike nr.231"

N r	Përshkrimi I aktiveve	Llog.ekonomik e	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Totali
1	Infras.vaditjes	231	2,611,769	778,961			4,096,620	7,487,350
2	Rruge rurale e urbane	231	9,121,373	4,812,144		448,485	53,648,975	68,030,977
3	Shërbime	231	126,043	310,761				436,804
4	Ndërtesa	231	546,440	634,364	38,642,113		19,859,610	59,682,527
5	Ujësjetës	231			278,468,667	198,310,131	422,944,624	899,723,422
Totali			12,405,625	6,536,230	317,110,780	198,758,616	500,549,829	1,035,361,080
PA ANALIZË								196,290,869
Në BK 31.12.2022								1,231,651,949
Diferenca								196,290,869

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se shifra e paraqitur në bilancin kontabël dhe totali i llogarive analitike ka një diferencë në shumën 196,290,869 lekë dhe për këtë zë nuk ka analizë të bërë apo detajim nga ana e Bashkisë Dibër, veprim ky në kundërshtim me pikat 26, 28, 30 dhe me pikën 75, Kreu IV, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, dhe më pikën 5 Kreu II dhe pika 30, Kreu III e Udhëzimit të MFE-së nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Nga sqarimet e bëra nga Bashkia Dibër dhe të paraqitura dhe në raportin e Auditimit të KLSH-së për vitin 2021, arsyeja e mbetjes së kësaj vlere të paanalizuar vjen pasi kjo shumë është regjistruar në PF të vitit 2017 në llogarinë 231, "Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara" dhe në

pasqyrat financiare të vitit 2018 është regjistruar në llogaritë ekonomike 212 “Ndërtesa”, 213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” në mënyre analitike si gjendje në fillim të vitit 2018, ndërkohë që nuk është pakësuar llogaria 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”. Nga ana e Bashkisë Dibër **nuk janë marrë masa për sistemimin e këtij veprimi.**

Pakësimet e kësaj llogarie vinë si rezultat i përfundimit të investimeve dhe për pasojë kreditohet llogaria 231 “Investime në proces” dhe debitohe llogaritë përkatëse të AAM-vë. Për vitin 2022 kanë përfunduar dhe janë kapitalizuar shumat e mëposhtme:

Tabela nr.21: “Investimet e përfunduara për vitin 2022”

N R	LLOG	Kodi projekt	231 Kredi	213 Debi	212 Debi	218 Debi	215 Debi
1	2313100	1060201	51,995,000	51,995,000			
2	2313100	1060246	18,666,630	18,666,630			
3	2313100	1060219	680,971	680,971			
4	2313100	1060301	1,191,492	1,191,492			
5	2312103	1060258	288,573	288,573			
6	2310000	1060255	1,509,960	1,509,960			
7	2313100	1060278	72,800	72,800			
8	2312103	1060258	197,548	197,548			
9	2313400	1060256	7,065,279	7,065,279			
10	2313400	1060265	834,420	834,420			
11	2312103	1060049	1,864,504		1,864,504		
12	2312104	1060251	4,480,322		4,480,322		
13	2,314,320	1,060,299	1,193,400				
14	2,314,260	1,060,244	1,915,200			1,193,400	1,915,200
Totali			91,956,099	82,502,673	6,344,826	1,193,400	1,915,200

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se pakësimet e llogarisë 231 kanë shkuar në shtimin e AAM-ve si më poshtë:

- Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është shtuar me 82,502,673 lekë;
- Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione” është shtuar me 6,344,826 lekë;
- Llogaria 215 “Mjete Transporti” është shtuar me 1,915,200 lekë;
- Llogaria 218 “Inventar Ekonomik” është shtuar me 1,193,400 lekë;

Veprimet e mësipërme janë kapitalizuar tek klasa e aktiveve afatgjata materiale, në përputhje me pikën 18 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ku përcaktohet se: “Me kapitalizimin e aktiveve bëhet verimi kontabël në debi të llogarive përkatëse të grupit 20 dhe 21 të aktiveve afatgjata në kredi të llogarive përkatëse të grupit 23, llogaritë e investimeve”.

PASIVET (DETYRIMET)

Gjendja e llogarive të pasivit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Bashkisë Dibër, më 31.12.2022 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.22: “Pasivi i Bilancit Kontabël të Bashkisë Dibër më 31.12.2022”

Nr.	Ref e llog	Emërtimi	2022	2021	Diferenca
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	726,299,802	613,303,937	112,995,865
66		I.Pasivet Afat shkurtër	726,299,802	613,303,937	112,995,865
67		1. Llogari te Pagushme	726,299,802	613,303,937	112,995,865
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	94,075,301	145,882,769	-51,807,468
69	42	Detyrime ndaj personelit	33,434,726	27,594,592	5,840,134
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,579,794	1,481,759	1,098,035
75	435	Sigurime Shoqërore	9,753,652	8,134,348	1,619,304
76	436	Sigurime Shëndetësore	1,342,964	1,119,272	223,692
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	78,862,434	51,910,379	26,952,055
82	467	Kreditore te ndryshëm	408,028,203	282,143,863	125,884,340
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	98,222,728	95,036,955	3,185,773

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Dibër më datë 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt organeve tatimore për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (TAP), sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm dhe llogaria “Operacione me shtetin”.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet në shumën 94,075,301 lekë dhe krahasuar më një vit më parë është ulur më 51,807,468 lekë. Kjo llogari paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Dibër. Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 94,075,301 lekë përbëhet nga fatura të palikuiduara për të muajit nëntor dhe dhjetor të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.23 : “Llogaritë analitike të llogarisë Furnitorë”

Emri Furnitorit/ Kreditorit	Dt faturës	Shuma
K.	16.11.2022	671,328
	30.11.2022	627,984
	12.12.2022	574,164
	15.12.2022	296,651
A. Ç.	15.12.2022	780,000
M.V.	29.11.2022	598,800
D.	14.12.2022	460,800
	25.12.2022	620,910
R.R.	18.11.2022	871,200
F.T.	07.12.2022	970,000
A.K.	23.12.2022	978,000
T.Ç	22.11.2022	479,640
	08.11.2022	187,018
	05.12.2022	152,535
K.V.	02.12.2022	119,760
S.V.	01.11.2022	9,336,000
	12.12.2022	4,621,320
B.	01.12.2022	99,700
N.Ll.	07.12.2022	99,000
S.	16.11.2022	15,202
P.Ll.	22.11.2022	99,000
E.	29.12.2022	381,600
A.	27.12.2022	119,000
Z.	16.12.2022	119,905
	16.12.2022	119,800
	29.12.2022	119,484
N.	17.11.2022	2,373,526
V.H.	03.11.2022	709,860
	29.12.2022	589,236
Sh.N.	19.12.2022	155,294
	21.12.2022	154,890
A.Gj.	08.12.2022	242,055
	01.11.2022	206,910
B.E.	30.12.2022	431,880
Sh.A Ujesjellesi	31.12.2022	549,618
A.	30.11.2022	65,889
	31.12.2022	64,938
FSHU	31.12.2022	1,970,740
A.	20.12.2022	1,150,000
Sh. sh.p.k	30.11.2022	4,128,000
E. shpk	27.12.2022	2,988,000
B. shpk	23.11.2022	6,476,712
N.	24.11.2022	1,159,993
S. sh.p.k	30.11.2022	7,606,528
	05.12.2022	26,748,756
I. sh.p.k	22.11.2022	50,019
2. sh.p.k	30.11.2022	1,619,919
N.S. shpk	17.11.2022	114,322
	12.12.2022	416,827
D. consulling	29.12.2022	240,000
2.	06.12.2022	312,000
M.C.	13.12.2022	78,961

A.I.	29.12.2022	2,521,227
A.B.	19.12.2022	837,600
B.	16.12.2022	6,592,800
Totali		94,075,301

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, në Bilancin kontabël të datës 31.12.2022 paraqiten ë shumën 33,434,726 lekë dhe paraqet detyrimin për pagat neto të muajit dhjetor 2022 dhe do të paguhet në muajin janar 2023, shumë e cila përputhet me shumën e pagave neto sipas listëpagesës së muajit dhjetor 2022.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet në shumën 2,476,794 lekë dhe paraqet vlerën e pa paguar për tatimin e të ardhurave nga punësimit për muajin dhjetor 2022, që paguhet në muajin janar 2023, shuma e paraqitur në Bilancin Kontabël përputhet me atë të paraqitur në listëpagesën e muajit dhjetor 2022.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqiten konkretisht në vlerat 9,753,652 lekë dhe 1,342,964 lekë dhe paraqesin vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhet në muajin janar 2023, shumat janë të njëjta si në listëpagesën e muajit dhjetor 2022.

Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 paraqitet në vlerën kontabël prej 78,862,434 lekë, në lidhje me shtesat dhe likuidimet për këtë llogari është rakorduar me Degën e Thesarit Dibër më datë 24.01.2022.

Titulli i gjetjes 4: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”

Situata:

Nga verifikimi saktësisë së paraqitjes së llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” rezultoi kjo llogari është paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të datës 31.12.2022 e mbivlerësuar më 735,980 lekë. Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit dhe akt rakordimeve me degën e thesarit mbi shtesat dhe likuidimet rezulton se ka një diferencë në shumën e paraqitur në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022, konkretisht si më poshtë:

Tabela nr. 24: “Lëvizjet e llogarisë nr.466”

Gjendja në fillim të vitit	Shtesat gjatë 2022	Pakësimet gjatë 2022	Gjendja në fund të vitit	Në PF 31.12.22	Difere nca
51,910,379	27,592,325	1,376,250	78,126,454	78,862,434	(735,980)

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit
Drejtorja e Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për xhirimin e fondeve të kontraktori, nëse bashkia nuk ka pretendime për investimin, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, Kapitulli II, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50, si dhe në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10

Kriteri:

- Neni 5, 6, 7, 9 dhe 10 i Ligjit nr 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Neni 6 i Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4 i Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.,
- Pika 10 e Kapitullit II,UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Pasoja: Mos regjistrim në kontabilitet dhe keqparaqitje e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2022.

Shkak: Mos njohja dhe mos zbatim i Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtori Ekonomik në Bashkinë Dibër, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, duke rakorduar në çdo muaj vlerat e llogarisë 466, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemimin dhe mbylljen e garancive, që u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori Ekonomik, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare të vitit 2022, z. M. Sh..

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën prej 408,028,203 lekë, vlera që kësaj llogarie pasqyron detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera dhe të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve dhe përputhet me llogarinë 486 në aktiv të Bilancit Kontabël.

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin” paraqet detyrime që i ka shtetit, Bashkia Dibër për të ardhura të konstatuara, por të paarkëtuara, konkretisht në aktiv të bilancit kontabël paraqiten në kundërparti të llogarive 423429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” dhe llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”. Nga verifikimi i bërë këtyre llogarive, rezulton se shumtë përkatëse janë sa shuma e paraqitur në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 të llogarisë 4341, konkretisht në shumën 98,222,728.

FONDI I KONSOLIDUAR

Në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet në shumën 6,007,672,681 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 5,569,696,173 lekë.

Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve në vlerën 6,733,972,483 lekë me pasivet në vlerën prej 726,299,802 lekë.

Tabela nr. 25: “Seksioni Fondi i Konsoliduar në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022”

Nr.	Ref e llog	Emërtimi	2022	2021	Diferenca
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	6,007,672,681	5,569,696,173	437,976,508
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	6,007,672,681	5,569,696,173	437,976,508
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	5,477,797,848	5,114,906,365	362,891,483
99	12	Rezultatet e mbartura	454,789,808	203,442,383	251,347,425
100	85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	75,085,025	251,347,425	- 176,262,400

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga verifikimi i bërë kësaj llogarie rezulton se llogari 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” është i njëjtë me rezultatin e paraqitur në Pasqyrën e Performancës Financiare F2, llogaria 12 “Rezultate e mbartura”, është paraqitur saktë si shuma aritmetike e “Rezultati mbartur i vitit ushtrimor 2021” dhe “Fitimit ushtrimor 2021” që janë trashëguar si çelje për vitin 2022.

Formati nr.2 “Pasqyra e Performancës Financiare”

Pasqyra e Performancës, nga ana e Bashkisë Dibër është paraqitur klasifikimin sipas natyrës ekonomike, për vitin 2022 kjo pasqyrë paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.26: “PASH e vitit 2022 për Bashkinë Dibër”

NR	Ref llog	Emërtimi	2022	2021	Diferenca 22-21
1	A	TE ARDHURAT	1,805,116,485	1,880,020,066	-74,903,581
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	29,338,464	40,607,543	-11,269,079
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	649,763	1,368,350	-718,587

6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	649,763	1,368,350	-718,587
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine	12,419,733	9,946,287	2,473,446
9	7020	Tatim mbi Pasurine e paluajtshme	12,080,557	8,678,543	3,402,014
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë se palujtshe	-	155,991	-155,991
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	339,176	1,111,753	-772,577
12	703	3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	16,268,968	29,292,906	-13,023,938
17	7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	16,268,968	29,292,906	-13,023,938
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	60,748,476	59,188,131	1,560,345
35	710	1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia	6,455,505	9,799,966	-3,344,461
38	7109	Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	6,455,505	9,799,966	-3,344,461
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	53,335,881	46,816,072	6,519,809
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	20,572,896	19,385,062	1,187,834
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	9,081,580	8,069,810	1,011,770
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	1,450,460	401,700	1,048,760
44	7114	Te ardhura nga biletat	21,926,330	18,959,500	2,966,830
45	7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestime e zhdëmtime	304,615		304,615
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	957,090	2,572,093	-1,615,003
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	-	-	-
53	72	V.GRANTE KORENTE	1,715,029,545	1,780,224,392	-65,194,847
54	720	1.Grant korent I Brendshëm	1,714,617,825	1,780,224,392	-65,606,567
55	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	4,300,000	21,468,463	-17,168,463
56	7201	Nga Buxheti për NJQP(Vendore)	1,670,170,405	1,699,328,856	-29,158,451
59	7204	Pjesëmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	37,615,419	18,269,601	19,345,818
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	-	38,329,971	-38,329,971
62	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	2,532,001	2,827,501	-295,500
64	721	2.Grant korent I Huaaj	411,720	-	411,720
65		Nga Qeveri te Huaaja			-
66		Nga Organizata Nderkombetare	411,720		411,720
74	B	SHPENZIMET	1,730,031,460	1,628,672,641	-11,269,079
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	440,471,468	417,076,520	-718,587
76	6001	Paga, personel I perhershëm	440,471,468	417,076,520	-74,903,581
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	73,972,490	69,332,278	4,640,212
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	66,442,357	61,955,324	4,487,033
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	7,530,133	7,376,954	153,179
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	120,673,736	97,658,253	23,015,483
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera	-		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	3,894,670	17,601,600	-13,706,930
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	13,463,970	12,712,260	751,710
87	6022	Sherbime nga te trete	14,436,080	12,516,700	1,919,380
88	6023	Shpenzime transporti	17,189,230	9,778,660	7,410,570
89	6024	Shpenzime udhetimi	2,083,000	581,927	1,501,073
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	8,456,235	5,738,779	2,717,456
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	1,280,980	635,590	645,390
	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	25,184,680		25,184,680
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	155,000		155,000
94	6029	Shpenzime te tjera operative	34,529,891	38,092,737	-3,562,846
95	603	IV.SUBVECIONE	-	-	-
101		V.TRANSFERIME KORENTE	1,101,701,557	1,038,003,031	-11,269,079
102	604	1.Transferime korente te brendshme	-	-	-
112	606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	1,101,701,557	1,038,003,031	-74,903,581
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	-		-
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,101,701,557	1,038,003,031	-718,587
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE	-	-	-
130	63	VIII.Ndryshimi I Gjendjes Se Inventarit	- 6,787,791	6,602,559	-13,390,350
131		IX.SHPENZIME TE TJERA	-	-	-
132	85	Rezultati I Veprimtarise se vitit Ushtrimor)	75,085,025	251,347,425	-718,587

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave rezulton se:

- Të ardhurat nga tatim taksat janë në shumën 29,338,464 lekë dhe zënë 2% të totalit të të ardhurave,

- Të ardhurat jo tatimore janë 60,748,476 lekë dhe zënë 3% të totalit të të ardhurave dhe
- Të ardhurat nga financimi i buxhetit të shtetit (grant korent i brendshëm) janë 1,670,170,405 lekë dhe zënë 93% të totalit të të ardhurave.
- Të ardhura nga financimet e tjera të brendshme 2% (llogaritë 7200, 7204, 7207)

Këto shuma të të ardhurave janë të rakorduara dhe me degën e Thesarit Dibër, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, nga ku totali i të ardhurave të realizuara nga vetë Bashkia Dibër është 134,946,080 lekë¹⁵.

Llogaria nr.7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël” pasqyrohet gjatë vitit 2022 paraqitet në shumën 649,7636 lekë dhe krahasuar me një vit më parë ka rezultuar se ky post është zvogëluar me 718,587 lekë. Kjo shumë është sipas shifrës së paraqitur në aktraordinin e bërë me Degën e Thesarit Dibër.

Llogaria nr.7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” paraqitet në shumën 12,080,557 lekë dhe në krahasim me një vit më parë është rritur me 3,402,014 lekë.

Llogaria nr.7029 “Të tjera tatime mbi pasurinë” paraqitet në shumën 339,176 lekë dhe në krahasim me një vit më parë është ulur me 772,577 lekë.

Llogaria nr.7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie” paraqitet në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2022 në shumën 16,268,968 lekë me një rënie prej 13,023,938 lekë, krahasuar me një vit më parë.

Llogaria nr.7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2022 paraqitet në shumën 6,455,505 lekë dhe krahasuar me një vit më parë kjo llogari ka pësuar një rënie me 3,344,461 lekë.

Llogaritë e klasës 711 “Shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare” në pasqyrën e performancës financiare të vitit 2022 rezultojnë të jenë në shumën 53,335,881 lekë, dhe krahasuar me një vit më parë janë rritur me 6,519,809 lekë.

Të gjitha llogaritë e mësipërme të të ardhurave të realizuara përgjatë vitit 2022, përkojnë me shumën e paraqitura dhe në akt rakordimin e Degës së Thesarit, Dibër.

Llogaritë e shpenzimeve të konstatuara në Pasqyrën e Performancës Financiare, të klasifikuara sipas natyrës rakordojnë me shumën e rezultuar në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor me akt rakordimet e thesarit.

Pesha specifike e klasave të shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet për llogarinë nr.600 “Paga shpërblime të tjera personeli”, në vlerën 440,471,468 lekë janë rreth 25% të totalit të shpenzimeve;
- Shpenzimet për llogarinë nr.601 “Kontribute të sigurime shoqërore dhe shëndetësore” në vlerën 73,972,490 lekë rreth 4% të totalit të shpenzimeve;
- Shpenzimet për llogarinë nr.602 “Blerje mallra dhe shërbime” në vlerën 120,673,736 lekë rreth 7% e totalit;
- Shpenzimet në llogarisë 606 “Transferta për buxhete familjare e individë” në vlerën 1,101,701,557 lekë zënë 64% të totalit të shpenzimeve, në të cilën përfshihen transferata për ndihmat ekonomike.

Rezultati i paraqitur në shumën 75,085,025 lekë, paraqitet saktë si diferencë e të ardhurave totale me shpenzimet totale.

Pasqyra e Flukseve të mjeteve monetare(Cash Flow)

Pasqyra Cash Flow nga Bashkia Dibër është përgatitur sipas metodës direkte, dhe nga testet ë bëra në lidhje me verifikimin e zërave të paraq

itur në këtë pasqyrë rezultoi se veprimet me bazë cash janë pasqyruar drejtë dhe gjendja e mjeteve monetare në fillim dhe fund të periudhës rakordojnë me shumën përkatëse në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit në lidhje me saktësinë e paraqitjes së shumave në këtë

¹⁵ Totali i të ardhurave pa pjesën e financimit nga Buxheti për NJQP(Vendore).

pasqyrë rezultoi se zërat analitikë të fondeve neto të paraqitura në këtë pasqyrë nuk përkojnë më gjendjen e zërave analitikë përkatës të Seksionit Aktivët neto, të Bilancit Kontabël të datës 31.12.2022, në mënyrë të detajuar situata paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.27: “Aktivët neto sipas pasqyrave : F1 dhe F4”

Emërtimi	Aktive neto në fillim (F4) ¹⁶	Aktive neto në fund (F4)	Aktive neto (F1 ¹⁷)
Nga Rezultatet e mbartura(+,-)	203,442,383	203,442,383	454,787,808
Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	251,347,425	251,347,425	75,085,025

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela më sipër rezulton se gjendja e postit “ Nga rezultate të mbartura” dhe “Nga rezultate e vitit ushtrimor” në pasqyrën e ndryshimeve në aktiveve neto paraqitet e pandryshuar, ndërsa bë pasqyrën e pozicionit financiar shumë paraqiten përkatësisht 454,787,808 lekë dhe 75,085,025 lekë. **Kjo paraqitje e pasaktë e pasqyrës së formatit 4 bën që pasqyrat të jenë të pakrahasueshme** nga një vit në tjetrin dhe të mund të kuptohet dhe arsyetja e ndryshimit të këtyre zërave sipas periudhave kontabile.

Shënime shpjeguese

Pasqyra e Shënimeve Shpjeguese (F5) **nuk paraqitet e plotë dhe nuk përmban as kërkesat minimale të plotësimit të saj**, në kundërshtim me përcaktimet e aneksit nr. 2 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022.

Mungon informacioni në lidhje me politikën kontabël të përdorura, bazat e vlerësimit të elementëve të pasqyrave, shënime specifike mbi elementët siç kërkohet në SKK-të përkatëse.

Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Për testimin e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës u bë përzgjedhja e disa transaksioneve të realizuara nëpërmjet tyre dhe u verifikua nëse janë të shoqëruara me dokumentacionet justifikuese përkatëse dhe si është bërë kontabilizimi i tyre.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listëpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me gjendjet e llogarive bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë.

Veprimet e bëra me arkë për vitin 2022:

Për verifikimin e veprimeve të kryera me arkë nga verifikimi i ditarit të arkës rezultoi se veprimet rregjistrohen manualisht, nuk mbahen në mënyrë elektronike ç’ka rrit dhe riskun e gabimit njerëzor. Nga verifikimi i ditarit të arkës rezultoi se nëpërmjet arkës kryhen vetëm veprime të arkëtimit dhe asnjë pagesë nuk kryhet nëpërmjet arkës. Në fund të ditës paratë gjendje në arkë, prej arkëtimit ditore të taksave dhe tarifave dhe në bazë të mandatarkëtimit dhe fletëhyrjeve është bërë dhe kalimi i tyre në llogarinë bankare dhe kontabilizimi.

¹⁶ Sipas Pasqyrës së ndryshimeve në aktivët neto (F4).

¹⁷ Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të datës 31.12.2022 (F1)

U auditua procedura në lidhje me përlogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, kontributin për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, ndërsa u përzgjedhën 3 muaj për verifikim konkretisht muaji Mars, Korrik dhe Dhjetor të vitit 2022, nga ku rezultoi se:

- Llogaritja e pagave është bërë në përputhje me kategoritë e pagave,
- Llogaritja e ndalesave është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi ;
- Pagesa e pagave neto e ndalesave është bërë brenda muajit pasardhës, nga ku u konfirmuan dhe dokumentacionet përkatëse që shoqëronin praktikën e pagesës nëpërmjet bankës si: listëprezencat ditore, listëpagesat, lista e pagave që është dërguar në bankë, lista bashkë me dokumentin e pagesës të nënshkruar dhe vulosur nga banka si dhe urdhërshpenzimet përkatëse.

Gjithashtu për verifikimin e saktësisë së veprimeve të realizuara me bankë, u bë përzgjedhje a disa shpenzimeve të kryera në mënyrë rastësore dhe për secilin rast u verifikua plotësia dhe saktësia e dokumentacionit justifikues që shoqëronte praktikën përkatëse.

Transaksionet e përzgjedhura për verifikim paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 28: "Transaksionet e shpenzimeve të përzgjedhura për testim nga grupi i auditimit"

NR. USH	Data	Përshkrimi i veprimit	Banka	Shuma
864	23.12.2022	Materiale te ndryshme për mirëmbajtjen e sistemit elektrik ne objekte dhe ndriçimit publik dhe mirëmbajtjen e kaldajave te objekteve arsimore Viti 2022	A.	2,943,600
906	28.12.2022	Dieta udhëtim I brendshëm	C.	66,200
941	29.12.2022	Shlyerje vendim gjyqësor pjesor S. sh.p.k	R.	3,000,000
744	17.11.2022	Blerje materiale për lyerjen e objekteve arsimore , social kulturore viti 2022, likuidim pjesor fature	A.	799,862
136	16.03.2022	Blerje goma bateri për nevojat e Bashkisë Dibër viti 2020	B.	1,179,600
137	17.03.2022	Shlyerje vendim gjyqësor pjesor Seali Vranezi	B.	2,500,000

Burimi i të dhënave: Pasqyrat Financiare të vitit 2022, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga verifikimi i bërë praktikeve të mësipërme rezultoi se:

Dokumentacioni justifikues është i plotë dhe pagesat nëpërmjet bankës janë të mbështetura në dokumentacionet justifikuese përkatëse dhe të plota dhe sipas urdhrave të titullarit dhe urdhërshpenzimeve përkatëse.

Nën/Pika(3.4.) Auditim mbi administrimin e aseteve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Nga të dhënat, Sektori i Aseteve ka funksionuar gjatë vitit 2022 me 4 punonjës sipas Vendimit Nr.14 datë 18.01.2022 të protokolluara në shkresën Nr.14 .Prot datë 18.01.2022.

Gjatë vitit ushtrimor të vitit 2022 dhe formularëve të paraqitur për inventarizimin e pronave të paluajtshme ose aktive të qëndrueshme shtetërore, rezulton se në Bashkinë Dibër janë gjithsej **5,950 prona** të paluajtshme si, shkolla, troje, sheshe, pemëtore, arra, spitale, zyra, rrugë, kanale, lulishte, varreza, pyje, moçalishte, kodrina , pyje, kullota etj, në 15 njësi administrative që janë në varësi të Bashkisë Dibër (Shih tabelën si më poshtë me VKM përkatëse të secilës njësi administrative).

Njesitë administrative të Bashkisë Dibër me pronat në përdorim

Nr.	Bashkia Diber Njesite Administrative	Vendimi I keshillit te Ministrave	Faza e Kalimit	Nr rendore te pronave ne listen e inventarit
1	Nj. Adm. Peshkopi	VKM nr. 1533 date 19.11.2008	Liste perfundimtare	1445
2	Nj. Adm. Maqellare	VKM nr. 700 date 21.05.2008	Inventar fizik	366
3	Nj. Adm. Melan	VKM nr. 1179 date 20.08.2008	Inventar fizik	245
4	Nj. Adm. Tomin	VKM nr. 51 date 16.01.2013	Liste paraprake	221
5	Nj. Adm. Kastriot	VKM nr. 367 date 01.04.2009	Liste Paraprake	193
6	Nj. Adm. Fush Cidhen	VKM nr. 364 date 24.04.2013	Liste Paraprake	136
7	Nj. Adm. Muhurr	VKM nr. 305 date 10.04.2013	Liste Paraprake	338
8	Nj. Adm. Luzni	VKM nr. 608 date 14.05.2008	Liste Perfundimtare	77
9	Nj. Adm. Arras	VKM nr. 1001 date 10.12.210	Liste Perfundimtare	204
10	Nj. Adm. Selishte	VKM nr. 102 date 03.02.2008	Inventare Fizik	806
11	Nj. Adm. Lure	VKM nr. 182 date 19.02.2009	Inventare fizik	792
12	Nj. Adm. Sillove	VKM nr. 211 date 16.03.2011	Liste paraprake	396

13	Nj. Adm. Zall Dardhe	VKM nr. 451 date 18.04.2013	Liste Paraprake	118
14	Nj. Adm. Zall Reç	VKM nr. 92 date 31.01.2007	Invetare fizik	200
15	Nj. Adm. Kala e Dodes	VKM nr. 699 date 10.10.2012	Liste perfundimtare	413
	Totali			5,950

Pra sipas pasqyrave rezulton se 1,935 prona janë në fazën përfundimtare ose 32 % e tyre, ndërsa të përfunduara plotësisht dhe të pajisur me certifikatë pronësie nga ASHK - Dibër vetëm 47 prona ose 0,07% e tyre, ritme shume të ulta këto të cilat kërkojnë me shumë impenjim për të mos u mbajtur këto prona në liste si “prona në përdorim”, pra janë 4,015 prona që janë në përdorim dhe nuk është kryer asnjë veprim ose 67% e tyre janë të pa regjistruara në ASHK -Dibër.

Nga këto kanë mbaruar plotësisht procedurat ligjore pranë ASHK - Dibër 47 prona të pajisur me kartelat përkatëse si dhe hartat topografike, në sipërfaqe totale **85,454.2 m²** nga këto janë 50,138 m² troje dhe ndërtesa pasqyruar në tabelën nr. 29, të aneksit nr. 3.

Pra në vitin 2021 dhe vitin 2022 janë certifikuar vetëm 27 prona ndërsa 20 janë certifikuar në vitin 2023, me ritme shume të ulta kur dihet që janë gjithsej 5,950 prona, dhe sipas llogaritjes i bie të regjistrohet vetëm një pronë në ditë. Në shkresën e dërguar me Nr. 3363 Prot., datë 16/11/2016, të miratuara sipas VKM-së nr. 1533, datë 19.11.2008, është dërguar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, të përgatitura nga kompania D., për pronat shtetërore që transferohen në pronësi të Bashkisë Peshkopi të Qarkut të Dibrës, është dhënë autorizim përgjegjësit të sektorit z. Z. H. për secilën pronë që është ndjekur për tu certifikuar në ASH - Dibër.

Në të gjitha rastet autorizimet janë të protokolluara dhe me datat përkatëse në librin e protokollit, kryesisht të njësive administrative Peshkopi për 1445 prona të cilat kanë autorizimin për të përfaqësuar Bashkinë Dibër për aplikimin në e-Albania sipas të dhënave të secilës pronë për tu pajisur me certifikatë pronësie HTR, kartelë përkatëse, me nr. Pasurie, volumi dhe zonë kadastrale të përgatitur nga Sektori i Aseteve Dibër.

Nga Bashkia Dibër në menaxhimin dhe përdorimin e aseteve ka lidhur kontrata për dhënien me qira të aseteve të cilat janë pronë e njësive vendore në **8 raste të trashëguara** në vitet e mëparshme me objekte “HEC” sipas dokumenteve rezulton (Sipas tabelës më poshtë)

Nr.	Emertimi subjektiv	Data e kontratës	Afati i Kontrates	Afati i kontratës	Siperf Ha
1	“A.” ShPK & ShPK	17.11.2017	10	-	1.05
2	“H. L.” ShPk	05.03.2015	10	-	1.4
3	“L.E.” ShPK,	31.10.2017	10	-	1.1
4	“H.S.” ShPK	08.05.2015	10	-	4.4
5	“K.H.”ShPK	28.03.2019	10	-	1.089
6	“Gj.R.” ShPK	07.11.2014	10	-	0.56
7	“K.”	21.11.2011	10	Mbaruar	
8	“K.H.”ShPK	28.10.2019	10	-	0.8

Titulli i gjetjes: Mos marrje masash për shlyerjet e detyrimeve të kontratave të lidhura.

Situata: Nga të dhënat rezulton se në total në 15 Njësiti Administrative të Bashkisë Dibër rezulton se sipas numrit të 5,950 aseteve, kapin një sipërfaqe totale 131,005,696.2 m² ose 131,005 ha dhe nga këto janë legalizuar 85,454.2 m² ose 0.6 % e totalit pra me këto ritme duhen vite me radhë për t’u certifikuar këto prona.

Mos administrimi dhe mos pajisja me certifikatë pronësie, rezulton se nuk janë mirë administruar këto prona dhe nuk ka lidhur kontrata për dhënie me qira dhe rritjen e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Dibër.

Nga Bashkia Dibër rezulton se në ndërtimin e HEC-ve kanë të pajisur kontratën dhe raportin teknik, pasqyra e përshkimit të parcelës, investimet e kryera, lista e ngastrave me sipërfaqet pyjore, si dhe tabela përmbledhëse e vlerësimit financiar të përgatitur nga Drejtoria Pyjore. Gjithashtu konstatojmë se subjekti, K. i ka mbaruar afati i kontratës 10 vjeçare dhe nuk ka

bërë zgjidhje kontrate edhe pse bëhen 2 vite që i ka mbaruar afati, por theksojmë se “K.” ka likuiduar detyrimet sipas kontratës të lidhur në vitin 2011 dhe në vitet 2022 - 2023.

Në verifikimin u konstatua se në kontrollin e mëparshëm janë konstatuar shkelje në drejtimin e lidhjes së kontratës dhe kanë konstatuar mos zbatim të kërkesat e VKM-së nr.391, datë 2.6.2006 “Për përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotave” të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010, lidhja 2, neni 11 dhe 12 dhe konkretisht :

a) Subjekti “A.” ShPK dhe “B.” ShPK me NIPT L42417014R dhe K022727202O kanë marrë në përdorim sipërfaqen 1.0535 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullosor të Bashkisë Dibër, por nga auditimi konstatohet se subjektet i detyrohen Bashkisë Dibër vlerën 3,074,174 lekë, për arsye se nga ana e njësisë vendore nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr.391, datë 2.6.2006 “Për përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotave” të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010, lidhja 2, neni 11 dhe 12.

b) Subjekti “H. L.” ShPK me NIPT L....H, ka marrë në përdorim sipërfaqen prej 0.1416 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullosor të Bashkisë Dibër. Në nenin nr. 3 të kontratës lidhur mes palëve, është përcaktuar afati i kontratës 10 vjet, duke filluar nga data 05.03.2015 deri më datën 04.03.2025. Në kontratë është përcaktuar se vlera e qirasë është 68,260 lekë, e cila do të paguhet vitin e parë, ndërsa për vitet e tjera qiraja është lënë zero lekë, si rezultat i së cilës nga auditimi rezultoi se subjekti detyrohet ti paguaj njësisë vendore vlerën 2,386,410 lekë.

c) Subjekti “L.E.” ShPK me NIPT L.....Q, ka marrë në përdorim sipërfaqen 0.1162 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullosor publik të Bashkisë Dibër”. Në nenin nr. 3 të kontratës është përcaktuar afati i kontratës 10 vjet (2017-2027). Nga përlllogaritja jo e saktë e vlerës së qirasë në kontratë rezulton se subjekti detyrohet ti paguaj njësisë vendore vlerën 88,425 lekë.

d) Subjekti “H.S.” ShPK me NIPT L.....T, ka marrë në përdorim me qira sipërfaqen prej 2.7086 ha, me afat 10 vjeçar. Me këtë subjekt është lidhur dhe një kontratë qiraje tjetër me ish Komunën Lurë për përdorim të sipërfaqes prej 4.4856 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor/ kullosor publik ish Komuna Lurë. Në nenin nr. 3 të kontratës është përcaktuar afati i kontratës 10 vjet (2015-2025). Nga përlllogaritja jo e saktë e vlerës së qirasë në kontratë, për periudhën e auditimit subjektit i lind detyrimi ndaj njësisë vendore në vlerën 2,945,495 lekë.

Në total, për katër rastet e mësipërme, për arsye se në llogaritjen e vlerës së qirasë është vepruar në kundërshtim me VKM nr, 1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” pika 2 lidhja 11, Bashkisë Dibër i është shkaktuar e ardhur e munguar në vlerën **8,494,504 lekë**.

-Në auditimin e kontratës së qirasë nr.1, datë 14.09.2021, të lidhur midis Bashkisë Dibër përfaqësuar nga ish Kryetari saj z. Sh. M. dhe subjektit E. Gj.” me objekt “*Prodhim/vjelje/grumbullim të bimëve medicinale*”, rezulton se:

-Nuk ka dokument ligjor të z. E. Gj. që është i regjistruar në QKB.

-Nuk ka të përcaktuar zonën ku do kryej aktivitetin tregtar, sipërfaqja në (ha) nuk përshkruhet në kontratë.

-Nuk ka dokument për magazinat e tregtisë Peshkopi për pasurinë Nr.18/212 zona kadastrale 2932 ish/Magazinat e tregtisë, “prona e kujt është dhe a është e regjistruar në ASHK apo pronë e Bashkisë Dibër”.

Kriteri: ligjit nr. 8744, datë 22.01.2011, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, VKM nr. 500 datë 14.08.2001, Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore si dhe ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 për qeverisjen vendore dhe ligjit 9936, date 26.06.2008 , “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Dibër në vlerën **8,494,504 lekë**.

Shkak: Mos zbatimi i procedurave ligjore.

Rëndësia: E Lartë,

Rekomandimi 1: Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore deri në procese gjyqësore për të likuiduar detyrimin e pa likuiduar te prapambetur prej dy vjetësh në vlerën **8,494,504 lekë**.

Rekomandimi 2: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa për mos përsëritjen dhe ndërprerjen e praktikave në lidhjen e kontratave me subjekte të cilat nuk plotësojnë kriteret e nevojshme.

Rekomandimi 3: Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për menaxhimin dhe kontrollin e kontratave të cilave ju ka mbaruar afati i parashikuar në kontratë, të njoftojë kontraktuesit për kushtet e lidhura në kontratë në të kundërt të njoftojë për prishje të saj.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 872/4 prot., datë 19.01.2024 nga Drejtoria e Buqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, “Sektori i Pyjeve dhe Kullotave” në varësi të Bashkisë Dibër nga z. G. S. me detyrë Ish/Drejtor, nga z.V. T. me detyrë Përgjegjës Sektori, nga z. I. Gj. me detyrë Specialist, nga z. O. K. me detyrë Specialist, për sa më poshtë vijon:

Pretendimet e paraqitura nga subjekti, janë të njëjta me ato të paraqitura mbi Akt Konstatimin nr. 5, datë 20.11.2023 dhe nuk ka asnjë argument apo dokument të ndryshëm nga ato të trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit. Sa më sipër, pretendimet e juaja nuk pranohen.

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2020-31.12.2021. Pas miratimit të regjistrit në sistem nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi, mbështetur në VKB përkatëse “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Dibër”.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB.

Pasqyrat e prokurimeve të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi janë paraqitur në Aneksat bashkëlidhur¹⁸.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për periudhën 01/01/2022 – 31/12/2022, nga Bashkia Dibër referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **44** procedura prokurimi me vlera të larta me vlerë të fondit limit 426,182 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 370,330 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 55,852 mijë lekë pa TVSH ose 13 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Vlera në mijë lek			
Procedura 01/01/2022 - 31/12/2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	44	426,182	370,330
-Të hapura	12	295,554	249,748
- E Hapur e Thjeshtuar	32	130,628	120,582

¹⁸Pasqyra për prokurimet me vlera të larta, e detajuar tabelën nr. 1 të aneksit nr. 4.

Procedura 01/01/2022 - 31/12/2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
Sipas objekteve	44	426,182	370,330
-Objekte në fushën e investimeve	27	362,231	308,516
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	17	63,951	61,814

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **131** OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar **41** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **13** procedura ose 29% e procedurave të zhvilluara, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 22 ose 50% e tyre.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohet në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Titulli i gjetjes: Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2022-31.12.2021, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet, OE të shpallur fitues të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK, financime pa fonde në dispozicion, vlerësim të ofertave në tejkalim të afateve, shpenzime pa efektivitet të buxhetit të Bashkisë Dibër.

Situata: Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, janë realizuar gjithsej **44** procedura me vlera të larta me fond limit 426,182 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 370,330 mijë lekë pa TVSH, me një diferencë për vlerën 55,852 mijë lekë ose 13 %.

Referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit, nga **44** procedura me fond limit 426,182 mijë lekë, vlerësoi për auditim **19** procedura me fond limit 347,904 mijë lekë ose 81.6% e fondit të prokuruar.

Nga auditimi i **19** procedurave me fond limit **426,182** mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej **19** procedura ose 100% e kampionit të testuar, nga të cilat: në **17** procedura kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës, në **19** procedura, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, në **15** raste investimet janë prokuruar pa pasur fonde në dispozicion, në **10** raste, vlerësimin e ofertave i kryer nga KVO është bërë në tejkalim të afatit 15 ditë, në **3** raste konstatohet se për shkak të vlerësimin të gabuar nga KVO, janë shkaktuar shpenzim pa ekonomicitet në buxhetin e Bashkisë Dibër në **vlerën 8,291 mijë lekë** veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 21, 77, 82, 92, 98, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 39, 73, 74, 75, 78, 82, 85;

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”; Neni 21 “Autoriteti ose Enti Kontraktor”, Neni 77, “Kërkesat për kualifikim”, Neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, Neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, Neni 73 “Titullari i autoritetit/entit kontraktor”, Neni 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, Neni 75 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, Neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, Neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Neni 85 “Lidhja e kontratës”, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016.

Shkak: Mosvlerësimi i drejtë i kriterëve, kriterë jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe/ose aplikimi i kriterëve të rënduara, të cilat çojnë direkt ose indirekt në uljen e numrit të OE pjesëmarrës. Vendosija nëpër komisione e personelit të pakualifikuar.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe jo në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST për kontrata me vlerën total **297,242 mijë lekë**, shpenzime pa ekonomicitet për buxhetin e Bashkisë Dibër në vlerën **8,291 mijë lekë** në 3 procedura prokurimi. Vonesa të paargumentuara në vlerësimin e ofertave, duke krijuar shtyrje të paargumentuar të lidhjes së kontratës dhe fillimin e punimeve, e cila përkthehet në vonesa në shërbimet ndaj banorëve të kësaj bashkie.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

Rekomandimi 2: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të shmangë angazhimet për procedura prokurimi pa fonde në dispozicion, kjo për të shmangur rritjen e borxhit të bashkisë.

Rekomandimi 3: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, të marrin masa për shmangien dhe mos përsëritjen e vonesave të paargumentuara në fazën e vlerësimit të ofertave, duke eliminuar tejkalimin e afateve ligjore në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.

Rekomandimi 4: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa ekonomicitet të fondeve publike për kontratat me objekt “Rikonstruksion shkolla 9 – vjeçare “Irfan Hajrullai” Peshkopi, Bashkia Dibër 2022”, “Sistemim asfaltim i rrugës së Lagjes Llixha, Bashkia Dibër 2022”, “Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton i lagjes Kallavere Peshkopi, Bashkia Dibër 2022” me impakt negativ financiar në vlerën **8,291 mijë lekë**.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 872/4 prot., datë 19.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: 1.Në të gjitha procedurat e prokurimit, në të cilat janë kërkuar staf i kualifikuar i cili duhet të disponojë dëshmi të sigurimit teknik, observuesit sqarojnë se kjo dëshmi është kërkuar pasi punonjësit janë gjithë kohës në kantier për zbatimin e punimeve, dhe kërkohet të kualifikuar që të mos kenë dëmtime fizike gjatë kryerjes së punëve.

2.Përsa i përket kërkesës për fabrikën inerte dhe të asfalto-betonit është kërkuar që të jenë të pajisur me leje mjedisore, që operatorët pjesëmarrës në procedurë prokurimi për ushtrimin e aktivitetit për fabrikën nyje inerte dhe të asfalto-betonit, të jenë të pajisur me leje mjedisore se në rast të kundërt kontrata nuk mund të zbatohet sipas afateve ligjore duke pasur parasysh se OE të ushtrojnë aktivitet të kundërligjshëm për punët publike sidomos me ent publik, ndërsa leja mjedisore është kërkuar nga persona të tretë në momentin që deklarojnë kontratë furnizimi, sepse duhet ta disponojë personi që ushtron aktivitetin dmth ai që bën furnizimin me mall.

Shënim: I njëjti observacion mbahet edhe për tenderin me objekt: Bashkia, Sistemim asfaltim i rrugës kryesore, mbushje gropash, kuneta, trotuare Bashkia Dibër 2022, Rehabilitimi dhe shtrimi me asfaltobeton të rrugës së fshatit Kalle, Bashkia Dibër 2022, Rehabilitimi dhe shtrimi me asfaltobeton i lagjes Kallavere, Peshkopi Bashkia Dibër 2022, Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Tomin Bashkia Dibër 2022, Rikonstruksion i ujësjellësit të brendshëm për fshatrat Lishan i Epërm, Arap i Epërm NJA Luzni. Sistemim asfaltim i rrugës Ura e Luznisë Kryqëzimi i fshatit Lishan me fshatin Hoteshe FAZA I, Sistemim asfaltim i rrugës sheshi fshatit Pollazhan-Varrezat e dëshmoreve

Bashkia Dibër 2022, Rikonstruksion dhe sistemim asfaltimi të rrugës ish-Ndërmarrja Grumbullimi Lagjia Gjok Doçi, Shtrim i trotuareve në qendrën e njësisë administrative Maqellarë Bashkia Dibër 2022.

3.Lidhur me procedurën me objekt “Ndërtim i shtegut turistik Radomirë – Liqeni i Zi, sqarohet se në pikën 2.3.3 është kërkuar qe OE të disponojnë pikën NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit), duke pasur parasysh që investimi dhe punimet do të kryhen në një zonë turistike dhe të mbrojtur dhe duke u bazuar në zërat e preventivit pikërisht në pikën 1 me nr. anal. 3.2., dhe bazuar ne gjurmën e objektit bazuar në projektin e miratuar nga AK.

4.Lidhur me procedurën me objekt “Rehabilitim dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës së fshatit Dohoshisht, Bashkia Dibër 2022”, sqarohet se kërkesa e pikës 2.3.2 kërkon inxhinierët drejtues teknik në përputhje me natyrën e punimeve të projektit dhe preventivit, të cilat janë në përputhje me pikat e licencës së zbatimit sipas vkm 42.

-Lidhur me kërkesën për mjetet e gërmimit, sqarohet se janë kërkuar bazuar në zërat e preventivit, ekskavator me zinxhir zëri i preventivit 1 me nr anal. 3.102/a, minieskavator është kërkuar për punimet që do të kryhen në pikën B të preventivit K.U.Z., ekskavatori me goma është kërkuar për mbushje, rrafshim, dhe rahabilitim të trupit të rrugës, ndërsa fadroma për shtrimin e shtresa të zhavorit të çakullit etj.

5.Lidhur me procedurën me objekt “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Irfan Hajrullai” Peshkopi Bashkia Dibër 2022” sqarohet se për pikën 2.3.3/b është kërkuar një punonjës për mbrojtjen kundra zjarrit, kjo bazuar në zërat e preventivit konkretisht në pikën 7, “Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit”, me vlere 256,495 leke, sistemi i MNZ në vlerën 102,000 leke, që do të thotë që kriteret janë vendosur në proporcion me natyrën e punimeve për zbatimin korrekt të punimeve me specialistë të fushës.

-Lidhur me kërkesën për 1 Arkitekt, sipas pikës 2.3.4, sqarohet se është kërkuar një drejtues teknik Arkitekt, me qëllim që gjatë zbatimit të punimeve ka dhe ndërhyrje të veçanta në strukturë të objektit, dhe në ndërtimin e shtesës bazuar në pikën 3 të preventivit.

6.Lidhur me procedurën me objekt “Sistemim asfaltim i lagjes Llixha, Bashkia Dibër 2022”, sqarohet se për pikën 2.3.4/b, është kërkuar në baze të nenit 39 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, dhe në vend të vendosjes së jo më pak se 50 % është vendosur e kundërta, është një lapsus nga ana e njësisë por nuk mendoj qe mund të ketë konfuzion gjate vlerësimit, duke qenë se është dhe kriter tipik i pa ndryshueshëm në të gjitha procedurat e prokurimit, po njëlloj parashikohet si në procedurat e mallrave, punëve dhe të shërbimeve.

7.SHENIM:

Për sa i përket pikës 2.3.4 të DST, njësia e prokurimit ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë një numër punonjësish të caktuar, që përkon me afat 3 - 6 muaj në listëpagesa. Ky kriter është vendosur bazuar ne nenin 39 pika 6 germa ç, e VKM 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, për seriozitetin e firmës dhe kapacitet e duhura te saj për ekzekutimin në mënyrë korrekte dhe sipas afate te zbatimit te punimeve, sepse nuk mund te vendoset për një periudhe 1 mujore numri i punonjësve, sepse kapacitetet teknike të firmës maten në kohë më të gjatë 3 muajt e fundit ose 6 muajt e fundit etj.

Vlera e financimit të objektet e prokurimit është vendosur në DT duke u bazuar në buxhetin e miratuar në fillim të vitit që është bërë me VKB dhe konfirmimin e prefekturës qe shprehur mbi ligjshmërinë e një Vendimi të marre nga Këshilli Bashkiak Dibër.

8.Në observacionin e paraqitur nga personi përgjegjës për prokurimet, z. I. S. dhe anëtari i NjP O. Ç., sqarohet gjithashtu se në bazë të nenit 73 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, titullari i AK është përgjegjës për ngritjen e komisioneve në një procedurë prokurimi. Në bazë të natyrës së llojit të procedurës së prokurimit është ngritur urdhri i prokurimit me specialit fushe për argumentimin e kriterëve të veçanta, kacitetin teknik kjo bazuar në nenin 77 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, por ndër të tjera detyrë titullari bën një ndarje të qartë të detyrave mes zyrtarëve të prokurimit e cila kjo ndarje është për secilën procedurë prokurimi të audituar nga ana juaj, ku dhe janë bërë të qarta detyrat e Personit përgjegjës të prokurimit dhe specialistit të fushës. Ndarja e detyrave mes zyrtareve (njësisë së prokurimit) është bazuar në nenin 74 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1.Lidhur me pikën 1 për stafin e kualifikuar me dëshmi të sigurimit teknik, pretendimi nuk pranohet. Audituesit siç kanë cituar në akt konstatimin e mbajtur, dëshmitë e sigurimit teknik lëshohen sipas ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”. Sa më sipër, pjesa më e madhe e stafit të kërkuar në procedurat e audituara, profilet e punonjësve të kërkuar dhe zërat e punimeve që ata kryejnë, nuk kanë lidhje me sigurinë e punës së pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike.

2.Lidhur me pikën 2 pretendimi nuk qëndron. Siç është cituar nga audituesit në akt konstatimin e mbajtur, referuar nenit 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, AK mund të kërkojë nga ofertuesit paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i konformitetit.....sa më sipër, është e qartë se kërkesat për paraqitje dokumentesh (leje mjedisore), nuk mund t’i drejtohen një subjekti tjetër të ndryshëm nga ai ofertues. Sa më sipër kjo është në kundërshtim me rregullat e LPP.

3.Lidhur me pikën 3 të observacionit për kategorinë NP-12, pranohet pretendimi juaj, duke e konsideruar si proces të riaftësimit natyror, botanik etj.

4.Lidhur me pikën 4 për inxhinierët drejtues teknik, pretendimi nuk pranohet. Audituesit sqarojnë se kemi të bëjmë me një procedurë me vlerë të vogël, ku kërkesa për 3 inxhinier drejtues teknik është e lartë. AK mund të kërkon disponimin e inxhinierëve edhe në listëpagesa më qenë e nevojshme të jenë drejtues teknik, kjo për të rritur edhe konkurrencën ndërmjet OE.

5.Lidhur me pikën 5 për ekspertin MNZ, pranohet pretendimi juaj, pasi provoni procese konkrete që lidhen me mbrojtjen nga zjarri sipas preventivit të punimeve, ndërsa kërkesa për 1 Arkitekt nuk pranohet, pasi nuk jemi në projektim, por në zbatim punimesh, dhe ekspertiza e arkitektit është e panevojshme.

6.Lidhur me pikën 6 për kërkesën e punëve të ngjashme, audituesit sqarojnë se pavarësisht se nuk ka ndikuar në vlerësimin e ofertave, kriteri është hartuar gabim, dhe potencialisht mund të përbëjë shkak për interpretim të gabuar gjatë vlerësimit. Vlerësohet se mund të jetë lapsus, por do evidentohet në raport, pikërisht për t’u pasur në vëmendje gjatë hartimit të dokumenteve në procedurat në vijim.

7.Lidhur me shënimin sipas pikës 7, në të cilin sqaroni arsyet e vendosjes së kërkesës për fuqinë punëtore për periudha që variojnë nga 3 deri në 6 muaj, pretendimi juaj nuk pranohet. Siç përcaktohet në nenin 39, pika 6 germa (ç) të VKM-së nr. 285, datë 29.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, AK kërkon fuqinë minimale punëtore të nevojshme për zbatimin e kontratës, por ky nen nuk përcakton periudha se për sa kohë duhet të figurojnë në listëpagesa stafi i kërkuar. AK, nuk ka mbajtur një qëndrim lidhur me këtë kërkesë, ku në shumë raste e kërkon me 3 muaj deri në 6 muaj. Për AK, duhet të jetë e nevojshme dhe e arsyeshme që OE të disponojnë fuqinë minimale të nevojshme për përmbushjen e kriteve të nevojshme, pa u shtrirë kjo periudhë në periudha të mëvonshme, pasi potencialisht mund të përbëjë shkak për s’kualifikim të padrejtë për OE që kanë në momentin e aplikimin numrin e nevojshëm.

8.Lidhur me vlerën e financimit, nuk pranohet pretendimi juaj. Rezulton se Bashkia Dibër ka kryer në masën më të madhe procedurat pa fonde në dispozicion, duke financuar për vitin e parë vlera më të vogla se 20% e investimit. Kjo situatë, krijon borxhe për Bashkinë Dibër, dhe njëkohësisht ul mundësinë e investimeve për vitet në vijim.

9.Lidhur me sqarimet e dhëna nga punonjësit I. S. dhe O. Ç., në cilësinë e personi përgjegjës për prokurimet dhe anëtarit të NjP, audituesit do vlerësojnë rast pas rasti pozicionin e tyre lidhur me hartimin e kriteve të veçanta të kualifikimi, kriteret të cilat hartohen nga specialisti i fushës.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO R. D., A. C. dhe M. Sh., është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 872/4 prot., datë 19.01.2024 si më poshtë:

Lidhur me pretendimet e paraqitura nga anëtarët e KVO, ato rezultojnë se janë të njëjta me observacionet e paraqitura për Akt Konstatimin Nr. 8, datë 20.11.2023, trajtimi i të cilave është bërë në Projekt Rarortin e Auditimit, duke mos pasur asnjë argumentim apo dokument për të mbështetur gjetjet e audituesve. Në këto kushte observacionet e juaja nuk merren në konsideratë.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit, etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022

1. Tenderi me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Selane (Dohoshisht – Selane), Faza I, Bashkia Dibër 2022”, me këto të dhëna:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Selane (Dohoshisht – Selane), Faza I, Bashkia Dibër 2022”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 75 datë 09.02.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.75 datë 09.02.2022 1. I. S. - (Jurist) 2. O. Ç. - (Anëtar) 3. M. D. - (Inxhinier)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 81 datë 10.02.2022 1. R. K. - (Kryetar) 2. Q. S. - (Anëtar) 3. E. Sh. - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur ”	6.Oferta fituese: OE “S.” shpk me ofertë 29,865,708 Lekë, me lidhje kontrate datë 23.06.2022, me afat 3 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 15,967,625 - lekë pa tvsh
5.Fondi Limit (pa Tvsh) : 45,833,333 leke pa tvsh.	8.Data e hapjes së tenderit: 11.03.2022	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës – 9 OE b)Skualifikuar – 4 OE c) Kualifikuar - 5 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 4,278,409 lekë, vlerë e cila përkon me 10% të investimit.

-Financimi për këtë projekt, është në kundërshtim me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 45 punonjës për periudhën Tetor 2021 – e në vazhdim, që përkon me një periudhë 5 mujore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 2 teknik ndërtimi, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë

stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik. Gjithashtu, sqarohet se dëshmitë e sigurimit teknik, nuk mund të konsiderohen dëshmi kualifikimi për proceset e punës që merren përsipër nga stafi i mësipërm, pasi objekti i këtyre dëshmimeve është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve elektrike dhe jo certifikimi për profilin apo kualifikimin e punonjësve.

3.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohet të paraqitet dokumentacioni i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Procesi i vlerësimit të ofertave: -Me shkresën pa nr. datë 29.03.2022, KVO ka bërë kërkesë drejtuar NjP për paraqitje dokumentacioni nga pjesëmarrës në këtë procedurë. NjP ka paraqitur kërkesë drejtuar OE sipas të cilës kërkon dokumentacion mbështetës sipas pikave 2.2.3, 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.3.5. Lidhur me këtë kërkesë, KVO i është përmbajtur nenit 26 pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, e cila përcakton se *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, Autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni si dhe dokumente tjera shoqëruese...* dokumentet e kërkuara me njoftimit e mësipërm, janë dokumente që plotësohen nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit dhe nuk argumentohet nga KVO arsyeja përse duhet kërkuar i gjithë dokumentacioni nga OE. Rezulton, se pavarësisht kësaj kërkesë, disa nga OE kanë paraqitur dokumentet sipas kërkesës së mësipërme, dhe të tjerë OE nuk i kanë paraqitur, ndërkohë që KVO, në përfundim të procesit i ka kualifikuar të gjithë këta OE. Veprimet e mësipërme janë konfonduese, jo ligjore, dhe kanë sjellë vonesa të paargumentuara në vlerësimin e ofertave dhe lidhjen e kontratës.

Në vijim, me shkresën pa nr. datë 19.04.2022 KVO ka bërë kërkesë tjetër drejtuar NjP për të kërkuar sqarime nga OE “S.” shpk për ofertën anomalisht të ulët. Me shkresën nr. 1287 prot., datë 22.04.2022, NjP ka kërkuar nga OE “S.” shpk sqarime që lidhen me ofertën e paraqitur e cila është anomalisht e ulët. Në përgjigje të saj, OE ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 17/1 prot., datë 26.04.2022, administruar në bashki me nr. 1287/1 prot., datë 26.04.2022 ku ka paraqitur analizën përkatëse.

-Me datë 29.04.2022 është mbajtur procesverbali në të cilin është përcaktuar si fitues i procedurës OE “S.” shpk.

-Me datë 13.05.2022 është bërë njoftimi i fituesit paraprak. Me datë 23.05.2022 është miratuar raporti përmbledhës nga Titullari i AK z. R. S..

-Nga verifikimi i mësipërm, rezulton se nga momenti i dorëzimit të ofertave me datë 11.03.2022, procesi është tej zgjatur mbi 2 muaj.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës nga KVO, është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar. Mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi e anëtarëve të KVO.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** e cila kërkon nga OE Deklarimin në fazën e ofertimit për Shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Vitin 2021. Ky OE nuk ka paraqitur sipas shtojcës 8 deklarinin përkatës.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për mjetin Grejder. Për këtë mjet është

paraqitur si dokument Deklarata Doganore nr. R 42174, ndërkohë mjeti me goma, i cili shënohet në regjistra publikë, për të cilat duhet të paraqiten dokumentet e nevojshme si leja e qarkullimit, akti i kolaudimit dhe polica e sigurimit, kjo në zbatim të kriterëve të vendosura nga NjP dhe sipas detyrimeve ligjore sipas përcaktimit të nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë neni 8 dhe neni 17.

2.OE nuk përmbush kriterin për 1 Autobotumatriçe. Për këtë mjet, është paraqitur si dokumentacion mjeti me targa DI4161A, i cili sipas fotove të paraqitura rezulton kamionçinë, dhe për këtë mjet nuk është paraqitur njëkohësisht certifikata e pronësisë së mjetit. Ndërkohë, është paraqitur edhe një deklaratë doganore për bitumatriçen, por në DST kërkohet ekzaktësisht mjeti Autobotumatriçe, mjet i posaçëm, ndërkohë mjeti i paraqitur rezulton mjet i montuar, në kundërshtim me kriteret e vendosura.

3.OE nuk përmbush kriterin për 1 Autovinç. Është paraqitur mjeti me targa AA607HP. Polica e sigurimit për këtë mjet ka skaduar me datë 23.05.2022, ndërkohë dokumentacioni i noterizuar dhe paraqitur pranë AK është i datës 27.05.2022.

4.OE nuk ka paraqitur policën e sigurimit për Kamionin mbi 8 Ton me targa DI5172A.

5.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku OE ka zhvilluar veprimtarinë e tij për vitin 2021. Ky OE ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Bulqizë për likuidimin e detyrimeve pranë kësaj bashkie për vitin 2021, vërtetim i firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm L. D..

Lëshimi i vërtetimit nga Sekretari i Përgjithshëm nuk është në përputhje me kompetencat që përcakton neni 64, germa (gj) “Kompetencat e Kryetarit” të ligjit me nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton se, *Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:*

gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;

-Sa më sipër, është kompetencë e kryetarit të bashkisë, ose personit të autorizuar prej tij, lëshimi i dokumenteve të tilla, në rastin konkret vërtetimit për likuidimin e tarifave vendore. Dokumenti i paraqitur nuk përcakton nëse ka autorizimin përkatës.

6.OE nuk përmbush kriterin e pikës 1/e të Kriterëve të Përgjithshme për likuidimin e faturave të energjisë elektrike. Ky OE ka sjell dokumentin e OSHEE me nr. 147 prot., datë 25.02.2022 i cili përcakton se ky OE ka likuiduar detyrimet deri me këtë datë përfshirë faturën e muajit Janar 2022. Ky dokumentacion është dorëzuar në bashki i noterizuar me datë 27.05.2022, periudhë në të cilën ky OE duhej të likuidonte muajt Shkurt dhe Mars 2022, për të cilat nuk ka paraqitur dokumentacionin përkatës duke rezultuar debitor.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **29,865 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, anëtarët e KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

2. Tenderi me objekt: “Rehabilitimi dhe shtrimi me asfalt-beton të rrugës së fshatit Brezhdan, Bashkia Dibër 2022”.me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton te rrugës se fshatit Brezhdan Bashkia Dibër 2022 ”.

1.Urdhër Prokurimi : Nr.229 datë 03.06.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 229 datë 03.06.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.319, datë 13.06.2022 1. R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 30,416,667 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “S.” Shpk” me ofertë 25,921,980- Lekë, me lidhje kontrate datë 18.08.2022, me afat 5 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 6,295,402 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 29.06.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës 3 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 4,304,924 lekë, vlerë e cila përkon me 14% të investimit. Për vitin 2023 financimi është në vlerën 6,666,666 lekë dhe diferenca do financohet për vitin 2024.

-Financimi për këtë projekt, është në kundërshtim me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 2 teknik ndërtimi, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik. Gjithashtu, sqarohet se dëshmitë e sigurimit teknik, nuk mund të konsiderohen dëshmi kualifikimi për proceset e punës që merren përsipër nga stafi i mësipërm, pasi objekti i këtyre dëshmimeve është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve elektrike dhe jo certifikimi për profilin apo kualifikimin e punonjësve.

2.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohet të paraqitet dokumentacioni i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për disa nga mjetet e paraqitura në këtë procedurë dhe konkretisht:

-Fadroma me targa AA227MC, Grejder me Deklaratë Doganore nr. R 42174 dhe Autobitumatriçe me targa DI4161A, rezultojnë të deklaruara njëkohësisht në procedurën me objekt “Sistemi i Asfaltimit të rrugës së fshatit Selane, Bashkia Dibër 2022” procedurë në të cilën ky OE është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratë për kryerjen e punimeve, në të cilat përfshihet edhe mjetet e mësipërme. Gjithashtu, OE ka dhënë deklaram të rremë në shtojcën

nr. 8, Rubrikën C, në të cilën ka deklaruar se mjetet sipas kësaj shtojce në të cilën përfshihen edhe mjetet e cituara më sipër, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër, dhe do të angazhohen vetëm në realizimin e këtij objekti.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për mjetin Grejder. Për këtë mjet është paraqitur si dokument Deklarata Doganore nr. R 42174, ndërkohë mjeti me goma, i cili shënohet në regjistra publikë, për të cilat duhet të paraqiten dokumentet e nevojshme si leja e qarkullimit, akti i kolaudimit dhe polica e sigurimit, kjo në zbatim të kriterëve të vendosura nga NjP dhe sipas detyrimeve ligjore sipas përcaktimit të nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë neni 8 dhe neni 17.

2.OE nuk përmbush kriterin për 1 Autobitumatriçe. Për këtë mjet, është paraqitur si dokumentacion mjeti me targa DI4161A, i cili sipas fotove të paraqitura rezulton kamionçinë, dhe për këtë mjet nuk është paraqitur njëkohësisht certifikata e pronësisë së mjetit. Ndërkohë, është paraqitur edhe një deklaratë doganore për bitumatriçen, por në DST kërkohet ekzaktësisht mjeti Autobitumatriçe, mjet i posaçëm, ndërkohë mjeti i paraqitur rezulton mjet i montuar, në kundërshtim me kriteret e vendosura.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 1 shofer, dhe konkretisht K. N.. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se Certifikata e Aftësisë Profesionale është jashtë vlefshmërie nga data 09.02.2022.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për 2 kamionçina me kapacitet mbajtës 1.5 – 3.5 Ton. Janë paraqitur 2 mjete dhe konkretisht mjeti me targa AA552BP me kapacitet mbajtës 1.1 Ton dhe mjeti me targa AB553BP me kapacitet mbajtës 0.86 Ton. Sa më sipër, asnjëri nga këto mjete nuk është brenda kapacitetit të kërkuar.

5.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për 1 kamion me kapacitet mbajtës mbi 8 Ton. Mjeti me targa AB237DP, rezulton se ka certifikatën e kontrollit teknik jashtë vlefshmërie nga data 05.07.2022, ndërkohë që dokumentet janë noterizuar me datë 19.07.2022 për tu dorëzuar pranë AK. Sa më sipër, akti i kolaudimit është jashtë vlefshmërie. Ky mjet ka gjithashtu jashtë vlefshmërie edhe certifikatën e transportit të mallrave nga data 05.07.2022. Gjithashtu, ky mjet ka edhe certifikatën e transportit jashtë vlefshmërie nga data 22.03.2022.

6.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për mjetin autovinç. Mjeti i paraqitur me targa DI3850A, ka certifikatën e kontrollit teknik jashtë afatit të vlefshmërisë nga data 15.07.2022, ndërkohë që dokumentet e dorëzuara pranë AK janë të datës 19.07.2022.

7.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku OE ka zhvilluar veprimtarinë e tij për vitin 2021. Ky OE ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Bulqizë për likuidimin e detyrimeve pranë kësaj bashkie për vitin 2021, vërtetim i firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm L. D..

Lëshimi i vërtetimit nga Sekretari i Përgjithshëm nuk është në përputhje me kompetencat që përcakton neni 64, germa (gj) “Kompetencat e Kryetarit” të ligjit me nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton se, *Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:*

gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;

-Sa më sipër, është kompetencë e kryetarit të bashkisë, ose personit të autorizuar prej tij, lëshimi i dokumenteve të tilla, në rastin konkret vërtetimit për likuidimin e tarifave vendore. Dokumenti i paraqitur nuk përcakton nëse ka autorizimin përkatës.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **25,921 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, anëtarët e KVO dhe ish Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

3. Tenderi me objekt: *“Sistemim asfaltim rrugësh kryesore, mbushje gropash, kuneta, trotuare Bashkia Dibër 2022”.me këto të dhëna:*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rrugësh kryesore, mbushje gropash, kuneta, trotuare Bashkia Dibër 2022”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.310 datë 08.06.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.310 datë 08.06.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anëtar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.377, datë 06.07.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,666,450 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “S.” Shpk” me ofertë 6,340,495- Lekë, me lidhje kontrate datë 01.09.2022, me afat 42 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 325,955 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 18.07.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 2,083,333 lekë, dhe vlera e mbetur financohet për vitin 2023.

-Financimi për këtë projekt, është në kundërshtim me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 teknik ndërtimi, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik. Gjithashtu, sqarohet se dëshmitë e sigurimit teknik, nuk mund të konsiderohen dëshmi kualifikimi për proceset e punës që merren përsipër nga stafi i mësipërm, pasi objekti i këtyre dëshmimeve është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve elektrike dhe jo certifikimi për profilin apo kualifikimin e punonjësve.

2.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo

subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t'u kërkohe të paraqitet dokumentacion i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Procesi i vlerësimit të ofertave: -Lidhur me vlerësimin e ofertave, rezulton se hapja e tyre është bërë me datë 18.07.2022 dhe vlerësimi i saj ka zgjatur deri më datë 15.08.2022, pra thuajse një muaj, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Vlerësimi i ofertave: *A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:*

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për disa nga mjetet e paraqitura në këtë procedurë dhe konkretisht:

- Autobitumatriçe me targa DI4161A, kamionçinat me targa AA265FT dhe AA553BP, Rruli Biteli, rezultojnë të deklaruara njëkohësisht në procedurat me objekt *“Sistemim Asfaltim të rrugës së fshatit Selane, Bashkia Dibër 2022”* dhe *“Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton të rrugës së fshatit Brezhdan, Bashkia Dibër 2022”* procedura në të cilën ky OE është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratë për kryerjen e punimeve, në të cilat përfshihet edhe mjetet e mësipërme. Gjithashtu, OE ka dhënë deklaram të rremë në shtojcën nr. 8, Rubrikën C, në të cilën ka deklaruar se mjetet sipas kësaj shtojce në të cilën përfshihen edhe mjetet e cituara më sipër, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër, dhe do të angazhohen vetëm në realizimin e këtij objekt.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin për 1 Autobitumatriçe. Për këtë mjet, është paraqitur si dokumentacion mjeti me targa DI4161A, i cili sipas fotove të paraqitura rezulton kamionçinë, dhe për këtë mjet nuk është paraqitur njëkohësisht certifikata e pronësisë së mjetit. Ndërkohë, është paraqitur edhe një deklaratë doganore për bitumatriçen, por në DST kërkohe ekzaktësisht mjeti Autobitumatriçe, mjet i posaçëm, ndërkohë mjeti i paraqitur rezulton mjet i montuar, në kundërshtim me kriteret e vendosura.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 1 shofer, dhe konkretisht K. N. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se Certifikata e Aftësisimit Profesional është jashtë vlefshmërie nga data 09.02.2022.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për 1 Ekskavator me goma. Janë paraqitur 2 mjete me dokumentacion deklarata doganore R 13549 dhe R 43609, ndërkohë mjetet janë me goma, të cilat shënohet në regjistra publikë, për të cilat duhet të paraqiten dokumentet e nevojshme si leja e qarkullimit, akti i kolaudimit dhe polica e sigurimit, kjo në zbatim të kriterëve të vendosura nga NjP dhe sipas detyrimeve ligjore sipas përcaktimit të nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë neni 8 dhe neni 17.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për 1 autobot uji. Mjeti i deklaruar me targa DI4632A rezulton se ka policën e sigurimit jashtë vlefshmërie nga data 14.07.2022.

5.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për mjetin kamionçinë me targa AA265FA. Ky mjet, krahas faktit që rezulton i angazhuar në kontrata tjera të lidhura nga i njëjti AK, ka gjithashtu certifikatën e kontrollit teknik jashtë vlefshmërie nga data 19.07.2022, ndërkohë dokumentacioni rezulton i noterizuar për tu dorëzuar në AK Bashkia Dibër me datë 22.08.2022. Ky mjet ka gjithashtu certifikatën e transportit të mallrave jashtë afatit të vlefshmërisë nga data 17.07.2022.

6.OE nuk përmbush kriterin e pikës 1/e të Kriterëve të Përgjithshme për likuidimin e OSHEE. Ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 511 prot., datë 29.06.2022 e cila përfshin faturën e muajit Maj 2022, ndërkohë që ky dokument është noterizuar dhe dorëzuar pranë AK me datë

22.08.2022. Ky OE ka për detyrim likuidimin e maturuar i cili në rastin konkret është ai i muajit Qershor 2022 i cili nuk rezulton të jetë likuiduar.

7.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për manovratorin F. S. Dëshmia e Aftësisë Profesionale e këtij manovratori është e vlefshme deri me datë 16.08.2022, ndërkohë dokumentacioni rezulton të jetë noterizuar për tu dorëzuar pranë AK me datë 22.08.2022. Sa më sipër, dokumentacioni i këtij manovratori është jashtë afatit të vlefshmërisë.

8.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku OE ka zhvilluar veprimtarinë e tij për vitin 2021. Ky OE ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Bulqizë për likuidimin e detyrimeve pranë kësaj bashkie për vitin 2021, vërtetim i firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm L. D..

Lëshimi i vërtetimit nga Sekretari i Përgjithshëm nuk është në përputhje me kompetencat që përcakton neni 64, germa (gj) “Kompetencat e Kryetarit” të ligjit me nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton se, *Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:*

gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;

-Sa më sipër, është kompetencë e kryetarit të bashkisë, ose personit të autorizuar prej tij, lëshimi i dokumenteve të tilla, në rastin konkret vërtetimit për likuidimin e tarifave vendore. Dokumenti i paraqitur nuk përcakton nëse ka autorizimin përkatës.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **6,340 mijë lekë** pa TVSH.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, anëtarët e KVO dhe ish Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

4. Tenderi me objekt: “Ndërtim i shtegut turistik Radomirë –Liqen i Zi Bashkia Dibër 2022”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Ndërtimi i shtegut turistik Radomirë – Liqeni i ZI Bashkia Dibër 2022”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.399.datë 21.07.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.399 datë 21.07.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.400, datë 21.07.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 10,430,000- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “K.” me ofertë 9,922,917- Lekë, me lidhje kontrate datë 13.09.2022, me afat 30 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 507,083 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 08.08.2022.	9.Burimi Financimit: Programi për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri (PZHRDH) dhe Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.2 e DST** e cila kërkon nga OE 2

inxhinierë drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa për periudhën Mars 2022 e në vazhdim, që përkon me një periudhë 4 mujore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa c të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar një listë të personelit kryesor, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër personale. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë personelit kryesor, pa qenë e nevojshme që prezenca e tyre në listë pagesa të shtrihet në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 25 punonjës për periudhën Mars 2022 – e në vazhdim, që përkon me një periudhë 4 mujore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

3.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 teknik ndërtimi, 1 manovrator dhe 2 shoferë, 2 murator dhe 1 elektrikist, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

4.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohet të paraqitet dokumentacion i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Procesi i vlerësimit të ofertave: -Me shkresat nr. 3985, 3986, 3987 dhe 3988 prot., datë 19.08.2022, KVO ka bërë kërkesë drejtuar OE për paraqitje të dokumentacionit mbështetës sipas vetëdeklarimit. Dokumentet e kërkuara me njoftimit e mësipërm, janë dokumente që plotësohen nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit dhe nuk argumentohet nga KVO arsyeja përse duhet kërkuar i gjithë dokumentacioni nga OE. Rezulton, se pavarësisht kësaj kërkesë, në dosje administrohet vetëm shkresa e OE “K.” shpk e protokolluar me nr. 4109 prot., datë 29.08.2022 e cila citon listën e dokumenteve të dorëzuara të noterizuara sipas kërkesës për paraqitje dokumentacioni, ndërsa për OE tjerë, nuk administrohet asnjë përgjigje në dosjen e procedurës. Veprimet e mësipërme janë konfunduese, jo ligjore, dhe kanë sjellë vonesa të paargumentuara në vlerësimin e ofertave dhe lidhjen e kontratës.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1. Operatori ekonomik ka paraqitur bilancet për vitet 2019 - 2021 dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit konstatohet që bilancet nuk janë të plota ku mungojnë lista e aseteve të mjeteve nga ku mund të verifikohet nëse OE i disponojnë mjetet e nevojshme për realizimin e punimeve ose jo.

-Lidhur me arsyen e mësipërme, sqarohet se KVO, ka mbajtur qëndrim totalisht të kundërt në s’kualifikimin e 2 OE tjerë në këtë procedurë, konkretisht “A.” shpk dhe “B.” shpk, të cilët janë s’kualifikuar pikërisht për faktin se bilancet e tyre janë të pa plota, pasi nuk përfshijnë listën e aseteve ku të verifikohet nëse disponojnë apo jo mjetet. KVO, nuk e ka përdorur si

kriter s'kualifikimi në asnjë rast arsyen e mësipërme. Gjithashtu, sqarohet se në pikën **2.2.1 të DST** kërkohet që OE duhet të paraqesin bilancet vjetore financiare për vitet 2019, 2020 dhe 2021, të shoqëruara me akt ekspertizën e ekspertit të autorizuar. OE e kanë përmbushur këtë si kriter, duke paraqitur bilancet dhe akt ekspertizat përkatëse, dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të vendoste ta konsideronte arsye s'kualifikimi për sa kohë nuk kërkohet në kërkesën e hartuar në DST. Përkundrazi, rezulton se KVO, ka mbajtur qëndrim të dyfishtë, pasi në 2 raste e konsideron arsye s'kualifikimi, ndërsa në vlerësimin e ofertës fituese, e konsideron të përmbushur, pavarësisht se mungon lista e aseteve.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 1/e të Kriterëve të Përgjithshme, për likuidimin e faturave të energjisë elektrike. Është paraqitur vërtetimi me nr. 1300 prot., datë 27.07.2022 sipas të cilët ky OE ka likuiduar detyrimet për energjinë elektrike deri me këtë datë, duke përfshirë faturën e muajit Qershor 2022. Vlerësimi i ofertave ka përfunduar në Shtator 2022, dhe dorëzimi i dokumenteve të fituesit përllëgaritet të bëhet gjatë këtij muaji. Rezulton se lidhur me likuidimin e faturave të OSHEE, OE nuk ka likuiduar detyrimet për muajin Korrik 2022.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për specialistë të certifikuar sipas profesioneve. Rezulton se hidraulike L. A., 2 muratorët L. M. dhe F. K, elektrikisti A. K., janë të certifikuar nga subjekti AQSCert, subjekt i cili nuk është i akredituar për kryerjen dhe certifikimin e punonjësve për profesionet e mësipërme.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **9,922 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, anëtarët e KVO dhe ish Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

5. Tenderi me objekt: “Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton të rrugës së fshatit Dohoshisht, Bashkia Dibër 2022”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton të rrugës së fshatit Dohoshisht, Bashkia Dibër 2022”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.206.datë 26.04.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.206.datë 26.04.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.282, datë 25.05.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 8,316,047 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “2.” me ofertë 7,077,351 - Lekë, me lidhje kontrate datë 19.08.2022, me afat 28 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 1,238,696 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 14.06.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 1,603,630 lekë, dhe diferenca e mbetur për vitin 2023.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.2 e DST** e cila kërkon nga OE të disponojnë 3 inxhinierë drejtues teknik në licencën e shoqërisë, nga të cilët 1 ndërtim, 1 topograf dhe 1 hidroteknik, që të figurojnë në listëpagesë të paktën nga muaji shkurt 2022 e në vijim, është kërkesë e paargumentuar. Së pari, kërkesa që stafi i inxhinierëve të figurojë në listëpagesa për një periudhë 3 mujore, është në kundërshtim me pikën 6 germa c të nenit 39 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar staf të kualifikuar, por jo detyrimin që stafi të shkrihet në periudha të mëparshme në listëpagesa.

-Gjithashtu, kërkesa që të gjithë inxhinierët duhet të jenë drejtues teknik, nuk është në përputhje me vlerën dhe volumin e punimeve, ku mund të kërkohej të paktën inxhinieri i ndërtimit drejtues teknik, dhe pjesa tjetër të ishte staf mbështetës i shoqërisë.

2.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 30 punonjës për periudhën Shkurt 2021 – e në vazhdim, që përkon me një periudhë 3 mujore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

3.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 2 hidraulik, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkohet me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik. Gjithashtu, sqarohet se dëshmitë e sigurimit teknik, nuk mund të konsiderohen dëshmi kualifikimi për proceset e punës që merren përsipër nga stafi i mësipërm, pasi objekti i këtyre dëshmimeve është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve elektrike dhe jo certifikimi për profilin apo kualifikimin e punonjësve.

4.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohej të paraqitet dokumentacioni i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2021. Ky OE, rezulton se ka deklaruar si punë të ngjashme kontratën e lidhur me

Këshillin e Qarkut Fier për kontratën me objektet *Rikonstruksion i rrugës Kallm i Madh – Kallm i Vogël*” zbatimi i së cilës ka filluar dhe mbaruar përgjatë vitit 2021. Sa më sipër, rezulton se ky OE duhej të likuidonte detyrimet vendore pranë Bashkisë Fier për punimet e kryera në territorin e kësaj bashkie, ndërkohë nuk rezulton të ketë paraqitur vërtetim për likuidim detyrimesh.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për mjetin Grejder. Është deklaruar si mjet i marrë me qira nga subjekti “D.” shpk, ndërkohë për këtë mjet nuk është paraqitur asnjë dokumentacion i nevojshëm përveç kontratës së lidhur mes palëve.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **8,136 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, anëtarët e KVO dhe ish Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

6. Tenderi me objekt: “Rehabilitim dhe shtrimi me asfaltbeton të rrugës së fshatit Kalle, Bashkia Dibër 2022” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim dhe shtrimi me asfaltbeton të rrugës së fshatit Kalle, Bashkia Dibër 2022”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.205.datë 26.04.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.205.datë 26.04.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.224, datë 06.05.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 15,833,333 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “B.” Sh.p.k” me ofertë 13,259,600 - Lekë, me lidhje kontrate datë 30.06.2022, me afat 2 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 2,573,733 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 24.05.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 2.083,333 lekë, për vitin 2023 do financohet vlera e mbetur.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 30 punonjës për periudhën Shkurt 2021 – e në vazhdim, që përkon me një periudhë 3 mujore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 2 teknik ndërtimi, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

3.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohet të paraqitet dokumentacioni i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për disa nga certifikatat ISO. Konkretisht, për certifikatën SSH/EN/ISO 39001:2012, është paraqitur një certifikatë e lëshuar nga R., e cila nuk është lëshuar nga organe të pa akredituara në Shqipëri, ose organizma ndërkombëtar akreditues. Për certifikatën EN ISO 3834-2:2006, është lëshuar nga K. C., e cila rezulton njëkohësisht e lëshuar nga organe të pa akredituara në Shqipëri, ose organizma ndërkombëtar akreditues.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.1 të DST** për punët e ngjashme. OE ka paraqitur kontratën e lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për objektin “Përmirësimi aksesit në sitet turistike dhe lehtësimi i trafikut në zonat urbane në rajonet veriore”. Lidhur me këtë kontratë, mungon Formulari i Vlerësimit, sipas Shtojcës 9, në kundërshtim me kërkesën në DST.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **1/e të Kriterëve të Përgjithshme** për likuidimin e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Nga OE është paraqitur vërtetimi me nr. 813 prot., datë 06.05.2022, i cili përcakton se ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me këtë datë, pa përfshirë faturën e muajit Prill 2022. Rezulton se dokumentacioni është dorëzuar pranë AK gjatë muajit Qershor 2022, dhe dokumentet janë noterizuar me datë 14.06.2022 për tu paraqitur pranë AK, ndërkohë do duhej që të ishte likuiduar detyrimi për muajin Prill 2022, i cili sipas vërtetimit të paraqitur rezultoi i pa likuiduar.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** 1 shofer nga 2 të kërkuar. Për shoferin A. A., nuk është paraqitur leja e drejtimit të mjetit, por vetëm certifikata e aftësisë profesionale, e cila rezultoi jashtë vlefshmërie nga data 20.10.2020.

2.1.OE ka mangësi edhe me 2 teknikët e ndërtimit dhe 1 saldator. Janë deklaruar punonjësit M. B., S. A. dhe N. B., për të cilët është paraqitur si pjesë e dokumentacionit vetëm dëshmi e sigurimit teknik, por nuk është paraqitur asnjë dëshmi profesionale për profesionet e tyre.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për kamionçinën me targa AA438AH. Certifikata e kontrollit teknik të këtij mjeti, është jashtë vlefshmërie nga data 27.06.2021.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **13,259 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, anëtarët e KVO dhe ish Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

7. Tenderi me objekt: “Rehabilitimi dhe shtrimi me asfalt beton të rrugës së fshatit Lacas, Bashkia Dibër 2022” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi dhe shtrimi me asfalt beton të rrugës së fshatit Lacas, Bashkia Dibër 2022”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.94 datë 17.02.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.94 datë 17.02.2023. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. M. D. - (Sp.Fushe) 3. O. Ç. – (Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.108, datë 23.02.2022 1. R. K. – (Kryetar) 2. Q. S. - (Anëtar) 3. E. Sh. – (Anëtar) i ndryshuar me nr. 256, datë 19.05.2022 1.R. D. – Kryetar 2.A. C. – Anëtar 3.M. Sh. - Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 37,725,928 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “B.” Shpk” me ofertë 27,115,782 - Lekë, me lidhje kontrate datë 20.06.2022, me afat 5 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 10,610,146 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 01.04.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 10 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 8 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 3,800,000 lekë, për vitin 2023 në vlerën 8,333,333 lekë dhe vlera 25,616,666 lekë të financohet për vitin 2024.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 2.3.2 e DST e cila kërkon nga OE 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier gjeodet drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listëpagesa nga muaji Dhjetor 2021 e në vazhdim, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen

në periudha të mëvonshme.

2.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 35 punonjës për periudhën Tetor 2021 – e në vazhdim, që përkon me një periudhë 3 muajore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

3.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 teknik ndërtimi, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkrijnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik. Gjithashtu, sqarohet se dëshmitë e sigurimit teknik, nuk mund të konsiderohen dëshmi kualifikimi për proceset e punës që merren përsipër nga stafi i mësipërm, pasi objekti i këtyre dëshmimeve është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve elektrike dhe jo certifikimi për profilin apo kualifikimin e punonjësve.

4.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohej të paraqitet dokumentacion i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Procesi i vlerësimit të ofertave: -Hapja dhe vlerësimi i ofertave ka filluar me datë 01.04.2022 dhe rezulton se ka përfunduar me datë 25.05.2022, pra gati 2 muaj.

-Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës nga KVO, është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për Certifikatën BS ISO 39001:2012 dhe UNI EN ISO 3834-2:2006. Këto certifikata, rezultojnë të lëshuara nga A., por nuk kanë akreditimin nga DPA ose institucione tjera ndërkombëtare akreditues.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 1/e të Kriterëve të Përgjithshme për likuidimin e maturuar të energjisë elektrike. Ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. OSHEE-2022-3056024-XR, datë 26.03.2022 sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet deri në këtë datë përfshirë faturën e muajit Shkurt 2022. Në kushtet kur OE ka dorëzuar dokumentacionin i cili është i noterizuar me datë 28.05.2022, rezulton se ka nuk ka likuiduar detyrimet e muajit Mars 2022, detyrim i cili duhet të ishte likuiduar për përmbushjen e kriterin.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3 të DST** për disa nga specialistët e kërkuar dhe konkretisht:

-Për 2 manovratorë, janë paraqitur dokumente për punonjësit B. I. dhe Sh. P., për të cilët nuk është paraqitur dëshmia e sigurimit teknik.

-Për 2 shoferë, janë deklaruar dhe paraqitur dokumentacion për G. M. dhe V. Z.. Për asnjërin nga këta punonjës nuk është paraqitur dëshmi e sigurimit teknik. Për shoferin G. M., rezulton

se ka lejen e drejtimit për kategoritë C e sipër që përkon me mjetet e nevojshme, jashtë vlefshmërie nga data 21.05.2022.

-Për 1 Teknik ndërtimi dhe 1 Saldator, janë deklaruar dhe paraqitur dokumentacion për punonjësit F. F, dhe F. H.. Për të dy punonjësit, mungon dëshmi e sigurimit teknik, ndërsa për saldatorin F. H., nuk është paraqitur gjithashtu asnjë certifikatë që të paraqesë kualifikimin e tij.

3.OE nuk përmbush kriterin për 1 Autobotumatriçe. Për këtë mjet, është paraqitur si dokumentacion mjeti me targa DI4161A, i cili sipas fotove të paraqitura rezulton kamionçinë, dhe për këtë mjet nuk është paraqitur njëkohësisht certifikata e pronësisë së mjetit. Ndërkohë, është paraqitur edhe një deklaratë doganore për bitumatriçen, por në DST kërkohet ekzaktësisht mjeti Autobotumatriçe, mjet i posaçëm, ndërkohë mjeti i paraqitur rezulton mjet i montuar, në kundërshtim me kriteret e vendosura.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për disa nga mjetet dhe konkretisht, për kamionin mbi 8 Ton me targa AA230LV dhe autobotin e ujit me targa AA217JY, mjete të cilat janë marrë me qira. Rezulton se certifikata e transportit për këto mjete është për transportin e vet subjektit dhe jo për të tretë dhe me qira, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit me nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, i cili citon se:

Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **27,115 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, anëtarët e KVO dhe ish Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

8. Tenderi me objekt: “Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton i lagjes Kallavere Peshkopi, Bashkia Dibër 2022” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton i lagjes Kallavere Peshkopi, Bashkia Dibër 2022”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.289.datë 30.05.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.289.datë 30.05.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anëtar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.290, datë 01.06.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 15,416,667 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “A. Sh.p.k” me ofertë 14,145,891- Lekë, me lidhje kontrate datë 16.08.2022, me afat 2 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 1,270,776 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 17.06.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 2.500.000 lekë, për vitin 2023 do financohet vlera e mbetur.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 teknik ndërtimi, 1 hidraulik, 1 hekurkthyes, 1 specialist i certifikuar për montim tubo HDPE, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

2.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohet të paraqitet dokumentacioni i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Procesi i vlerësimit të ofertave: -Hapja dhe vlerësimi i ofertave ka filluar me datë 17.06.2022 dhe rezulton se ka përfunduar me datë 19.07.2022, pra mbi 1 muaj.

-Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës nga KVO, është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2021. OE nuk ka deklaruar sipas shtojcës 8 likuidimin e tyre.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 1 specialist të certifikuar për montim tubo HDPE. Në shtojcën 8 nuk është bërë deklarimi i këtij specialisti.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për Certifikatën BS ISO 39001:2012 dhe UNI EN ISO 3834-2:2006. Këto certifikata, rezultojnë të lëshuara nga A., por nuk kanë akreditimin nga DPA ose institucione tjera ndërkombëtare akreditues.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për mjetin autobitumatriçe. Për këtë mjet, është deklaruar në shtojcën 8 Bitumatriçe e marrë me qira, ndërkohë që kërkohet autobitumatriçe, mjet i cili ka edhe dokumentacionin e nevojshëm përfshirë targimin e tij, të cilat nuk janë deklaruar në shtojcën nr. 8.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3 të DST** për punësim mesatar prej 30 punonjës. Për muajin Mars ka paraqitur një listë pagesë me 39 punonjës, nga të cilët 28 prej tyre kanë nga 0 deri në 2-6 ditë punë të siguruar. Për muajin Prill ka paraqitur listëpagesën me 40 punonjës, nga të cilët 27 kanë nga 0 deri në 2-6 ditë punë të siguruar. Nga sa më sipër, rezulton se ky OE, nuk jep garanci se disponon stafin e nevojshëm për kryerjen e punimeve për periudhën objekt auditimi, ose ka shmangur detyrimet për stafin e punonjësve duke mos respektuar legjislacionin përkatës për kontributet dhe sigurimet shoqërore sipas legjislacionin në fuqi, duke dhënë deklarim të rremë në shtojcën nr. 8.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 2 shoferë. Është deklaruar si shofer G. M., për të cilin rezulton se leja e drejtimit për kategorinë C të mjeteve që është e nevojshme për llojin e mjeteve të kërkuara, është jashtë vlefshmërie nga muaji Mars i vitit 2019. Për

shoferin Elsin Liçi, nuk është paraqitur e plotë leja e drejtimit, pasi mungojnë të dhënat e vlefshmërisë së afatit për kategorinë C të drejtimit. Për të dy shoferët, mungojnë edhe dëshmitë e sigurimit teknik.

-Për 2 manovratorët, R. N. dhe A. N., mungojnë dëshmitë e sigurimit teknik.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2/b të DST** për 1 punonjës *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*. Është deklaruar punonjësi L. K., i cili ka certifikatë të lëshuar nga A., shoqëri e cila nuk është e akredituar për lëshimin e certifikatave të trajnimit për punonjës.

-Për hidraulikun I. H., specialistin e tubave HDPE M. H., dhe hekurkthyesin Sh. H., janë paraqitur dëshmi të lëshuara nga A., shoqëri e cila nuk është e akredituar për lëshimin e certifikatave të trajnimit për punonjës.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për disa nga mjetet dhe konkretisht:

-Për mjetin fadromë me targa AIMT 47, rezulton se polica e sigurimit nuk është në emër të shoqërisë, por në emër të shtetasit Z. Gj.. Polica rezulton gjithashtu jashtë vlefshmërie nga data 30.06.2022, ndërkohë që dokumentet janë noterizuar me data 20.07.2022 dhe dorëzuar pranë AK me datë 21.07.2022

-Për mjetin me targa AA031GU i marrë me qira nga subjekti G. R., polica e sigurimit rezulton jashtë vlefshmërie nga data 30.06.2022 ndërkohë që dokumentet janë noterizuar me data 20.07.2022 dhe dorëzuar pranë AK me datë 21.07.2022.

C. Lidhur me vlerësimin e kryer nga KVO të ofertës ekonomike të OE K.T. shpk, me ofertë në vlerën 12,239,889 lekë ka rezultuar si vijon:

-Arsyet e s'kualifikimit të këtij OE, rezulton të jetë fakti se Tekniku i Ndërtimit F. Z. dhe hidrauliku Q. B., rezultojnë të punësuar me nga 5 ditë për muajin Mars – Prill 2022, në kundërshtim me deklaratën sipas shtojcës 8, si dhe lidhur me vërtetimin e energjisë elektrike, është paraqitur vërtetimi nr. OSHEE me nr. OSHEE-2022-3914251-OU datë 10.05.2022, ku në rastin konkret rezulton pa likuiduar fatura e muajit Prill 2022.

-Lidhur me arsyet e s'kualifikimit, sqarohet se KVO ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, dhe ka mbajtur standarde të dyfishta në vlerësimin e ofertave. Lidhur me punonjësit Q. B. dhe F. Z., të cilët janë deklaruar në shtojcën nr. 8, për KVO duhet të jetë e mjaftueshme, kjo sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, e cila përcakton formularin e vetëdeklarimit si mjetin e nevojshëm në këtë fazë të vlerësimit. Lidhur me këtë vlerësim KVO ka mbajtur standard të dyfishtë pasi, rezulton se vetë OE i kualifikuar dhe shpallur fitues, ka më shumë se 75% të stafit të deklaruar me 0 deri 6 ditë pune, përfshirë punonjësin I. H. 2 ditë punë, E. L. 5 ditë pune, Sh. H. 5 ditë pune, M. H. 5 ditë pune etj.

-Gjithashtu, arsyet e s'kualifikimit për likuidimin e faturave të OSHEE është jo në përputhje me rregullat e LPP, pasi edhe kjo pikë plotësohet nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit, veprim i cili është kryer nga OE dhe sa më sipër nuk qëndron si arsyet e s'kualifikimit.

Sa më sipër, konstatohet se kualifikimi i pa drejtë i OE "A." shpk, dhe s'kualifikimi për arsye të padrejta të OE "K.T." shpk, ka sjellur keqpërdorim të fondeve publike në vlerën 1,906,002 lekë, si diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të s'kualifikuar padrejtësisht, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **23,045 mijë lekë** pa TVSH. Shpenzim pa economicitet në vlerën **1,906 mijë lekë**.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, anëtarët e KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

9. Tenderi me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Tomin, Bashkia Dibër 2022” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Tomin, Bashkia Dibër 2022”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.427.datë 05.08.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.427.datë 05.08.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anëtar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.472, datë 23.08.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 14,164,639 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “A. Sh.p.k” me ofertë 13,306,676- Lekë, me lidhje kontrate datë 07.12.2022, me afat 2 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 857,963 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 27.09.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 2.500.000 lekë, për vitin 2023 do financohet vlера e mbetur.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 teknik ndërtimi, 1 murator, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

2.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohet të paraqitet dokumentacion i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Procesi i vlerësimit të ofertave: -Hapja dhe vlerësimi i ofertave ka filluar me datë 27.09.2022 dhe rezulton se ka përfunduar me datë 01.11.2022, pra mbi 1 muaj.

-Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës nga KVO, është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.

Vlerësimi i ofertave: *A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:*

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2021. OE nuk ka deklaruar sipas shtojcës 8 likuidimin e tyre.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për disa nga mjetet e paraqitura dhe konkretisht, mjetin fadrom me targa AKMT87, mjetin rrul sipas deklaratës doganore të datës 21.06.2017, mjetin Grejder. Këto mjete rezultojnë të angazhuara në kontratën e lidhur ndërmjet këtij subjekti dhe Bashkisë Dibër me datë 16.08.2022 me objekt **Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton i lagjes Kallavere Peshkopi, Bashkia Dibër 2022**. Është e njëjta KVO që ka bërë dy vlerësimet dhe duhej të evidentonte deklarimin e rremë të dhënë nga ky OE ky citon sipas pikës C të shtojcës se mjetet e poshtëshënuara, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për Certifikatën BS ISO 39001:2012 dhe UNI EN ISO 3834-2:2006. Këto certifikata, rezultojnë të lëshuara nga A., por nuk kanë akreditimin nga DPA ose institucione tjera ndërkombëtare akreditues.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për 1 kamion, për mjetin Autovinç dhe miniekskavator. Është deklaruar vetëm 1 kamion në shtojcë, ndërsa për 2 mjetet tjera nuk janë bërë deklarimet përkatëse në shtojcën 8.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **1/e të Kriterëve të Përgjithshme** për likuidimin e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Nga OE është paraqitur vërtetimi me nr. OSHEE2022-8999504-PS, datë 15.09.2022, i cili përcakton se ky OE ka likuiduar detyrimet e llogaritura deri me këtë datë, përfshirë faturën e muajit Shtator 2022. Lidhur me këtë përmbajtje, sqarohet se detyrimet e muajit Shtator nuk janë gjeneruar akoma në sistemin e OSHEE për të cilin të kryhet ky likuidim. U verifikua vërtetimi i paraqitur dhe i ngarkuar në SPE me vërtetimin e paraqitur dhe të ngarkuar në SPE në procedurën me objekt **Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton i lagjes Kallavere Peshkopi, Bashkia Dibër 2022** nga ku ka rezultuar se të dy vërtetimet kanë të njëjtin nr. serial. Rezulton se të dhënat digjitale të faturës së OSHEE, mbajnë datën 2022.06.15 07:13.04 + 02'00'.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3 të DST** për punësim mesatar prej 25 punonjës. Për muajin Maj 2022 ka paraqitur një listë pagesë me 37 punonjës, nga të cilët vetëm 4 prej tyre janë me ditë të plota pune, ndërkohë të tjerët variojnë me nga 0 ditë pune deri në 10 ditë pune. Për muajin Qershor 2023 ka paraqitur listëpagesën me 38 punonjës, nga të cilët vetëm 4 prej tyre janë me ditë të plota pune, dhe pjesa tjetër prej 34 punonjës janë me 0 deri në 10 ditë pune. Për muajin Korrik 2023, ka paraqitur një listë pagesë me 37 punonjës, nga të cilët vetëm 4 prej tyre janë me ditë të plota pune, dhe pjesa tjetër me 0 deri në 10 ditë pune. Nga sa më sipër, rezulton se ky OE, nuk jep garanci se disponon stafin e nevojshëm për kryerjen e punimeve për periudhën objekt auditimi, ose ka shmangur detyrimet për stafin e punonjësve duke mos respektuar legjislacionin përkatës për kontributet dhe sigurimet shoqërore sipas legjislacionin në fuqi, duke dhënë deklarim të rremë në shtojcën nr. 8.

-Gjithashtu, ky OE ka kontratë tjetër të lidhur me AK Bashkia Dibër me objekt **Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton i lagjes Kallavere Peshkopi, Bashkia Dibër 2022**, në të cilën ka deklaruar angazhimin e 30 punonjësve, ndërkohë në procedurën objekt shqyrtimi, nevojiten edhe 25 punonjës tjerë. Sa më sipër, ky OE ka me gjithë mangësitë e trajtuara, ka 37 punonjës në listëpagesë, 30 të angazhuar në kontratën e mësipërme dhe ngelet me mangësi prej 18 punonjës tjerë.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 2 shoferë. Është deklaruar si shofer G. M., për të cilin rezulton se leja e drejtimit për kategorinë C të mjeteve që është e nevojshme për llojin e mjeteve të kërkuara, është jashtë vlefshmërie nga muaji Mars i vitit 2019. Për

shoferin E. L., nuk është paraqitur e plotë leja e drejtimit, pasi mungojnë të dhënat e vlefshmërisë së afatit për kategorinë C të drejtimit. Për të dy shoferët, mungojnë edhe dëshmitë e sigurimit teknik.

-Për 2 manovratorët, A. K. dhe A. N., mungojnë dëshmitë e sigurimit teknik.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2/b të DST** për 1 punonjës *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*. Është deklaruar punonjësi L. K., i cili ka certifikatë të lëshuar nga A., shoqëri e cila nuk është e akredituar për lëshimin e certifikatave të trajnimit për punonjës.

-Për muratorët L. K. dhe Xh. Xh., janë paraqitur vetëm dëshmitë e sigurimit teknik, por nuk është paraqitur asnjë dokument apo dëshmi që certifikon specializimin për profilin e kërkuar.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **13,306 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, anëtarët e KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

10. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion shkolla 9 – vjeçare “Irfan Hajrullai” Peshkopi, Bashkia Dibër 2022”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Irfan Hajrullai”, Peshkopi Bashkia Dibër 2022.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.428 datë 05.08.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 428 datë 05.08.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. F. T. - (Anëtar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.440, datë 11.08.2022 1. R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	6.Oferta fituese: BOE “A.” Shpk” & “A.” me ofertë 47,682,957 - Lekë, me lidhje kontrate datë 25.11.2022, me afat 4 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 563,529 - lekë pa tvsh
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 48,246,485 - lekë pa tvsh	8.Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 08.09.2022.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 Arkitekt, nuk përputhet me objektin e prokurimit. Nuk parashikohet asnjë element që lidhet me arkitekturën pasi projekti është i miratuar dhe kërkohet zbatimi i tij. Nuk ka zëra për të cilat të kërkohet asistenca e arkitektit.

2.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 inxhinier mekanik, 1 arkitekt, 2 teknik ndërtimi, 1 murator, 2 hidraulik, 1 hekurkthyes, 2 karpentier, 1 mekanik, 2 pllakashtrues, 1 manovrator dhe 4 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të

cilat kërkojnë dëshmitë e sigurimit teknik.

3.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 50 punonjës për periudhën Maj 2022 – e në vazhdim, që përkon me një periudhë 3 muajore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

Procesi për vlerësimin e ofertave: -Dorëzimi i ofertave në këtë procedurë është bërë me datë 08.09.2022, dhe vlerësimi i tyre rezulton të ketë përfunduar me datë 13.10.2022, pra më shumë se 1 muaj nga dorëzimi i ofertave.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës nga KVO, është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE “A.I.C” shpk, i cili ka marrë përsipër kryerjen e 36.24% të punimeve, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.1 të DST** pasi nuk ka paraqitur asnjë punë të ngjashme. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistem, janë 3 punë të ngjashme të cilat janë kryer nga subjekti tjetër, dhe konkretisht “A.I.G.C”

2.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për certifikatën ISO 3834-2:2006. Këtë certifikatë ka paraqitur OE “A.I.G.C” shpk e cila rezulton jashtë vlefshmërie nga data 03.07.2022.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE “A.I.C” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës 1/e të Kriterëve të Përgjithshme, për likuidimin e faturave të maturuara të OSHEE. Ky OE ka dorëzuar vërtetimin me nr. OSHEE-2022-9649645-DI, datë 30.08.2022, i cili përcakton se ky OE ka likuiduar detyrimet përfshirë muajin Korrik 2022. Ky dokument është noterizuar dhe dorëzuar pranë AK me datë 30.10.2022. Sa më sipër, ky OE rezulton se nuk ka përfshirë faturën e muajit Gusht, duke rezultuar debitor.

2.OE “A.I.G.C” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës 1/e të Kriterëve të Përgjithshme, për likuidimin e faturave të maturuara të OSHEE. Ky OE ka dorëzuar vërtetimin me nr. OSHEE-2022-5434816-ZD, datë 29.08.2022, i cili përcakton se ky OE ka likuiduar detyrimet përfshirë muajin Korrik 2022. Ky dokument është noterizuar me datë 15.10.2022. Sa më sipër, ky OE rezulton se nuk ka përfshirë faturën e muajit Gusht, duke rezultuar debitor.

3.OE “A.I.G.C” nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për stafin e specialistëve, për të cilat është kërkuar të disponojnë certifikatë/dëshmi kualifikimi, si dhe dëshmitë e sigurimit teknik. I gjithë stafi i specialistëve të deklaruar nga ky OE, kanë paraqitur si dokument një certifikatë të lëshuar nga QKL, por për asnjërin nga stafi i specialistëve, nuk është paraqitur dëshmia e sigurimit teknik.

4.OE “A.I.C.” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për stafin e specialistëve, për të cilat është kërkuar të disponojnë certifikatë/dëshmi kualifikimi, si dhe dëshmitë e sigurimit teknik. Për të gjithë stafin e paraqitur, është paraqitur si dokumentacion vetëm dëshmia e sigurimit teknik, dëshmi e cila nuk përcakton kualifikimin e punonjësve. Nuk është paraqitur asnjë dokument si dëshmi kualifikimi apo certifikatë për profesionin e tyre.

-Njëkohësisht, për 1 manovrator dhe 4 shoferët e kërkuar, për asnjërin prej tyre, nuk është paraqitur dëshmi e sigurimit teknik, sipas kërkesës në DST.

5.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për 2 Autobetoniere. Janë paraqitur 2 mjetet me targa AA549DV dhe AA550DV. Për këto dy mjete, dokumentacioni i të cilave është noterizuar për tu dorëzuar në AK mban datën 15.10.2022, ndërkohë rezulton se polica e sigurimit për këto mjete ka skaduar me datë 07.10.2022, ndërsa Certifikata e Kontrollit Teknik me datë 08.10.2022. Sa më sipër, mjetet e mësipërme kanë dokumentacion jashtë afatit të vlefshmërisë.

6.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për 1 Autobot Uji me sprucator. Është deklaruar mjeti me targa AB835FK, ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, rezulton se certifikata e pronësisë së mjetit dhe polica e sigurimit është për mjetin me targa AB593MS. Sa më sipër, nuk përputhen të dhënat e dokumentacionit me ato të mjetit të deklaruar.

7.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për mjetin Autobot Uji. Është deklaruar mjeti me targa AB553DZ, mjet për të cilin nuk është paraqitur leja e transportit.

8.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku OE ka zhvilluar veprimtarinë e tij për vitin 2021. OE “A.I.G.C” shpk, ka paraqitur 2 vërtetimi të lëshuara nga Bashkia Librazhd dhe nga Bashkia Sarandë që mban firmën e Drejtorit të të Ardhurave.

Lëshimi i vërtetimit nga personeli i mësipërm, nuk është në përputhje me kompetencat që përcakton neni 64, germa (gj) “Kompetencat e Kryetarit” të ligjit me nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton se, *Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:*

<i>gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;</i>
--

-Sa më sipër, është kompetencë e kryetarit të bashkisë, ose personit të autorizuar prej tij, lëshimi i dokumenteve të tilla, në rastin konkret vërtetimit për likuidimin e tarifave vendore. Dokumenti i paraqitur nuk përcakton nëse ka autorizimin përkatës.

-E njëjta mangësi është edhe për OE “A.I.C” shpk, vërtetimi i së cilës është lëshuar nga Drejtor i të Ardhurave në Bashkinë Librazhd.

C. Gjithashtu, KVO ka ndjekur standard të dyfishtë në vlerësimin e ofertave. Rezulton se OE A. me ofertë në vlerën **41,789,880 lekë**, është s’kualifikuar për disa mangësi që lidhen me punët e ngjashme, për të cilat OE i ka ngarkuar në sistem dhe jep garanci për kryerjen e tyre, pavarësisht se mund ti mungojnë disa dokumente, ndërkohë në vlerësimin e ofertës fituese, KVO e ka konsideruar të përmbushur kriterin për punë të ngjashme, ndërkohë figuron se njëri nga OE nuk ka paraqitur asnjë punë të tillë. Sa më sipër, rezulton se KVO duke shpallur fitues BOE, kryer shpenzime pa ekonomikitet në vlerën **5,893,077 lekë**, si diferencë ndërmjet ofertës ekonomike të këtij OE, me atë të OE “A.”, e cila është s’kualifikuar për devijime të vogla, të cilat në thelb nuk cenonin zbatimin e kontratës.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **47,682 mijë lekë** pa TVSH. Shpenzim pa ekonomikitet në vlerën **8,893 mijë lekë**.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

11. Tenderi me objekt: “Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje e kanaleve vaditëse të njësive Administrative” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje e kanaleve vaditëse të njësive Administrative” Bashkia Dibër 2022.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.121.datë 03.03.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.121 datë 03.03.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. M. D. - (Sp.Fushe) 3. F. T. – (Anëtar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.122, datë 03.03.2022 1.O. Ç. – (Kryetar) 2. E. Sh. - (Anëtar) 3. Q. S. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 9,166,513- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE “R. & F.” me ofertë 7,662,610 - Lekë, me lidhje kontrate datë 25.05.2022, me afat 25 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 1,503,903 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 01.04.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 1,833,333 lekë, dhe për vitin 2023 do financohet vlera e mbetur e projektit.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE 1 inxhinier ndërtimi, 1 topograf, 1 hidroteknik dhe 1 mjedisi drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listëpagesa nga muaji Dhjetor 2021 – Shkurt 2022, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa c të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqi punëtore të kualifikuar për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky staf i kualifikuar. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë stafin e nevojshëm për zbatimin e kontratës.

-Gjithashtu, lidhur me pikën e mësipërme, audituesit sqarojnë se kërkesa që gjithë stafi prej 4 inxhinierësh të jetë njëkohësisht drejtues teknik, është kërkesë e tepërt, pasi do mjaftonte që njëri prej tyre (ndërtim ose hidro) të ishte drejtues teknik, dhe pjesa tjetër do ishte e mjaftueshme edhe si staf mbështetës. Kërkesa nuk është në raport me vlerën dhe volumin e punimeve.

2.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 35 punonjës për periudhën Dhjetor 2021 – Shkurt 2022, që përkon me një periudhë 3 mujore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në

momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

3.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 2 teknik ndërtimi, 2 manovratorë, 2 shoferë, 1 murator, 1 specialist për montim tubosh dhe 1 hekurlidhës të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik. Gjithashtu, sqarohet se dëshmitë e sigurimit teknik, nuk mund të konsiderohen dëshmi kualifikimi për proceset e punës që merren përsipër nga stafi i mësipërm, pasi objekti i këtyre dëshmimeve është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve elektrike dhe jo certifikimi për profilin apo kualifikimin e punonjësve.

3.1. Gjithashtu, kërkesa për një hekurlidhës, është kërkesë e pa përshtatshme, pasi referuar VKM-së nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP, e rishikuar”, nuk ka asnjë pozicion pune të përcaktuar për hekurlidhës. Pozicioni i vetëm i përshtatshëm është hekurkthyes.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore. Në shtojcën nr. 8 “Formulari i vetëdeklarimit”, nuk është deklaruar nga asnjëri prej BOE likuidimi i detyrimeve vendore.

2.OE “R.” shpk, i cili ka marrë përsipër kryerjen e 53.4% të punimeve, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për certifikatën UNI EN-ISO 3834-2:2006. Certifikata e paraqitur është e lëshuar nga A., e cila nuk ka akreditimin nga organe kombëtare ose ndërkombëtare akreditimi për këtë certifikatë ISO.

3.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 1 specialist për montim tubash. Në shtojcën nr. 8 “Formulari i vetëdeklarimit”, nuk është deklaruar nga asnjëri prej OE specialisti për montimin e tubave.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **7,662 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

12. Tenderi me objekt: “Rikonstruktion i ujësjellësit brendshëm për fshatrat Lishan i Epërm, Arap i Epërm, NJA Luzni” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruktion i ujësjellësit brendshëm për fshatrat Lishan i Epërm, Arap i Epërm, NJA Luzni”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.237.datë 12.05.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.237.datë 12.05.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anëtar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.255, datë 19.05.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2.A. C. - (Anëtar) 3.M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 12,708,333 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “E.” me ofertë 9,789,909- Lekë, me lidhje kontrate datë 04.08.2022, me afat 2 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 2,918,424 - lekë pa tvsh

8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 13.06.2022.	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 2,541,666 lekë, për vitin 2023 do financohet vlera e mbetur.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2. Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kritereve: 1. Kërkesa e pikës **2.3.2 e DST** e cila kërkon nga OE 3 inxhinierë drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa për periudhën Shkurt 2022 e në vazhdim, që përkon me një periudhë 3 mujore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa c të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar një listë të personelit kryesor, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër personale. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë personelit kryesor, pa qenë e nevojshme që prezenca e tyre në listë pagesa të shtrihet në periudha të mëvonshme.

2. Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE fuqi minimale punëtore prej 35 punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa për periudhën Shkurt 2022 e në vazhdim, që përkon me një periudhë 3 mujore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

3. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 2 teknik ndërtimi, 1 teknik mekanik, 3 hidraulik, 2 specialist i certifikuar për montim tubo HDPE, 2 manovratorë, 3 shoferë, 1 vinçier, 2 karpentier, 1 hekurkthyes, 1 hidroizolues dhe 1, të cilët të figurojnë në listëpagesa të paktën muajin e fundit, të cilët duhet të disponojnë gjithashtu dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkrijnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik. 3.1. Gjithashtu, kërkesa për 1 teknik mekanik, 2 specialist tubosh HDPE dhe 1 vinçier të cilët duhet të figurojnë në listëpagesë muajin e fundit, është kufizuese. AK duhej të mundësonte që specialistë të tillë të sigurohen edhe me kontrata shërbimi për objektin e prokurimit, pa qenë domosdoshmëri prezenca e tyre në listëpagesa.

Procesi i vlerësimit të ofertave: -Hapja dhe vlerësimi i ofertave ka filluar me datë 13.06.2022 dhe rezulton se ka përfunduar me datë 06.07.2022, pra mbi 3 javë.

-Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës nga KVO, është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit

82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2021. OE nuk ka deklaruar sipas shtojcës 8 likuidimin e tyre.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2/a të DST** për stafin e inxhinierëve. Në shtojcën 8, formulari i vetëdeklarimit, nuk është deklaruar asnjë inxhinier hidroteknik, në kundërshtim me DST.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2/b të DST** për një punonjës *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*. Në shtojcën Nr. 8, nuk është deklaruar asnjë punonjës sipas kësaj kërkesë.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 3 hidraulik, 2 specialist për montim tubo HDPE, 1 hekurkthyes dhe 1 hidroizolues. Në shtojcën nr. 8, formulari i vetë deklarimit, nuk është deklaruar asnjë nga specialistët e kërkuar në DST.

5.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për certifikatën EN ISO 3834-2:2006. Nga verifikimi rezulton se certifikata e paraqitur është lëshuar nga A., e cila nuk është e akredituar për lëshimin e kësaj certifikate nga organe kombëtare ose ndërkombëtare akreditimi.

6.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për mjetet ekskavator me zinxhirë dhe mini ekskavator me zinxhirë. Në shtojcën nr. 8, nuk është deklaruar asnjëri nga këto mjete.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për stafin e specialistëve të nevojshëm për zbatimin e kontratës. Në listëpagesën e paraqitur, OE ka pjesën më të madhe të stafit të specialistëve të kërkuar dhe të deklaruar në shtojcën 8, me 1 ditë pune ose mungojnë në listëpagesë. Konkretisht, punonjësit E. Sh., A. D., K. L., P. M., J. M., F. Ç., A. P., F. D., S. S., I. D., A. Sh., D. K., E. R., A. D., M. B. dhe I. Xh., rezultojnë të gjithë me nga 1 ditë pune në listëpagesë, ndërsa punonjësit tjerë të deklaruar në shtojcën nr. 8 si B. D., A. R., M. G., P. G., T. L. dhe Sh. Sh., nuk figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Nga sa më sipër, rezulton se ky OE, nuk jep garanci se disponon stafin e nevojshëm për kryerjen e punimeve për periudhën objekt auditimi, ose ka shmangur detyrimet për stafin e punonjësve duke mos respektuar legjislacionin përkatës për kontributet dhe sigurimet shoqërore sipas legjislacionin në fuqi, duke dhënë deklarim të rremë në shtojcën nr. 8.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **9,096 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

13. Tenderi me objekt: “Sistemim Asfaltim të rrugës Ura e Luznisë -Kryqëzimi i rrugës së fshatit Lishan me fshatin Hotesht, Faza I” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim Asfaltim të rrugës Ura e Luznisë -Kryqëzimi i rrugës së fshatit Lishan me fshatin Hotesht, Faza I”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.473 datë 23.08.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.473 datë 23.08.2023. 1. I. S. – (P/Prokurimi)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.471, datë 23.08.2022 1. R. D. – (Kryetar)

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	2. O. Ç. - (Anëtar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 36,666,667 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “C.” Shpk” me ofertë 30,371,265 - Lekë, me lidhje kontrate datë 24.02.2022, me afat 4 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 6,295,402 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 16.09.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata: Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 9,166,666 lekë, për vitin 2023 në vlerën 5,500,000 lekë dhe diferenca të financohet për vitin 2024.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.2 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 inxhinier gjeolog, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, nuk është në përputhje me objektin e prokurimit, dhe aq më pak të jetë edhe drejtues teknik. Nuk ka zëra që të kërkohej ekspertiza e inxhinierit gjeolog. Gjithashtu, kërkesa që inxhinieri hidroteknik të jetë drejtues teknik në licencë, është gjithashtu e tepërt, pasi do ishte e mjaftueshme që ky inxhinier të disponohej edhe si punonjës në listëpagesë, pa qenë e nevojshme të jetë drejtues teknik.

2.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 40 punonjës për periudhën Maj 2022 – e në vazhdim, që përkon me një periudhë 3 mujore, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

3.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon 2 teknik ndërtimi, 3 manovratorë, 3 shoferë dhe 1 murator, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

4.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohej të paraqitet dokumentacion i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Procesi i vlerësimit të ofertave: -Hapja dhe vlerësimi i ofertave është bërë me datë 16.09.2022 dhe vlerësimi ka zgjatur deri me datë 25.11.2022, pra ka zgjatur me shumë se 2

muaj.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës nga KVO, është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** e cila kërkon nga OE Deklarimin në fazën e ofertimit për Shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Vitin 2021. Ky OE nuk ka paraqitur sipas shtojcës 8 deklarin përkatës.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021. Ky OE rezulton se ka lidhur kontratë me Bashkinë Tiranë për objektin “Rikonstruksion i rrugëve “Sabaudin Gabrani” dhe “Leka i Madh”. Përfundimi i punimeve sipas formularit të vlerësimit rezulton të jetë data 26.07.2021. Nga ky dokument, rezulton se ky OE ka kryer punime përgjatë vitit 2021 në Bashkinë Tiranë, ndërkohë nuk rezulton se ka likuiduar detyrimet vendore.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 1 murator. Për të përmbushur këtë kriter është paraqitur punonjësi B. A., me certifikatë të lëshuar nga A. Nga faqja web e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, rezulton se subjekti A.t, nuk ka fushë veprimi të licencuar dhe akredituar trajnimin e punonjësve dhe certifikimin e tyre.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për mjetin Grejder. Nga OE është paraqitur mjeti grejder i marrë me kontratë qiraje nga subjekti “G. C.” shpk, për të cilin është paraqitur si dokument Deklarata Doganore nr. R 26465, ndërkohë mjeti është me goma, i cili shënohet në regjistra publikë, për të cilat duhet të paraqiten dokumentet e nevojshme si leja e qarkullimit, akti i kolaudit dhe polica e sigurimit, kjo në zbatim të kriterëve të vendosura nga NjP dhe sipas detyrimeve ligjore sipas përcaktimit të nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë neni 8 dhe neni 17.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **30,371 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

14. Tenderi me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së Lagjes Llixha, Bashkia Dibër 2022” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së Lagjes Llixha, Bashkia Dibër 2022”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.551.datë 06.10.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.551.datë 06.10.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.552, datë 06.10.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 14,166,296 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “S.” Sh.p.k” me ofertë 13,942,300 - Lekë, me lidhje kontrate datë 07.12.2022, me afat 2 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 223,996 - lekë pa tvsh

8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 27.10.2022.	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 2.000.000 lekë, për vitin 2023 do finanohet vlera e mbetur.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2. Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1. Kërkesa e pikës **2.3/a/b e DST** e cila kërkon nga OE Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% (a) dhe punë të ngjashme ku vlera monetare e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 viteve të fundit është jo më e madhe se dyfishi i vlerës që prokurohet, janë kërkesa të hartuara gabim, pasi nga NjP do duhej të përdoret **jo më e vogël se** përqindja e përcaktuar. Hartimi në këtë mënyrë i kësaj kërkesë, mund të krijojë konfuzion për OE.

2. Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE staf të nevojshëm për kryerjen e punimeve 30 punonjës për periudhën Qershor 2021 – e në vazhdim, që përkon me një periudhë 4 muaj, është kërkesë jo në përputhje me pikën 6 germa ç të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës OE të disponojnë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha të mëvonshme.

3. Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 2 teknik ndërtimi, 1 murator, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, 1 hekurkthyes, 1 hidraulik dhe 1 bojaxhi, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

3.1. Gjithashtu, kërkesa për 1 bojaxhi është e tepërt, pasi referuar preventivit të punimeve, nuk ka asnjë zë për të cilën të kërkohet si staf i nevojshëm edhe punonjësi bojaxhi.

4. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon 2 fadroma me goma, 1 ekskavator me zinxhirë dhe 1 miniekavator, është e tepërt. Janë kërkuar shumë mjete gjurmimi, ndërkohë për volume të ngjashme apo më të larta se kaq, në procedura tjera janë kërkuar më pak mjete gjurmimi.

5. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohet të paraqitet

dokumentacion i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Procesi për vlerësimin e ofertave: -Hapja dhe vlerësimi i ofertave ka filluar me datë 27.10.2022 dhe rezultoi se ka përfunduar me datë 02.12.2022, pra mbi 1 muaj.

-Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës nga KVO, është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.

Vlerësimi i ofertave: *A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:*

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2021. OE nuk ka deklaruar sipas shtojcës 8 likuidimin e tyre.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për certifikata ISO. Janë kërkuar ISO 9001:2015, ISO 45001:2018 dhe ISO 39001:2012. Për të përmbushur këtë kriter, janë paraqitur 3 certifikata ISO të lëshuara nga subjekti A. Këto certifikata nuk përmbushin kriteret, pasi nuk kanë asnjë element që përcakton se janë të lëshuara nga organe kombëtare akreditimi, ose nga organizma ndërkombëtar akreditues. A., nuk është e akredituar për lëshimin e këtyre certifikatave.

B.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, ky OE ka mos përmbushje të kriterëve tjera si më poshtë:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 1 teknik ndërtimi dhe 1 hekurkthyes. Është paraqitur dokumentacion për teknikun e ndërtimit Sh. Gj. dhe hekurkthyesin M. M.. Për të dy këta punonjës, është paraqitur si dëshmi aftësie certifikata e lëshuar nga A. Rezultoni se kjo shoqëri nuk është e akredituar për certifikimin e punonjësve.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për 2 mjetet fadroma me goma. Mjetet e paraqitura me targa AHMT38 dhe AEMT40, rezultoni se kanë certifikatën e kontrollit teknik jashtë vlefshmërie nga data 01.12.2022, ndërkohë që dokumentacioni është noterizuar për tu dorëzuar pranë AK me datë 03.12.2022.

C. Lidhur me vlerësimin e ofertës së OE 2. shpk, rezultoni si vijon:

Ky OE, ka paraqitur ofertë në vlerën 13,450,277 lekë, ose 492,023 më pak se oferta fituese. Oferta e këtij OE, rezultoni se është refuzuar me argumentin se në shtojcën nr. 8, për disa nga mjetet si ekskavator me zinxhirë, miniekskavator, frezë asfalti, rrul ngjeshës, grejder, asfalto shtruese, rrul ngjeshës, nuk kanë deklaruar numrin e shasisë së mjetit. Gjithashtu, është konsideruar si arsye s'kualifikimi fakti se disa nga mjetet janë të angazhuara pranë AK, Bashkia Dibër.

-Lidhur me këto arsye, auditusit sqarojnë se KVO ka mbajtur standard të dyfishtë, pasi në procedura tjera të vlerësuar pranë këtij AK, nuk është konsideruar arsye s'kualifikimi mungesa e numrit të shasisë së mjeteve. Vlen të theksohet se në procedurën me objekt *"Rikonstruktion Shkolla 9-vjeçare "Irfan Hajrullai", Peshkopi, Bashkia Dibër 2022"* asnjëri nga bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ka paraqitur të dhënat e shasisë së mjeteve, dhe për KVO nuk ka qenë arsye s'kualifikimi. E njëjta situatë përsëritet në 2 procedura tjera prokurimi, ku fitues është OE "A.", i cili nuk ka deklaruar në shtojcën nr. 8 në pjesën takuese për mjetet, numrat e shasisë.

-Lidhur me arsyen tjetër të s'kualifikimit, që ka të bëjë me angazhimin e mjeteve të këtij OE pranë kësaj bashkie, KVO nuk ka përcaktuar se cilat mjete janë të angazhuara, dhe në cilën kontratë, ndërkohë që paralelisht, ka kualifikuar OE "S." shpk në 2 raste, dhe OE "A." në 1 rast, edhe pse mjetet e tyre, rezultoni të angazhuara në kontrata tjera të prokuruar pranë Bashkisë Dibër.

-Sa më sipër, KVO ka mbajtur standarde të dyfishta në vlerësimin e ofertave, duke s'kualifikuar ofertën më të favorshme në këtë procedurë, atë të OE "2." shpk, duke kryer shpenzime pa ekonomikitet për buxhetin e Bashkisë Dibër në vlerën 492,023 lekë, si diferencë ndërmjet ofertës ekonomike të fituesit e cila nuk përmbush kriteret dhe asaj

të OE “2.” shpk.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **30,371 mijë lekë** pa TVSH. Shpenzim pa ekonomikitet në vlerën **492 mijë lekë**.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

15. Tenderi me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës sheshi fshatit Pollozhan -Varrezat e dëshmorëve, Bashkia Dibër 2022” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës sheshi fshatit Pollozhan -Varrezat e dëshmorëve, Bashkia Dibër 2022.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.553.datë 06.10.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.553 datë 06.10.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.554, datë 06.10.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 5,416,666- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “D.” me ofertë 5,377,932 - Lekë, me lidhje kontrate datë 20.12.2022, me afat 2 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 38,734 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 20.10.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata: Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 1,083,333 lekë.

-Financimi për këtë projekt, është në kundërshtim me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier topograf të cilët duhej të figurojnë në listëpagesa për periudhën Maj 2022 e në vazhdim. Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 39, pika 6 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqi të kualifikuar dhe jo periudhën në të cilën duhet të kërkohet ky staf, i cili nga AK është kërkuar të jetë për të paktën 5 muajt e fundit.

2.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE fuqi punëtore prej 20 punonjës për periudhën Maj 2022 e në vazhdim, është kërkesë në kundërshtim me nenin 39, pika 6 germa (ç) të VKM-së nr. 285 të cituar më sipër, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqi punëtore për zbatimin e punimeve, dhe jo shtrirjen e kësaj kërkesë në periudha të mëparshme, ku në rastin konkret kërkohet për 5 muajt e fundit.

3.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 teknik ndërtimi, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkohet me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

4.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohej të paraqitet dokumentacion i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2021. OE nuk ka deklaruar sipas shtojcës 8 likuidimin e tyre.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për Certifikatën SSH/EN/ISO 39001:2012 mbi “Sistemi i menaxhimit të trafikut rrugor”. OE ka paraqitur një certifikatë të lëshuar nga R. e cila nuk ka akreditimin nga DPA ose institucione tjera ndërkombëtare akreditues për këtë certifikatë.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **5,416 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

16. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion dhe sistemim asfaltim i rrugës së ish Ndërmarrjes Grumbullimit Lagja Gjok Doçi” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion dhe sistemim asfaltim i rrugës së ish Ndërmarrjes Grumbullimit Lagja Gjok Doçi” Bashkia Dibër 2022.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.585.datë 14.10.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.585 datë 14.10.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.600, datë 24.10.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,022,303- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “D. & A.” me ofertë 5,686,155 - Lekë, me lidhje kontrate datë 27.01.2022, me afat 42 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 336,148 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 12.12.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata: Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 1,204,464 lekë, për vitin 2023 do financohet vlera e mbetur.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE 1 inxhinier ndërtimi, 1 inxhinier topograf, 1 elektrik dhe 1 hidroteknik drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët duhej të figurojnë në listëpagesa për periudhën Shtator 2022 e në vazhdim, kërkesë është në kundërshtim me nenin 39, pika 6 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqi të kualifikuar dhe jo periudhën në të cilën duhet të kërkohet ky staf, i cili nga AK është kërkuar të jetë për të paktën 3 muajt e fundit.

-Gjithashtu, kërkesa që të 4 inxhinierët të jenë drejtues teknik, është kufizuese. Vlera dhe volumi i punimeve është i vogël për të përcaktuar një numër kaq të lartë inxhinierësh, dhe aq më pak drejtues teknik. AK duhej që në rast nevojë për disa nga inxhinierët, të ishin staf mbështetës në listëpagesa ose me kontratë për objektin e prokurimit, pa qenë nevoja të jenë drejtues teknik.

2.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE fuqi punëtore prej 25 punonjës për periudhën Shtator 2022 e në vazhdim, është kërkesë në kundërshtim me nenin 39, pika 6 germa (ç) të VKM-së nr. 285 të cituar më sipër, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqi punëtore për zbatimin e punimeve, dhe jo shtrirjen e kësaj kërkesë në periudha të mëparshme, ku në rastin konkret kërkohet për 3 muajt e fundit.

3.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 teknik ndërtimi, 1 manovratorë dhe 2 shoferë dhe 1 hidraulik, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkohet me profilin e punimeve për të cilat kërkohen dëshmitë e sigurimit teknik.

4.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 Ton, është kërkesë fikse e cila potencialisht mund të përbëjë shkak të s’kualifikim të padrejtë të OE. NjP duhej që kërkesën ta përcaktonte si në raste tjera ku kapacitete të jetë midis 2 vlerave ose mbi dhe nën një kapacitet të kërkuar.

5.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh dhe Fabrikë asfalto - betoni, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohet të paraqitet dokumentacion i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2021. OE nuk ka deklaruar sipas shtojcës 8 likuidimin e tyre.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për stafin prej 25 punonjës. Ky OE ka deklaruar se disponon 25 punonjës për zbatimin e kësaj kontrate, ndërkohë rezulton se 20 punonjës tjerë janë të deklaruar në kontratën me objekt “Sistemin asfaltim i rrugës sheshi

fshatit Pollozhan-Varrezat e dëshmorëve” kontratë e cila është lidhur me Bashkinë Dibër, dhe vlerësimi i së cilës është bërë nga e njëjta KVO. Sqarohet se sipas deklarimit, ky OE ka për muajin Nëntor 2022 staf prej 45 punonjës, ndërkohë rezultojnë se inxhinierët e deklaruar, tekniku i ndërtimit, manovratorët dhe shoferët, janë të deklaruar njëkohësisht në kontratën e mësipërme. Nga kjo rezultojnë se ky OE nuk disponon kapacitetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** për disa nga mjetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate. Sipas shtojcës nr. 8 *Formulari i vetëdeklarimit*, ky OE rezultojnë se ka deklaruar mjetin kamion me kapacitet mbi 8 Ton me targa DI4423A, Autobitumatriçen dhe Asfalto shtruesen, të cilat rezultojnë njëkohësisht të deklaruar në procedurën me objekt *“Sistemin asfaltim i rrugës sheshi fshatit Pollozhan-Varrezat e dëshmorëve”* e vlerësuar nga e njëjta KVO në AK Bashkia Dibër.

Gjithashtu, ky OE, rezultojnë se nuk ka deklaruar në shtojcën nr. 8, mjetin kamionçinë me kapacitet mbajtës mbi 3.5 Ton, dhe për mjetin Ekskavator me goma.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **5,416 mijë lekë** pa TVSH.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

17. Tenderi me objekt: “Shtrimi i trotuareve në qendrën e Njesisë Administrative Maqellare” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shtrimi i trotuareve në qendrën e Njesisë Administrative Maqellare” Bashkia Dibër 2022.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.357.datë 27.06.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.357 datë 27.06.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.385, datë 08.07.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”	6.Oferta fituese: OE “Z.” me ofertë 5,427,293- Lekë, me lidhje kontrate datë 30.11.2022, me afat 42 dite.	7.Diferenca me fondin limit: 905,094 - lekë pa tvsh
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,332,387- lekë pa tvsh	8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 22.07.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
		13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata: Financimi: Financimi për vitin 2022 përcaktohet në vlerën 1,266,666 lekë, dhe për vitin 2023 do financohet vlera e mbetur.

Mënyra e financimit është në kundërshtim me rregullat e LPP, konkretisht me pikën 2 të nenit 85 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

2.Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier topograf të cilët duhej të figurojnë në listëpagesa për periudhën Prill 2022 e në vazhdim. Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 39, pika 6 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqi të kualifikuar dhe jo periudhën në të cilën duhet të kërkohej ky staf, i cili nga AK është kërkuar të jetë për të paktën 3 muajt e fundit.

2.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE fuqi punëtore prej 22 punonjës për periudhën Prill 2022 e në vazhdim, është kërkesë në kundërshtim me nenin 39, pika 6 germa (ç) të VKM-së nr. 285 të cituar më sipër, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqi punëtore për zbatimin e punimeve, dhe jo shtrirjen e kësaj kërkesë në periudha të mëparshme, ku në rastin konkret kërkohej për 3 muajt e fundit.

3.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 1 teknik ndërtimi, 1 inxhinier hidroteknik, 1 hidraulik, 2 manovratorë dhe 2 shoferë, të cilët duhet të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, është në kundërshtim me ligjin mbi të cilin lëshohen dëshmitë e sigurimit teknik, konkretisht ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001, ndryshuar me ligjin nr. 13/2013 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve elektrike, impianteve dhe instalimeve elektrike”, pasi proceset e punës që kryejnë stafi i mësipërm nuk përkojnë me profilin e punimeve për të cilat kërkohej dëshmitë e sigurimit teknik.

4.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE Nyje Inertesh, për të cilat duhet të disponojnë **Leje Mjedisore**, sqarohet se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi kërkesat u drejtohet OE dhe jo subjekteve tjera që nuk janë ofertues dhe si e tillë nuk mund t’u kërkohej të paraqitet dokumentacion i subjekteve që nuk janë pjesë e procedurës.

Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2021. OE nuk ka deklaruar sipas shtojcës 8 likuidimin e tyre.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** për Certifikatën SSH/EN/ISO 39001:2012 mbi “Sistemi i menaxhimit të trafikut rrugor”. OE ka paraqitur një certifikatë të lëshuar nga R. e cila nuk ka akreditimin nga DPA ose institucione tjera ndërkombëtare akreditues për këtë certifikatë.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **5,427 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP, KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

18. Tenderi me objekt: “Blerje dru zjarri për nevoja të institucioneve arsimore, Bashkia Dibër 2022-2023” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri për nevoja të institucioneve arsimore, Bashkia Dibër 2022-2023”.

1.Urdhër Prokurimi : Nr.248.datë 17.05.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.248 datë 17.05.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. Z. – (Sp.Fushe)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.281, datë 25.05.2022 1.R. D. – (Kryetar) 2. A. C. - (Anëtar) 3. M. Sh. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur/Marrëveshje kuadër”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 11,661,000 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “S. V.” me ofertë 11,631,100 - Lekë, me lidhje kontrate datë 20.06.2022, me afat 12 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 29,900 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 13.06.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata:

Procesi për vlerësimin e ofertave: -Hapja dhe vlerësimi i ofertave ka filluar me datë 13.06.2022 dhe rezulton se ka përfunduar me datë 04.07.2022, pra mbi 3 javë.

-Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës nga KVO, është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Vlerësimi i ofertave: *A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:*

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për deklarimin e likuidimit të detyrimeve vendore në çdo vend ku ushtron aktivitetin. Në formularin Nr. 8 *Formulari i vetëdeklarimit*, mungon deklarimi nga OE.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 shoferë kamioni. OE në shtojcën nr. 8 *Formulari i vetëdeklarimit*, ka deklaruar se disponon 2 shofere, por mungojnë të dhënat e këtyre 2 shoferëve.

B.Gjithashtu, nga kontrolli i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, OE ka mangësi tjera si vijon:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 1/e të Kriterëve të Përgjithshme. OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 375 prot., datë 02.06.2022 sipas të cilit ky OE likuiduar detyrimet deri me këtë datë, pa përfshirë faturën e muajit Maj 2022. Ky Dokument është administruar në protokollin e Bashkisë Dibër me datë 06.07.2022, dhe ky OE, ka detyrimet të likuidonte detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, që në rastin konkret rezultojnë të jenë ato të muajit Maj 2022, të cilat nuk janë likuiduar.

2.Nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për 2 shoferët e kamionit. Mungon dokumentacioni i kërkuar për 2 shoferët si kontrata, leja e drejtimit.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **11,631 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor për vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

19. Tenderi me objekt: “Blerje karburant (naftë) për nevojat e Bashkisë Dibër viti 2022” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje karburant (naftë) për nevojat e Bashkisë Dibër viti 2022”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.111.datë 24.02.2022.	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.111 datë 24.02.2022. 1. I. S. – (P/Prokurimi) 2. O. Ç. - (Anetar) 3. F. T. – (Anetar)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.115, datë 01.03.2022 1.R. K. – (Kryetar) 2. E. Sh. - (Anëtar) 3. Q. S. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur/Marrëveshje kuadër”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 12,715,000- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “K.” me ofertë 12,715,000- Lekë, me lidhje kontrate datë 13.04.2022, me afat 12 muaj .	7.Diferenca me fondin limit: 0 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 17.03.2022.	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë.	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik në zhvillimin e procedurës.

Situata: Vlerësimi i ofertave: A.Nga shqyrtimi i ofertës fituese, dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, OE nuk ka përmbushur të gjitha kriteret, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2021. OE nuk ka deklaruar sipas shtojcës 8 likuidimin e tyre.

-Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur pranë AK, ka rezultuar se ky OE, ka sjellë disa vërtetime për likuidim detyrimesh vendore për vitin 2021, por rezulton se ky OE ka adresa sekondare në thuajse gjitha njësitë vendore të Shqipërisë, ndërkohë që nuk ka paraqitur vërtetimet për likuidim detyrimesh si Bashkia Mat, Fushë Arrëz, Gramsh, Peqin, Pogradec, Tropojë, Has, Kolonjë, Rrogozhinë, Maliq, Himarë, etj.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën **12,715 mijë lekë** pa TVSH.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor për vlerësimin e ofertave duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO dhe Titullarin e AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

-Për periudhën objekt auditimi, nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bashkia Dibër janë miratuar 30 leje ndërtimi, nga të cilat 3 leje ndërtimi janë për objekte mbi 250 m², 18 leje janë për objekte nën 250 m², dhe lejet tjera janë leje rikonstruksioni pa ndryshim funksioni. TNI e mbledhur për lejet e mësipërme është në vlerën 3,777 mijë lekë¹⁹.

¹⁹Pasqyra me lejet e ndërtimit paraqitet e detajuar në tabelën nr. 1, të aneksit nr. 5.

Titulli i gjetjes: Miratim i lejeve të ndërtimit në mos respektim të legjislacionit sektorial. Përlllogaritje të gabuara të TNI, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Dibër.

Situata 1: Sipas regjistrimit elektronik nr. 1061/1 në emër të zhvilluesit A. A., me datë aplikimi 05.04.2022, për objektin: “*Shtesë 1 Kat shërbim & 4 kat banim mbi objekt ekzistues*”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1. Nuk është respektuar distanca me 2 objektet, konkretisht objektin 3 katesh në Veri Perëndim ku përcaktohet 6.4 metër, ndërkohë duhet të jetë 10 metër, dhe me objektin 3 katesh në Jug ku distanca është 6.12 metër, ndërkohë duhet të jetë 10 metër. Mangësitë që lidhen me distancat, janë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.

2. Leja e zhvillimit me nr. 4318, datë 26.01.2022 është lëshuar për shtetasin A. A., ndërkohë sipas certifikatës së pronësisë rezultojnë 2 bashkëpronarë.

-Mungon deklarata e dakordsisë ose marrëveshje midis pronarëve për zhvillimin e zj. M. F. A., veprim në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (b) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, e ndryshuar.

3. Lidhur me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë rezulton se ajo është përlllogaritur gabim nga punonjësit e urbanistikës.

-Sipas përlllogaritjes së bërë, subjekti ka likuiduar vlerën 1,510,836 lekë. Sipas objektit të lejes, ajo është *Shtesë 1 Kat shërbim & 4 kat banim mbi objekt ekzistues*. Sipas projektit dhe objektit të lejes, rezulton se janë katër kate banim me nga 5 hyrje për kate = 20 hyrje total + kati i parë për ambiente me destinacion biznesi.

Ligji mbi të cilin do bëhet përlllogaritja do jetë ligji nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 7 pika 1 e të cilit përcakton se: *Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri*. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Neni 9, pika 2 e ligjit 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore” përcaktohet se:

Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4% deri 8% të të çmimit të shitjes për metër katror.

-VKM nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 të Këshillit të Ministrave, “për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” sipas aneksit nr. 1 të këtij vendimi, çmimi referues për Bashkinë Dibër është 49,000 lekë. Në aneksin nr. 2 të këtij vendimi, në germën **a** përcaktohet se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve, dhe germa b përcakton se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

Sipas objektit të lejes, projektit dhe relacionit arkitektonik, kati i parë është përcaktuar për shërbime dhe tregti, dhe 4 katet tjera për banim.

Sipas paketës fiskale për vitin 2022, baza e taksës për objektet e reja për njësi tregtimi dhe shërbimi është 6%.

Përlllogaritja rezulton si më poshtë:

1. Kati në kuotën 0.0 sipërfaqe reale $372 \text{ m}^2 \times 49,000 \times 6\% \times 1.5 = 1,640,520$ lekë;

3.Kati nga I deri në IV, sipërfaqe reale $459 \times 4 \text{ kate} = 1836 \text{ m}^2 \times 49,000 \times 6\% = 5,397,840$ lekë;

Sa më sipër, vlera e përlogaritur nga TNI për ndërtimit e ri, është 7,038,360 lekë dhe jo 1,510,836 lekë sa është përlogaritur nga punonjësit e urbanistikës. Diferenca prej 5,527,524 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, përbën të ardhur të paarkëtuar për Bashkinë Dibër.

Situata 2 : Sipas regjistrimit elektronik nr. 297 në emër të zhvilluesit L. S., me datë aplikimi 22.02.2022, për objektin: “Ndërtim çatie të re mbi objektin ekzistues”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1.Projekti arkitektonik nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e nevojshme, pasi mungojnë prerjet dhe detaje teknike, në kundërshtim me nenin 14 pika 1 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar.

2.Lidhur me objektin e lejes, ajo rezulton të jetë shtesë kati dhe jo ndërtim çatie. Sipas projektit arkitektonik, rezulton kemi një ambient të shfrytëzueshëm. Jemi në kushtet e përcaktuara në nenin 37, pika 3 germa (d), të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, e cila përcakton se:

Në ndërtimet me çati, hapësira nën çati vlerësohet si kat kur, pjerrësia e saj lejon shfrytëzimin e të paktën 50% të sipërfaqes së përgjithshme të banimit të katit që mbulohet.....

Sa më sipër, dhe sipas projektit të paraqitur nga aplikuesi, duhet të ishte konsideruar shtesë kati në lartësi, dhe jo ndërtim çatie.

3. Lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, ajo është përlogaritur gabim nga personat përgjegjës. Konkretisht, sipas faturës për arkëtim me nr. 000211 datë 11.03.2022, është përcaktuar totali i detyrimit në vlerën 28,020 lekë, nga të cilat 24,020 lekë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimit e reja dhe 4,000 lekë tarifë aplikimi për leje zhvillimi... Përlogaritja rezulton se është bërë bazuar në sipërfaqen e objektit $150 \text{ m}^2 \times 32,830 \text{ lekë}$ çmimi sipas kostonë së ndërtimit nga EKB për $\text{m}^2 \times 2\%$ taksa sipas paketës fiskale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se subjekti aplikues ka paraqitur preventivin e punimeve në vlerën 1,201,012 lekë. Referuar preventivit, dhe në zbatim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, i cili përcakton se:

1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

Rezulton se përlogaritja është bërë gabim nga punonjësit e urbanistikës, pasi nuk është zbatuar neni 46 i ligjit 107/2014 i cituar më sipër, pasi nuk është përzgjedhur vlera më e lartë për kryerjen e përlogaritjes. Nga përlogaritja e grupit të auditimit, vlera duhet të jetë si më poshtë:

$-150 \text{ m}^2 \times 32,830 \text{ lekë}$ çmimi kosto sipas EKB $\times 2\%$ TNI sipas paketës fiskale = 4,924,500 lekë $\times 2\% = 98,490 \text{ lekë}$.

Sa më sipër, vlera e përlogaritur nga TNI për ndërtimit e ri, është 98,490 lekë dhe jo 24,020 lekë sa është përlogaritur nga punonjësit e urbanistikës (pa përfshirë tarifën për leje zhvillimi). Diferenca prej 74,470 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, përbën të ardhur të paarkëtuar për Bashkinë Dibër.

Situata 3: Sipas regjistrimit elektronik nr. 274 në emër të zhvilluesit I. S., me datë aplikimi 28.01.2022, për objektin: “Vila Turistike I Kat, Fushë Lurë, Bashkia Dibër”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1. Raporti i VNM – së nuk është nënshkruar elektronikisht nga Eksperti A. C., si dhe mungon deklarata, Vendimi i miratimit, QKB, Licenca, si dhe mungon miratimi i tij nga

Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

2. Nuk është dërguar për mendim në institucionet përgjegjëse të cilat japin mendimet e tyre lidhur me aplikim për leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 10/1 pika 6 të VKM-së 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar.

3. Nuk është bërë ndryshimi i statusit të tokës nga Arë në Truall;

4. Lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, ajo është përlllogaritur gabim nga personat përgjegjës. Konkretisht, sipas faturës për arkëtim me nr. 000205 datë 15.02.2022, është përcaktuar totali i detyrimit në vlerën 181,461 lekë, nga të cilat 176,461 lekë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimit e reja dhe 5,000 lekë tarifë aplikimi për leje zhvillimi... Përlllogaritja rezulton se është bërë bazuar në sipërfaqen e objektit $215 \text{ m}^2 \times 32,830 \text{ lekë çmimi sipas kostos së ndërtimit nga EKB për } \text{m}^2 \times 2.5\% \text{ taksa sipas paketës fiskale}$. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se subjekti aplikues ka paraqitur preventivin e punimeve në vlerën 10,189,512 lekë. Referuar preventivit, dhe në zbatim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, i cili përcakton se:

1. *Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.*

Rezulton se përlllogaritja është bërë gabim nga punonjësit e urbanistikës, pasi nuk është zbatuar neni 46 i ligjit 107/2014 i cituar më sipër, pasi nuk është përzgjedhur vlera më e lartë për kryerjen e përlllogaritjes. Nga përlllogaritja e grupit të auditimit, vlera duhet të jetë si më poshtë:

10,189,512 lekë preventivi i punimeve $\times 2.5\%$ TNI sipas paketës fiskale = 254,737.8 lekë.

Sa më sipër, vlera e përlllogaritur nga TNI për ndërtimit e ri, është 254,737.8 lekë dhe jo 176,461 lekë sa është përlllogaritur nga punonjësit e urbanistikës (pa përfshirë tarifën për leje zhvillimi). Diferenca prej 78,276.8 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, përbën të ardhur të paarkëtuar për Bashkinë Dibër.

Situata 4: Sipas regjistrit elektronik nr. 1402/1 në emër të zhvilluesit R. D., me datë aplikimi 01.05.2022, për objektin: “*Godinë banimi 2 kat + 1 kat bodrum*”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1. Mungon plani i rievimit topografik Sh 1: 500, licenca e topografit dhe deklarata, në kundërshtim me pikën 1 germa (ç) të nenit 10, dhe pikën 1 germa (e, ë) të nenit 15 të VKM-së 408 datë 13.05.2015, i ndryshuar;

2. Mungon harta treguese dhe certifikata për vërtetim pronësie, në kundërshtim me pikën 1 germa (b) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar;

Situata 5: Sipas regjistrit elektronik nr. 1950 në emër të zhvilluesit Sh. E., me datë aplikimi 04.06.2022, për objektin: “*Kapanon për magazinimin e materialeve*”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1. Projekti arkitektonik është i pa plotë. Mungojnë detajet teknike, nuk janë paraqitur fasadat e objektit, në kundërshtim me nenin 14 pika 1 dhe nenin 15 pika 1/1 germa (i) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 i ndryshuar;

2. Mungon projekti për MNZ. Në dosjen përkatës është ngarkuar projekti konstruktiv, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 germa (iv) të VKM-së 408 cituar më sipër;

3. Mungon Raporti për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe vendimi përkatës nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

Situata 6: Sipas regjistrit elektronik nr. 4752 në emër të zhvilluesit M. S., me datë aplikimi 10.10.2022, për objektin: “*Ndërtimi i 4 bujtinave dhe 1 lokal*”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1.Nga verifikimi i dokumentacionit të pronësisë, rezulton se prona mbi të cilën kërkohet të zhvillohen projekti i 4 bujtinave dhe lokali, është në pronësi të shtetasit D. S.. Ndërmjet palëve, qiradhënës – qiramarrës, është lidhur kontrata me nr. 223 Rep., 82 Kol, datë 18.01.2022, sipas së cilës lidhet kontratë me afat 15 vjet. Sipas pikës 3 të kontratës, përcaktohet se qiramarrësi detyrohet që të mirëmbajë dhe të kujdeset për arën e marrë me qira dhe ta dorëzojë në atë gjendje në fund të periudhës së qiramarrjes.

-Sipas kontratës dhe përshkrimit të objektit të saj, nuk përcaktohet e drejta që ka qiramarrësi për ndërtimin e objekteve, por përcaktohet detyrimi për mirëmbajtjen e arës.

-Sipas certifikatës së pronësisë, gjithashtu përcaktohet statusi i tokës Arë, dhe jo truall. Sipas përcaktimit të pikës 4 të nenit 14 të ligjit 9244, datë 16.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, përcaktohet se *Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.*

Referuar preventivit të punimeve, rezulton se materialet që do përdoren janë në kundërshtim me ligjin e mësipërm, pasi kemi gërmim dheu, plinte, kolona b/a, breza betoni etj, pra kemi të bëjmë me materiale që nuk lejohen.

2.Lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, ajo është përlllogaritur gabim nga personat përgjegjës. Konkretisht, sipas faturës për arkëtim me nr. 000253 datë 22.11.2022, është përcaktuar totali i detyrimit në vlerën 147,154 lekë, nga të cilat 142,154 lekë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe 5,000 lekë tarifë aplikimi për leje zhvillimi... Përlllogaritja rezulton se është bërë bazuar në sipërfaqen e objektit 173.2 m² x 32,830 lekë çmimi sipas kostos së ndërtimit nga EKB për m² x 2.5% taksa sipas paketës fiskale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se subjekti aplikues ka paraqitur preventivin e punimeve në vlerën 10,189,512 lekë. Referuar preventivit, dhe në zbatim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, i cili përcakton se:

1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

Rezulton se përlllogaritja është bërë gabim nga punonjësit e urbanistikës, pasi nuk është zbatuar neni 46 i ligjit 107/2014 i cituar më sipër, pasi nuk është përzgjedhur vlera më e lartë për kryerjen e përlllogaritjes. Nga përlllogaritja e grupit të auditimit, vlera duhet të jetë si më poshtë:

7,199,585 lekë preventivi i punimeve x 2.5% TNI sipas paketës fiskale = 179,989 lekë.

Sa më sipër, vlera e përlllogaritur nga TNI për ndërtimet e ri, është 179,989 lekë dhe jo 147,154 lekë sa është përlllogaritur nga punonjësit e urbanistikës (pa përfshirë tarifën për leje zhvillimi). Diferenca prej 32,835 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, përbën të ardhur të paarkëtuar për Bashkinë Dibër.

Situata 7: Sipas regjistrimit elektronik nr. 429 në emër të zhvilluesit S. K., me datë aplikimi 10.10.2022, për objektin: “Magazinë grumbullimi bimë medicinale 1 kat + 1 kad bodrum”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1.Mungojnë projektet e instalimeve hidro sanitare, elektrike dhe të ngrohje ftohjes, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 germa (iii) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar;

2.Mungon projekti për mbrojtjen nga zjarri, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 germa (iv) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar. Është paraqitur relacion i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit, por mungon projekti;

3.Mungon vendimi për vlerësimin në mjedis i lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit,

por është paraqitur vetëm raporti i vlerësimit.

4.Mungon mendimi i institucioneve që përfshihen në procesin e miratimit të lejeve të ndërtimit, si OSHEE, ASHK, Ujësjellës Kanalizime etj, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 10/1 të VKM-së 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar;

Situata 8: Sipas regjistrit elektronik nr. 1862 në emër të zhvilluesit V. M., me datë aplikimi 30.05.2022, për objektin: *“Shtesë 1 kat në lartësi dhe shtesë anësore, shkallë mbi strukturën ekzistuese 1 kat”*.

1.Lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, ajo është përlllogaritur gabim nga personat përgjegjës. Konkretisht, sipas faturës për arkëtim me nr. 000229 datë 13.06.2022, është përcaktuar totali i detyrimit në vlerën 85,592 lekë, nga të cilat 81,592 lekë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimit e reja dhe 4,000 lekë tarifë aplikimi për leje zhvillimi... Përlllogaritja rezulton se është bërë bazuar në preventivin e punimeve x 2% taksa sipas paketës fiskale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se përlllogaritja është bërë në kundërshtim me nenin 46 pika 1 të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, i cili përcakton se:

1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohej të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

Rezulton se përlllogaritja është bërë gabim nga punonjësit e urbanistikës, pasi nuk është zbatuar neni 46 i ligjit 107/2014 i cituar më sipër, pasi nuk është përzgjedhur vlera më e lartë për kryerjen e përlllogaritjes. Nga përlllogaritja e grupit të auditimit, vlera duhet të jetë si më poshtë:

158.2 m² ndërtimi i ri shtesë x 32,830 lekë çmimi kosto sipas EKB x 2% TNI sipas paketës fiskale = 103,874 lekë.

Sa më sipër, vlera e përlllogaritur nga TNI për ndërtimit e ri, është 103,874 lekë dhe jo 81,592 lekë sa është përlllogaritur nga punonjësit e urbanistikës (pa përfshirë tarifën për leje zhvillimi). Diferenca prej 22,282 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, përbën të ardhur të paarkëtuar për Bashkinë Dibër.

Kriteri: Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar Neni 46 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar Neni 10 pika 1 germa (ç) “Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi”, Neni 10/1 pika 6 “Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi”, Neni 14 pika 1 “Kushtet për lëshimin e lejes së zhvillimit”, Neni 15 pika 1 germa (b, e), pika 1/1 germa (i, iii, iv) “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi”, Neni 34 pika 2 “Distancat minimale midis ndërtimeve”, Neni 37, pika 3 “Lartësia e ndërtimeve”, Ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, Neni 9 pika 2, VKM 162, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” Aneksi 1, Aneksi 2 germa (a, b), Ligji nr. 9244, datë 16.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës”, Neni 14, pika 4.

Ndikimi/Efekti: Miratimi i këtyre lejeve në kundërshtim me ligjin Nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë Dibër nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, për aplikantë

të cilët kanë mangësi në dokumentacion, gjë që e bën aplikimin jo të plotë dhe miratimin e lejeve të mësipërme në kundërshtim me ligjin.

Shkaku: Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim 1: Nga Bashkia Dibër, të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.

Rekomandim 2: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Taksave, të marrin masa për nxjerrjen e njoftim detyrimit ndaj subjekteve zhvillues A. A., L. S., I. S., M. S. dhe V. M., për të bërë të mundur arkëtimin e shumës **5,735,388 lekë** si rezultat i përlllogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga të cilat për shtetasin A. A. vlera **5,527,524 lekë**, për shtetasen L. S. vlera **74,470 lekë**, për shtetasin I. S. vlera **78,277 lekë**, për shtetasen M. S. vlera **32,835 lekë**, për shtetasin V. M. vlera **22,282 lekë**, shuma të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Dibër.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi, z. R. S. – Kryetar i Bashkisë Dibër, z. E. M. - Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, z. E. Sh. – Kontrollues, me pozicion Përgjegjës Sektori në DPKT, z. D. V. – Nëpunës, Specialist në DPKT, dhe M. M., ish punonjës pranë DPKT.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Drejtori i Urbanistikës z. E. M., është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 872/4 prot., datë 19.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Lidhur me lejen në emër të zhvilluesit A. A., sqarohet si më poshtë:

1. Në lidhje me këtë pikë nuk jemi dakord me argumentin për arsye që vijon:

Sipas pikës 3 të nenit 34 të VKM-se nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.

“Në rast se ndërtimi përballet me një objekt ekzistues, të ndërtuar në kundërshtim me kondicionet urbane të legjislacionit përkatës, atëherë ndërtimi i ri përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat sipas pikës 2, të këtij neni, dhe mbart detyrimin e respektimit të distancës nga kufiri i pronës, sipas nenit 35. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, nuk do të merren në konsideratë objektet ekzistuese të ndërtuara përpara viteve 1990, nga të cilat do të respektohen distancat minimale të përcaktuara në pikën 2.

Objekti në veri përëndim është objekt i ndërtuar pas viteve 1990, ndërsa objekti në jug është objekt në pronësi të zhvilluesit.

2.Lidhur me pikën 3 nuk jemi dakord me argumentin për arsye që vijon:

Referuar ligjit nr.95/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 9 pika 2 referon:

2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga **shoqëri ndërtimi**, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Referuar kësaj dispozite investimi në fjalë nuk kryhet nga shoqëri ndërtimi por nga një individ i caktuar i cili ka kërkuar në lejen e zhvillimit që objekti do shërbeje për përdorim vetjak. Aplikanti ka gjithashtu ne parcelat kufitar me parcelën e zhvilluar objekte me sipërfaqe të përafërta të cilat i ka për përdorim vetjak e cila tregon që objektet që i zhvillon nuk i ka për shitje.

Bashkia Dibër e ka në monitorim zhvillimin e objektit deri në dhënien e certifikatës së përdorimit, nëse konstatohet që zhvilluesi devijon nga qëllimi i lejes së dhënë, nuk do të jepet certifikata e

përdorimit deri në derdhjen e diferencës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Lidhur me lejet në emër të zhvilluesve L. S., Sh. E. dhe S. K. rezulton se observacionet janë të njëjta me ato të paraqitura dhe të trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Lidhur me observacionet e paraqitura, ato rezultojnë të njëjta me ato të paraqitura dhe trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit. Kundërshtitë tuaja nuk janë të mbështetura në kritere ligjore dhe sa më sipër qëndrimi i audituesve është i njëjtë me atë të paraqitur në Projekt Raportin e Auditimit.

2.6. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).

Titulli i Gjetjes: IMTV funksionon me staf të pakualifikuar. Aktiviteti jo në përputhje me detyrimet që përcakton ligji për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme dhe ai për planifikimin e territorit.

Situata: 1.Për periudhën objekt auditim 01.01.2022 deri 23.12.2022, IMTV është drejtuar nga K/inspektor L. T., i cili rezulton me arsim për financë - bankë, dhe nga data 23.12.2022 e në vijim është drejtuar nga K. I. i arsimuar me juridik.

Inspektorët që kanë punuar dhe punojnë gjatë kësaj periudhe janë Sh. I. me arsim juridik, M. M. me arsim juridik, A. P. me arsim financë - bankë, F. R. inxhinieri agrare dhe A. C. – administrim biznes.

Për sa më sipër, konstatohet se IMTV Bashkia Dibër, përgjatë periudhës objekt auditimi, ka rekrutuar një pjesë të stafit në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i cili përcakton se:

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

Ish - kryeinspektori dhe disa nga inspektorët e cituar më sipër, nuk kanë arsimimin e duhur për të ushtruar detyrën e K/inspektorit dhe atë të inspektorit. Mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij inxhinierik përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli apo për të përcaktuar dhe përshkruar teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit.

-Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë mbajtur 17 akte konstatimi për punime pa leje²⁰.

2.Lidhur me procedurat e mësipërme, konstatohet mangësi në veprimtarinë e IMTV, pasi masa e gjobës për 17 subjektet e mësipërme, është aplikuar gabim, pasi me ligjin nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e), është ndryshuar si më poshtë:

e)kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me....

Në këto kushte masa e gjobës e caktuar me vlera nga 50,000 deri në 200,000 lekë është masë e cila nuk mbështetet në ligj, pasi me ndryshimet e cituara më sipër, masa e gjobës përlllogaritet sipas vlerës së punimeve të kryera pa leje, dhe në çdo rast kur kemi të bëjmë me ndërtim për qëllime fitimi, masa e gjobës është jo më pa se 35,000 lekë për metër katror.

-Lidhur me këto mangësi, audituesit kanë sqaruar në hyrje të këtij akt konstatimi, se do duhej

²⁰Pasqyra me Akt Konstatimet dhe masat e marra nga IMTV, paraqitet në tabelën nr. 1 të aneksit nr. 6.

që në stafin e IMTV-së të kishte staf të kualifikuar, sidomos me profil inxhinierik, pasi me ndryshimet e ligjit nuk kemi më minimum gjore në vlerë të përcaktuar, por kërkohet ekspertizë dhe staf i kualifikuar për të nxjerrë përlogaritjet dhe nxjerr masën e gjobës në përputhje me dispozitat ligjore.

3.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori/ët kanë nxjerrë vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, por rezulton se nuk ka marrë apo pasqyruar asnjë masë apo procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve.

4.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori/ët nuk kanë miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”. Njëkohësisht sqarohet se në mungesë të stafit të kualifikuar, ky kontroll do ishte i pamundur pasi punonjësit nuk kanë kualifikimin sipas ligjit për të kryer akte kontrolli në objektet që kanë leje ndërtimi.

5.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

6.Lidhur me konstatimet e mësipërme, në asnjë rast nuk disponohet një dosje e hapur për subjektin kundërvajtës, por procesverbalet e mbajtura dhe aktet që ka nxjerrë inspektorati, ishin vetëm nëpër blloqe, duke mos pasur një praktikë estetike të administrimit të dokumentacionit.

7.Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se shumë procedura nuk dispononin fotot e konstatimit, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e kundërvajtjes së kryer, dhe në rastet kur ato disponoheshin, nuk ishin të firmosura nga inspektorët përkatës. Mungesa e fotografive të kundërvajtjes, është veprim në kundërshtim me nenin 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton se:

Inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta

a)të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit.

8.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori, për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar planet mujore të punës, veprim ky në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

9.Lidhur me gjobat e vendosura nga IMT, rezulton se asnjëra prej tyre nuk është përcjellë pranë Drejtorisë Juridike për të kërkuar pranë gjykatës kthimin e tyre në titull ekzekutiv, pra ndjekjen e procedurave ligjore për vjeljen e gjobës.

Lidhur me vijimin e procedurës për arkëtimin e tyre, nuk ka asnjë veprim nga zyrat e mësipërme, ndërkohë nuk rezulton të jetë bërë asnjë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv.

Kriteri: Ligji 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa (a, b, f) neni 11, 12; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”; VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 41 germa (a) “Të drejta të tjera të inspektorit”.

Ndikimi: Ndikon në ndërtimet e reja në mos përputhje të planit rregullues. Shmangen

detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Nuk jep garanci për një kontroll efektiv dhe cilësor të territorit.

Shkaku: Personeli i pakualifikuar dhe jo në përputhje me detyrimet që përcakton ligji.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, kjo jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Të synohet që stafi i kualifikuar të jetë me drejtim inxhinierie.

- IMT Bashkia Dibër, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

- IMT Bashkia Dibër, të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave në përputhje me natyrën e shkeljes. Të merren masa për ekzekutimin e vendimeve për prishje, dhe në rast mungese të mjeteve, Kryetari i Bashkisë të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje. Të përgatiten planet mujore/vjetore të punës nga K/inspektori.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. L. T. – Ish - Kryeinspektor i IMTV
2. F. R. – Inspektor
3. Sh. I. – Inspektor
4. M. M. – Inspektor
5. A. P. – Inspektor
6. A. C. – Inspektor

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Dibër nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nuk është miratuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike, si prokurimet publike, shpenzimet, të ardhurat etj.

Nga titullari nuk është nxjerrë akt i brendshëm ku të përcaktohen detyrat e punonjësit dhe strukturave përkatëse të Bashkisë Dibër gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës.

Nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, duke mos marrë masa për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me:

- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 13;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi “Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25 “Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit”;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 8, pika 2, 8b, neni 9 pika ç dhe neni 16 pika 2 dhe 3;
- VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” Kreu III, pika 27 deri në 30;
- VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, Kreu VII, pika 49, 52, 52;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”;
- Ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 datë 29.3.2012 “Procedura e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm”, Kap. V. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e regjistrit të rriskut të secilës strukturë dhe të të gjithë institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit.

Nga Titullari i njësisë vendore të hartohen rregulla të shkruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përkatëse të kësaj njësie gjatë marrjen dhe dorëzimin e detyrës nga punonjësit.

Deri në 30.06.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i organizimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm(NJAB) rezultoi se:

- Prej muajit shkurt të vitit 2022 struktura është plotësuar me 3 (tre) anëtarë, të cilët përgjatë vitit 2022 kanë qenë të pa certifikuar, në kundërshtim me pikën 3 VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
- Një prej anëtarëve të NJAB-së (E. D.) është rekrutuar në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të posaçme, për të qenë anëtar i NJAB-së, pasi nuk zotëron diplomë universitare të nivelit të dytë, në kundërshtim me pikën 2 a të nenit 11 të ligjit

nr.114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, si dhe nuk ka pasur eksperiencën e nevojshme prej 3 vite, por vetëm 1 vit, në kundërshtim me pikën 2/ç, të nenit 11, të Ligjit nr.114/2015.

- Drejtuesi i NJAB-së, nuk ka pasur pesë vite përvojë pune në momentin e emërimit si Drejtues i NJAB-së dhe nuk është certifikuar përgjatë vitit 2022, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2b, të nenit 11, të Ligjit nr. 114/2015.
- Dy nga tre punonjësit e NJAB-së, për vitin 2022 kanë kryer trajnimet e vijueshme për 40 orë/vit, ndërsa një anëtar i NJAB-së, znj. E. D. nuk ka realizuar asnjë orë trajnimi, në kundërshtim me nenin 5 të “Rregullores së trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, të miratuar me Urdhrin nr. 3, datë 08.01.2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2, faqe 25-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që struktura e njësisë së auditit të brendshëm të plotësohet me punonjës, të cilët përmbushin të gjitha kriteret e posaçme për punësimin si auditues i brendshëm.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procesit të planifikimit vjetor dhe strategjik të veprimtarisë së auditit të brendshëm u konstatuan disa mangësi si më poshtë:

- NJAB përpara procesit të planifikimit nuk ka plotësuar pyetësorët standard që kërkohen sipas Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, i ndryshuar. Konkretisht nuk është plotësuar “Pyetësori formati standard 1”, “Pyetësori vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm”, Pyetësori formati standard 2”, “Pyetësori për planin strategjik – Të kuptosh procedurat e Auditimit të Brendshëm”, si dhe “Pyetësori formati standard nr. 3” “Identifikimi i sistemeve të njësive”.

Subjektet e planit strategjik, të përzgjedhura për t’u përfshirë në planin vjetor nuk kanë qenë ato të vlerësuara me risk të lartë, por fokusi është vendosur të subjektet me risk të mesëm dhe të ulët, si Klubi shumësportësh Peshkopi vlerësuar me “Risk të mesëm”; Klubi futbollit “Korabi” vlerësuar me “Risk të mesëm” dhe Njësitë Administrative Kala e Dodës, Luzni, Lurë të vlerësuara me “Risk të ulët”, në kundërshtim me pikën “Identifikimi subjekteve”, të kapitullit “Formati Standard 5: Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJA”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me UMFE nr. 4, datë 10.01.2020. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2, faqe 27-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtuesi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për të realizuar një proces planifikimi të plotë siç parashikohet në Manualin e Auditit të Brendshëm, duke e dokumentuar këtë proces nëpërmjet plotësimit të të gjithë formularëve standard të kërkuar prej tij dhe në përzgjedhjen e subjekteve për auditim t’i kushtohet rëndësi e shtuar subjekteve të vlerësuara me “risk të lartë” të auditimit.

Deri më datë 20 Tetor 2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dosjeve të auditimit u konstatua se dosjet janë të paplota dhe nuk përmbajnë dokumentet e kërkuara në Kapitullin VI të Manualit të Auditimit të Brendshëm”, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, të ndryshuar. Në të gjitha dosjet e auditimit, mungojnë dokumentet standarde si më poshtë:

- Dokumenti Standard “Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit”
- Dokumenti Standard “Vlerësimi i risqeve për sisteme/fusha të veçanta të llogarisë”
- Dokumenti Standard “Vlerësimi i përgjithshëm i riskut”
- Dokumenti Standard “Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit”
- Dokumenti Standard “Plani i veprimit i sugjeruar”
- Dokumenti Standard “Kundërshtitë (observacionet)”

-Dokumenti Standard “*Reagimet (feedback) e auditimit*”

-Dokumenti Standard “*Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar*”.

-Dokumentit Standard “*Autorizimi*” në 4 dosje auditimi i mungon data, konkretisht në subjektet: Njësia Administrative Kala e Dodës, Njësia Administrative Luzni, Klubi Shumësportësh Peshkopi dhe Klubi i Futbollit “Korabi”;

-Dokumenti standard “*Programi i angazhimit të auditimit*” mungon në subjektin: Njësia Administrative Luzni dhe në të gjitha rastet e tjera kur ka qenë pjesë e dosje nuk ka pasur të shënuar datën.

Dosjet e auditimit gjithashtu kanë mangësi në evidencat mbështetëse të rezultateve të auditimit, në evidencat e vlerësimit të risqeve për subjektet.

Nga dosjet e auditimit, rezultoi se:

-2 misione auditimi janë realizuar në të njëjtën periudhë kohore, konkretisht Njësitet Administrative Kala e Dodës dhe Luzni;

4 muajt e parë të vitit rezultojnë pa asnjë veprimtari audituese.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2, faqe 31-33 të Raportit (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2, faqe 25-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtuesi i Njesisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa, që në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të NJAB-së të realizojnë dokumentimin e punës audituese dhe të bëjë një shpërndarje të punës audituese, që të shmangen mbivendosjet e auditimeve në terren në të njëjtën kohë.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: 1. Për hartimin e PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Dibër nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”, kreu I, pika 13;

2. Kryetari i Bashkisë Dibër nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”, kreu I, pika 5 dhe 6;

3. Kryetari i Bashkisë Dibër nuk ka përgatitur dhe propozuar për miratim në Këshillin Bashkiak Tavanet Përgatitore të PBA 2022-2024, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”, kreu I, pika 3;

4. Kryetari i Bashkisë Dibër nuk ka dërguar brenda datës 1 Qershor 2021 me shkrim dhe në rrugë elektronike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, projekt-dokumentin e PBA 2022-2024, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”, kreu I, pika 9. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 33-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për publikimin në faqen zyrtare të saj, Projekt Buxhetet Afatmesme, të miratojë udhëzimin plotësues për përgatitjen e PBA-së, të miratojë tavanet përgatitore dhe të dërgojë projekt-dokumentin e PBA-së në MFE.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dibër për vitin 2022 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2022, ndërsa 3 raportet periodike të monitorimit nuk janë hartuar për vitin 2022. Kryetari i Bashkisë Dibër në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë nuk ka

miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit nuk janë të plota pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 35-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe drejtori i Drejtorisë Ekonomike, të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen tre raporte katër mujor për monitorimin e zbatimit të buxhetit, të cilat të dërgohen gjithashtu në MFE. Kryetari i Bashkisë të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura, rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura rezulton të jetë në vlerën 501,101,775 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 38-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 501,102 mijë lekë, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 në Bashkinë Dibër niveli i realizimit të të ardhurave është 71%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit. Përkatësisht:

- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 2;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 41, germa ç/1;
- Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 40-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër të angazhohet në marrjen e masave për një planifikim sa më të saktë duke bashkëpunuar me struktura të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Dibër ushtrojnë aktivitetin 10 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, asete të Bashkisë Dibër. Nga bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimit të mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Dibër. Rastet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet nxjerrje prodhim minerale dhe inertesh, që nga të dhënat e

Bashkisë Dibër, ka lidhur kontratë qiraje me nr. 5130 Rep., nr. 946/1 Kol., datë 08.06.2012 me subjektin “E.” ShPK, me objekt administrimin e një pasurie të paluajtshme, tokë me sipërfaqe 4950 m², në të cilën me Vendim të Këshillit të Komunës Fushë Cidhën nr. 19, datë 01.08.2010 ka ndërtuar një Nyje Zhavorri për Larje Inertesh dhe prodhim Asfalto-Betoni, me një afat 30 vjet, duke filluar nga data 01.03.2011. Subjekti paguan detyrimet në Bashkinë Dibër, por sipas verifikimit në AKBN nuk është i pajisur me leje minerare. Veprime këto në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6., faqe 51-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të merren masa në mënyrë të menjëhershme që të bllokohet aktiviteti ekonomik i këtyre guroreve (sipas tabelës II.6.9), deri në momentin e përfundimit të procedurave ligjore, në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve përkatëse të guroreve të sipërcituara. Gjithashtu, para momentit të zhbllokimit, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat ligjore për heqjen nga fondi pyjor, Bashkia Dibër të bëjë një vlerësim për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor, dhe t’jua faturojë subjekteve përkatëse private me aktivitet gurore.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve, u konstatua se Bashkia Dibër nuk ka arritur të certifikojë dhe regjistrojnë pronat që kanë në administrim në 15 njësitë në varësi të saj. Nga 5,950 asete në përdorim, rezulton se për 4,015 asete nuk është kryer asnjë veprim ose 67% e tyre nuk ka ndjekur procedurat për ti regjistruar në ASHK-Dibër, në kundërshtim me pikën të nenit 4, pikën 2 të nenit 5 dhe pikës 1 të nenit 43 të ligjit nr. 20/20 “Për Kadastrën” *tarifa shërbimi të reduktuara në regjistrimin e aseteve të pushtetit vendor*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 54-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore dhe të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për të regjistruar dhe pajisur me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dibër ka në përdorim të saj 2870 hektar sipërfaqe kullësore, e cila është e pa menaxhuar dhe nuk ka lidhur asnjë kontratë qiraje për dhënie e saj në përdorim për blegtorinë, duke mos sjellë asnjë të ardhur për buxhetin e Bashkisë Dibër, pavarësisht planifikimit si zë në paketën fiskale për vitin 2022, në kundërshtim me nenin 6, pika 3, nenin 7 dhe neni 12, pika 3, të Ligjit Nr. 57/2020 “Për pyjet” dhe sipas Rregullores të Bashkisë Dibër me nr.31 datë 05.02.2020 e ndryshuar me Rregulloren me Nr. nr. 101 datë 21.04.2022, (nenet 116, 117, 118) si dhe VKM nr. 433, datë 8.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive e të pyjeve dhe të kullotave publike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 54-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për menaxhimin e aseteve të veta të kullotave, për të rritur të ardhurat sipas planifikimit në paketën fiskale të vitit 2022, në kapitullin dhe 2.8.2 dhe 2.8.3 “Tarifat dyshme për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullësor publik për ushtrimtarinë” e kontratave.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi mbi saktësinë e paraqitjes së llogarisë nr.423429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, rezultoi se shuma 5,880,928 lekë përfaqëson detyrime të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në auditimin e vitit 2016, në lidhje me ish komunitat dhe punonjësit e administratës. Këto të drejta datojnë prej vitit 2016 dhe nga ana e Bashkisë Dibër nuk janë marrë masa konkrete për arkëtimin dhe vlerësimin e drejtë të tyre siç përcaktohet në pikën b të paragrafit 85, të Standard Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, por vijon të mbartet çdo vit e njëjtë në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 57-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Drejtori Ekonomik i Bashkisë Dibër, në bashkëpunim me strukturat e tjera të saj, të marrin masa për arkëtimin e të drejtave dhe pasi të jenë ezauruar të gjitha përpjekjet për vjeljen e saj, nga Drejtori Ekonomik të vlerësohet gjendja reale të llogarisë nr. 423429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, dhe ta paraqesë saktë shumën në Pasqyrat Financiare.

Deri më datë 31.03.2024

13. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime” rezultoi se:
- Analitiku i kësaj llogarie përbëhet nga 78 Projekte të Bashkisë Dibër me kosto historike në shumën 56,390,670 lekë, nga të cilat 38 projekte nuk kanë të përcaktuar vitin në të cilin janë krijuar, emërtimet në disa raste janë të padetajuara, duke mos mundësuar përcaktimin e saktë të destinacionit apo qëllimit të kryerjes së tyre dhe në një rast emërtimi mungon. Për projektet që kanë të përcaktuar vitin e krijimit rezultoi se i përkasin periudhës 2009-2013 dhe grupi tjetër ka shënimin: “*Të mbartura nga 2016*”. Për këto aktive nuk ka një regjistër kontabël, ku të specifikohen për secilin prej tyre të dhënat si: përshkrimet e studimeve dhe projekteve, vitin e krijimit, shtesat e bëra ndër vite, etj. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 26 dhe 30 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- Në lidhje me këtë llogari, amortizimi vjetor është llogaritur me normën 15%, siç përcaktohet në pikën 36 d, të UMFE nr.8, datë 09.03.20218 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, por norma e amortizimit është llogaritur në grup mbi VKN-në e një viti më parë dhe mungon pasqyra analitike e amortizimit për çdo zë të veçantë, siç kërkohet në pikën 30 të UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- Në lidhje me 78 projektet, pjesë e llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime” mungon një analizë e detajuar e tyre dhe nuk është kryer verifikim për të përcaktuar statusin e tyre nëse janë finalizuar apo jo dhe në rastet e finalizimit, të kryhen procedurat e mbylljes për këto llogari, siç përcaktohen në kapitullin 3.2 të UMFE nr.8/2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 62-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin zë për zë të llogarive analitike të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime”, me qëllim përcaktimin e destinacionit të tyre për të mundësuar statusin e secilit zë dhe më pas nga Drejtori Ekonomik të kryhen regjistrimet kontabël në lidhje me kapitalizimet në aktivet përkatëse apo çregjistrimet sipas rastit.

Deri më datë 31.03.2024

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i bërë për saktësinë e paraqitjes së llogarive të klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)” kanë rezultuar disa pasaktësi, që paraqiten si më poshtë:

Për llogarinë nr.210 “Toka, troje, terrene” rezultoi se:

-Nuk është kryer rivlerësim i tyre, veprim ky në kundërshtim me paragrafin 22 të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe Jomateriale.

Për llogarinë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, rezultoi se:

- Bashkia Dibër nuk ka një regjistër kontabël për “Ndërtesat dhe konstruksiione”, siç përcaktohet në pikën 30 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe për pjesën më të madhe të tyre nuk zotërohet informacion për vitin e njohjes fillestare, shtesat e pakësimit për secilin zë më vete.
- Amortizimi për këtë klasë llogarie bëhet në grup dhe jo për çdo zë më vete, dhe për shtesat e vitit 2022 amortizimi është llogaritur i plotë për 12 muaj, pasi nuk detajohet në mënyrë specifike data e saktë e njohjes së tyre.
- Në listën analitike të llogarisë “Ndërtesa dhe Konstruksiione” tre zëra janë pa emërtim, shuma e të cilave është 4,415,705 lekë. Mos emërtimi i këtyre zërave, dhe mungesa e informacioneve të detajuara sipas formatit të regjistrit kontabël të Aktiveve Afatgjata Materiale nuk mundëson dhënien e një pamje të plotë në lidhje me këtë klasë llogarie dhe e bën të pamundur identifikimin fizik të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 26, 28, 30 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Nga Bashkia Dibër nuk është ndërmarrë asnjë procedurë për rivlerësimin e tyre, për të mundësuar paraqitjen me vlerë reale. Kostot me të cilat këto zëra rezultojnë në listën analitike janë sa kostove fillestare në momentin e njohjes, veprim ky në kundërshtim me paragrafin 22 të SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”.

Për llogarinë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezultoi se:

- Për shtesat e bëra për këtë klasë llogarie gjatë vitit 2022, amortizimi është bërë për vitin e plotë duke mos i'u referuar datës së saktë të njohjes së tyre në kontabilitet.
- Amortizimi mbi këtë klasë llogarie është bërë në grup dhe jo për çdo zë;
- Nuk është mbajtur regjistër kontabël analitik;
- Lista e detajuar me zërat e kësaj llogarie përbëhet nga 418 objekte, nga ku për 47 prej tyre nuk përcaktohet momenti i njohjes fillestare, në një rast mungon emërtimi, por paraqitet shënimi “Pa Analizë”.
- Në listën analitike të llogarisë nr.213 ka gjithashtu dhe 17 zëra, me kosto historike, në total 10,752,249 lekë, të njohura në vitin 2016 si “Shërbime mirëmbajtje”, për të cilat nuk paraqiten detaje nëse plotësojnë kushtet për t'u njohur si AAM më vete apo duheshin konsideruar shpenzime ushtrimore, as shënimet shpjeguese nuk reflektojnë detaje mbi njohjen e tyre. Veprimi i njohjes së tyre si zë më vete duke mos rritur koston e aktivit për të cilin janë bërë ose mosnjohja si shpenzim ushtrimor është në kundërshtim me paragrafin 43 të SKK 5 “AAM”.

Për llogarinë nr.214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”, rezultoi se:

- Lista analitike e kësaj llogarie përmban zëra të cilat nuk duhen kategorizuar si “Instalime teknike, makineri dhe pajisje”, lista përmban elementë si: tavolina, dollapë, pjesë për laboratorët e shkollave, depozita, kompjuterë, etj, të cilat nuk konsiderohen si aktive (makineri, instalime dhe pajisje) afatgjata për të cilat duhet aplikuar norma e amortizimit 5%. Klasifikimi i pasaktë i elementëve të kësaj kategorie ka ndikuar dhe llogaritjen e amortizimit, ku rezulton të jetë përdorur norma e amortizimit e vjetor 5% dhe jo 20%, në kundërshtim me pikën 36, të UMFE nr.8/2018. Si rezultat i aplikimit të pasaktë të normës së amortizimit vjetor, shpenzimet e amortizimit për këtë klasë llogarie janë nënvlerësuar me 12,593,019 lekë, ndërsa vlera kontabël neto e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të datës 31.12.2022 e llogarisë “Instalime teknike”, makineri e pajisje” paraqitet e mbivlerësuar me 12,593,019 lekë;
- Për këtë klasë llogarie nuk ka një regjistër kontabël siç përcaktohet në pikën 30 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku të specifikohet për çdo zë gjendja fillestare shtesat dhe pakësimit;

- Përlllogaritja e amortizimit vjetor për këtë llogari është bërë duke aplikuar normën e pasaktë të amortizimit, në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe jo mbi çdo zë por në grup.

- Nga ana e bashkisë Dibër nuk është kryer ndonjë proces verifikimi fizik mbi zërat e kësaj llogarie për të konfirmuar ekzistencën dhe kushtet e tyre.

Për llogarinë nr.215 “Mjete transporti”, rezultoi se:

- Nga Bashkia Dibër për amortizimin e kësaj llogarie është përdorur norma vjetore e amortizimit 5% dhe jo 20%, në kundërshtim me pikën 36 të UMF nr. 8/2018, si rezultat i mos aplikimit të normës së duhur të amortizimit, shpenzimet e amortizimit vjetor paraqiten të nënvlerësuar me 6,022,902 lekë, ndërsa Vlera Kontabël Neto e llogarisë 215 “Mjete Transporti” në Pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqitet e mbivlerësuar me diferencën e mosllogaritjes saktë të amortizimit;

- Në lidhje me këtë klasë llogarie nga ana e Bashkisë Dibër nuk është ndërmarrë asnjë proces inventarizimi, në listën analitike ka mjete që kanë si vit të njohjes së tyre periudha shumë të hershme, konkretisht për 9 mjete transporti nuk është identifikuar viti i njohjes, 1 mjet rezulton të jete regjistruar 42 vite më parë; 6 mjete mbi 30 vite, 5 mjete mbi 20 vite, ç’ka tregon se nga ana e Bashkisë Dibër nuk janë marrë masa për verifikimin e tyre fizik për të konfirmuar funksionimin e tyre real dhe për të siguruar paraqitjen e saktë të vlerës në pasqyrat financiare.

Për llogarinë nr.218 “Inventar ekonomik”, rezultoi se:

- Norma e përdorur e amortizimit për këtë klasë llogarie është 5% dhe jo 20%, në kundërshtim me pikën 36, të UMFE 8/2018 e për pasojë në pasqyrat financiare të vitit 2022 kemi një nënvlerësim të shpenzimeve të amortizimit dhe mbivlerësim të llogarisë nr. 218 “Inventar Ekonomik”, në shumën 18,590,982 lekë;

-Në lidhje me këtë klasë llogarie nuk ka një regjistër kontabël sipas specifikimeve të bëra në pikën 11 të UMF, dhe amortizimi i llogarisë bëhet në grup duke aplikuar normën e amortizimit mbi VKN e llogarisë sintetike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për të kryer inventarizimin fizik të AAM-ve dhe në rast se është e nevojshme të kryhen procedurat e nxjerrjes nga përdorimit për aktivet e papërdorshme.

Deri më datë 31.03.2024

14.2. Rekomandimi: Drejtori ekonomik i Bashkisë Dibër të marrë masa për krijimin e regjistrave kontabël në lidhje me çdo klasë të AAM-ve dhe të kryejë veprimet kontabël për korrigjimin e regjistrimeve të gabuara në lidhje me amortizimet, sipas SKK-ve në fuqi.

Deri më datë 31.03.2024

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi saktësisë së paraqitjes së llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, rezultoi kjo llogari është paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të datës 31.12.2022 e mbivlerësuar më 735,980 lekë. Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit dhe akt rakordimeve me degën e thesarit mbi shtesat dhe likuidimet, rezulton se ka një diferencë në shumën e paraqitur në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 dhe shumës që rezulton nga pasqyra e lëvizjeve të kësaj llogarie. Drejtoria e Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për xhirimin e fondeve të kontraktori, nëse bashkia nuk ka pretendime për investimin, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8,

datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, Kapitulli II, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50, si dhe në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 70-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Drejtori Ekonomik në Bashkinë Dibër, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar në çdo muaj vlerat e llogarisë 466, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për sistemimin dhe mbylljen e garancive, që u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Deri më datë 31.03.2024

16. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kontratës së qirasë nr.1, datë 14.09.2021, të lidhur midis Bashkisë Dibër përfaqësuar nga ish Kryetari saj z. Sh. M. dhe subjektit E. Gj.” me objekt “Prodhim/vjelje/grumbullim të bimëve medicinale”, rezulton se:

-Nuk ka dokument ligjor të z. E. Gj. që është i regjistruar në QKB.

-Nuk ka të përcaktuar zonën ku do kryej aktivitetin tregtar, sipërfaqja në (ha) nuk përshkruhet në kontratë.

-Nuk ka dokument për magazinat e tregtisë Peshkopi për pasurinë Nr.18/212 zona kadastrale 2932 ish/Magazinat e tregtisë, “prona e kujt është dhe a është e regjistruar në ASHK apo pronë e Bashkisë Dibër” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.4 faqe 79-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa për mos përsëritjen dhe ndërprerjen e praktikave në lidhjen e kontratave me subjekte të cilat nuk plotësojnë kriteret e nevojshme.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e lidhur me datë 21.11.2021 me subjektin “K.” shpk, e cila vazhdon aktivitetin e saj në fushën “HEC-ve”, rezulton se ka mbaruar afati i kontratës 10 vjeçare dhe nuk është njoftuar subjekti për përfundimin e saj sipas kushteve kontraktuale të përshkruara nga të dy palët, ose për rinovimin e saj sipas kërkesave të VKM-së nr.391, datë 2.6.2006 të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010, me pasojë shkelje në drejtim të afateve ligjore të lidhjes së kontratës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.4 faqe 79-82 të Projekt Raportit të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për menaxhimin dhe kontrollin e kontratave të cilave ju ka mbaruar afati i parashikuar në kontratë, të njoftojë kontraktuesit për kushtet e lidhura në kontratë në të kundërt të njoftojë për prishje të saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave për aktivitetin e vitit 2022, në 26 raste janë mbajtur proces verbale të zjarrit në pyje “dëmtim pa autor” në një rast janë evidentuar 250 m linear rrugë e hapur “dëmtim pa autor”, dhe në një rast janë prerë 183 m³ dru zjarri “dëmtim pa autor”. Inspektorët e ruajtjes së pyjeve kanë mbajtur vetëm evidenca të situatës, pa evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës për dëmtimin e pyjeve dhe kullotave, duke mos marrë asnjë masë administrative në kundërshtim me nenin 10 “Dënim administrativ”, neni 46 Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar, neni 50 njoftimi i të tretëve i ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 54-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Bashkia Dibër dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, të marrin masa dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore për ruajtjen, identifikimin e dëmtuesve dhe menaxhimin e kontrollin e pyjeve, duke mos funksionojë vetëm si drejtori evidentuese, por te menaxhojë asetet sipas ligjit të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 19 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 17 raste me fond limit **401,806** mijë lekë pa TVSH, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, 21, 77, si dhe neni 39, 74 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 17 procedurave publike për investimet e realizuara për vitin 2022, rezulton se në 15 raste, procedurat janë kryer pa fonde në dispozicion, ku janë angazhuar për vitin buxhetor më pak se 20% të financimit. Këto veprime, rrisin riskun e rritjes së borxhit të Bashkisë Dibër. Procedurat e prokurimit pa fonde në dispozicion, janë veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të shmangë angazhimet për procedura prokurimi pa fonde në dispozicion, kjo për të shmangur rritjen e borxhit të bashkisë.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, kanë rezultuar në 10 raste vonesa të pa argumentuara të afatit për vlerësimin e ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duke sjell vonesa në lidhjen e kontratës për kryerjen e shërbimit apo punimeve të planifikuara për tu kryer përgjatë vitit 2022. Vonesa për vlerësimin e ofertave, është veprim në kundërshtim me nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, të marrin masa për shmangien dhe mos përsëritjen e vonesave të paargumentuara në fazën e vlerësimit të ofertave, duke eliminuar tejkalimin e afateve ligjore në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 19 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022 – 31.12.2022, me vlerë totale të lidhjes së kontratave prej **297,242 mijë lekë**, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së të gjitha kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

Kualifikimi në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta, është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 “Qëllimi”, neni 3 “Parimet të përgjithshme”, nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 3, ”, Neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, Neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 7 raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në *e-leje*, i kanë miratuar ato në mos përmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin, pasi janë evidentuar mangësi që lidhen me treguesit e distancave ndërmjet ndërtimeve në 1 rast, në 1 rast mungon plani i rilevimit, në 2 raste projekti arkitektonik është i pa plotë, në 1 rast kemi shtesë kati ndërkohë që është trajtuar si ndërtim çatie, në 3 raste mungojnë VNM-të, në 2 raste mungon mendimi i institucioneve, në 1 rast nuk është bërë ndryshimi i statusit të tokës nga arë në truall, në 1 rast mungon harta treguese dhe certifikata për vërtetim pronësie, në 2 raste mungon MNZ, në 1 rast mungon projekti i instalimeve hidrosanitare, elektrike dhe ngrohje ftohjes, në 1 rast mungon deklarata e bashkëpronarit për dhënie dakordësie për zhvillimin e ndërtimit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar Neni 10 pika 1 germa (ç), Neni 10/1 pika 6, Neni 14 pika 1, Neni 15 pika 1 germa (b, e,), pika 1/1 germa (i, iii, iv), Neni 34 pika 2, Neni 37, pika 3 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 125-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkojnë të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për veprimtarinë e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, rezultuan mangësi në lidhje me aktivitetin e kësaj njësie, e cila për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar me staf të pa kualifikuar. IMTV Bashkia Dibër, ka aplikuar në mënyrë të gabuar masën e gjobave të vendosura, nuk ka ekzekutuar vendimet për prishje të ndërtimeve pa leje, nuk disponohej asnjë akt kontrolli për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi, mungon korrespondenca me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo 3 muaj, nuk administrohen dosje për çdo procedurë të nisur, mungojnë planet mujore të punës, mungojnë fotot që evidentojnë konstatimet gjatë inspektimit si dhe nuk është bërë kthimi i gjobave në titull ekzekutiv. Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa (a, b, f) neni 11, 12; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”; VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 41 germa (a) “Të drejta të tjera të

inspektorit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 131-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, kjo jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Të synohet që stafi i kualifikuar të jetë me drejtim inxhinierie.

- IMT Bashkia Dibër, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

- IMT Bashkia Dibër, të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave në përputhje me natyrën e shkeljes. Të merren masa për ekzekutimin e vendimeve për prishje, dhe në rast mungese të mjeteve, Kryetari i Bashkisë të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje. Të përgatiten planet mujore/vjetore të punës nga K/inspektori.

Menjëherë dhe në vijime

B.1. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: 1. Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin A. A., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.

Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit, duhet të jetë 7,038,360 lekë dhe jo 1,510,836 lekë, sa është llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues. Objekti është për leje 5 kat, nga të cilat kati i parë për aktivitet biznesi dhe 4 katet tjera sipas projektit do ndërtohen 20 apartamente.

Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes mbi bazë preventivi dhe taksim 2% dhe 2.5%, në kundërshtim me Ligjin nr. 95/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore””, i ndryshuar, neni 9, pika 2, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes, e cila në paketën fiskale për vitin 2022 është 6% për ambientet për banim dhe 6% për ambientet e dedikuara për biznes.

Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 5,527,524 lekë, e pallogaritur, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Dibër.

2. Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin L. S., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.

Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 98,490 lekë dhe jo 24,020 lekë e llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues.

Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes, duke zgjedhur vlerën më të vogël sipas preventivit, dhe jo vlerën sipas kostos së ndërtimit sipas EKB për m², në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 74,470 lekë, e pallogaritur, e cila përbën të ardhur të paarkëtuar për Bashkinë Dibër.

3. Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin I. S., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.

Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 254,738 lekë dhe jo 176,461 lekë

e llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues.

Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes, duke zgjedhur vlerën më të vogël sipas kostos së ndërtimit sipas EKB për m², dhe jo sipas preventivit i cili ka vlerë më të lartë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 78,277 lekë, e pallogaritur në mënyrë të saktë, e cila përbën të ardhur të munguara për Bashkinë Dibër.

4.Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin M. S., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.

Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 179,989 lekë dhe jo 147,154 lekë e llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues.

Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes, duke zgjedhur vlerën më të vogël sipas kostos së ndërtimit sipas EKB për m², dhe jo sipas preventivit i cili ka vlerë më të lartë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 32,835 lekë, e pallogaritur, e cila përbën të ardhur të munguara për Bashkinë Dibër.

5.Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin V. M., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.

Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit duhet të jetë 103,874 lekë dhe jo 81,592 lekë e llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Dibër sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues.

Në llogaritjen e TNI-së është përdorur metoda e gabuar e llogaritjes, duke zgjedhur vlerën më të vogël sipas preventivit, dhe jo sipas kostos së ndërtimit sipas EKB për m², në kundërshtim me pikën 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej 22,282 lekë, e pallogaritur, e cila përbën të ardhur të munguara për Bashkinë Dibër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 125-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Taksave, të marrin masa për nxjerrjen e njoftim detyrimit ndaj subjekteve zhvillues A. A., L. S., I. S., M. S. dhe V. M., për të bërë të mundur arkëtimin e shumës **5,735,388 lekë** si rezultat i përlllogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga të cilat për shtetasin A. A. vlera **5,527,524 lekë**, për shtetasen L. S. vlera **74,470 lekë**, për shtetasin I. S. vlera **78,277 lekë**, për shtetasen M. S. vlera **32,835 lekë**, për shtetasin V. M. vlera **22,282 lekë**, shuma të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Dibër.

Brenda datës 30.6.2024

2. Gjetje nga auditimi: Lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2022 nuk ka paguar asnjë qytetarë me vlerë totale 2,507,750 lekë dhe nga vitet e mëparshme janë debitorë në vlerë totale 10,090,807 lekë, që përbën në total 12,598,557 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër. Ky veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27. Ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c. Ligjin nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë

30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”. VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë me Drejtorinë e të ardhurave dhe struktura të tjera të bashkisë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 12,598,557 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e Bashkisë Dibër të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit rezultojnë se:

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve është në vlerën 5,235,170 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 11,403,160 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër.

Gjendja e debitorëve e familjarëve është në vlerën 12,743,314 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 47,713,042 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër.

Në total borxhi tatimor në Bashkinë Dibër rezultojnë në vlerë 59,116,202 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezultojnë se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2022, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës subjektet debitorë për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 44-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 47,713,042 lekë;

2. Biznese Debitorë në vlerë 11,403,160 lekë.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Dibër, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Vlera e gjobave nga IMTV për vitin 2022²¹, është 1,230,000 lekë, nga të cilat nuk është paguar vullnetarisht asnjë gjobë. Gjithashtu, nuk janë ndërmarrë masa nga si nga Drejtoria e IMTV për të njoftuar drejtoritë përkatëse që këto gjoba të kontabilizohen, ashtu dhe nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria Ekonomike nuk ka marrë masa për tu kontabilizuar këto gjobat. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5 dhe Ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22 dhe VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kapitulli 1 , pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **1,230,000 lekë për vitin 2022**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Brenda datës 30.6.2024

5. Gjetje nga auditimi: Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse, rezultojnë 17 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 18 pika karburanti), nga të cilat 14 pika kanë licenca me afat më të shkurtër se 5 vjet dhe me pagesa pjesore dhe 4 pika kanë licenca 5-vjeçare, 8 subjekte për 9 pika karburanti janë të autorizuar, për vitin 2022 dhe kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore, ndërsa për 9 subjekte janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale progresive 7,200,000 lekë (sipas tabelës II.6.8) e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dibër dhe 3,750,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dibër për vitin 2022. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, Neni 20-Autorizimet pika 2 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Dibër me vlerë **7,200,000 lekë**²².

Brenda datës 30.6.2024

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dibër nuk ka ndjekur procedurat ligjore për 4 subjekte të

²¹ Nga Bashkia nuk ka të dhëna të tjera për gjobat e vendosura nga IMTV në vitet e mëparshme.

²² Lista e subjekteve dhe detyrimet përkatëse, e detajuar në tabelën nr. II.6.8, faqe 50 Raportit Përfundimtar të Auditimit

konstatuara në auditimin e vitit të mëparshëm, nuk ka depozituar asnjë padi civile për personat përgjegjës të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratat për dhënie me qira të fondit pyjor - kullësor, me qëllim likuidimin e detyrimit në vlerën totale **8,494,504 lekë**, për subjektet:

- Subjekti "A." ShPK & "B." ShPK, për vlerën 3,074,174 lekë;
- Subjekti "H. L." ShPK, për vlerën 2,386,410 lekë;
- Subjekti "H. S." ShPK për vlerën 2,945,495 lekë;
- Subjekti "L. E." ShPK, për vlerën 88,425 lekë;

Në kundërshtim me VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" pika 2 lidhja 11 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.4, faqe 79-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore deri në procese gjyqësore për të likuiduar detyrimin e pa likuiduar të prapambetur prej dy vitesh në vlerën **8,494,504 lekë**.

Brenda datës 30.6.2024

B.2. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik me objekt "*Rehabilitimi dhe shtrimi me Asfaltbeton i lagjes Kallavere Peshkopi, Bashkia Dibër 2022*", "*Rikonstruktion shkolla 9 – vjeçare "Irfan Hajrullai" Peshkopi, Bashkia Dibër 2022*" dhe "*Sistemim asfaltim i rrugës së Lagjes Llixha, Bashkia Dibër 2022*", ka rezultuar se KVO ka kualifikuar OE fitues më të cilët është lidhur kontrata në mos përmbushje të kriterëve kualifikuesë, ndërkohë ka s'kualifikuar OE me oferta më ulëta ose më të favorshme për arsye të cilat nuk qëndrojnë ose për devijime të vogla të cilat në thelb nuk cenojnë zbatimin e punimeve. Nga vendimmarrjet e gabuara të KVO, AK Bashkia Dibër, ka kryer shpenzime pa ekonomikitet në vlerën **8,291 mijë lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2 "*Qëllimi*", neni 3 "*Parimet të përgjithshme*", nenin 87 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" pika 3, ", Neni 92, "*Shqyrtimi i ofertave*".

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë vlerësimet e gabuara të kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për personat përgjegjës për shpenzimet pa ekonomikitet në vlerën **8,291 mijë lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore rezulton se, mos likuidim i vendimeve gjyqësore sipas radhës së paraqitjes së tyre, rezulton se:

1. Vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore të prapambetura nga dokumentet analitike të bashkisë rezulton në vlerën 101,618,041 lekë janë paguar detyrime në vlerën **71,354,999 lekë dhe për vitin 2022 rezultojnë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore në vlerë 30,263,042 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore" neni 40, pika 3;
2. Bashkia Dibër në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në

llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike të hartojë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojë me rigorozitet radhën e regjistrimit të tyre në bashki kur të kryejë likuidimet e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE.

C.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Në mbështetje të shkronjës (c) – Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Dibër, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

a- Masa disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për:

1. z. M. Sh., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

2. z. A. C., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik, ku në **16 raste** vlerësimi i dokumentacionit të OE fitues është bërë në kundërshtim me kërkesat e vendosura në DST, si dhe mangësitë e konstatuara në afatet për kryerjen e vlerësimit për procedurat nën kufirin e lartë monetar ku në **10 raste** vlerësimi është kryer përtej afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2019 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 82-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3. z. E. M., në cilësinë e Drejtorit të Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit;

Për mangësitë e konstatuara në miratimin e lejeve të ndërtimit, ku në 7 raste, lejet e miratuara kanë mangësi që bien në kundërshtim me rregulloren e zhvillimit të territorit, sipas VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, dhe në 5 raste për përlogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën **5,735,388 lekë;** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 125-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

b- Masa disiplinore “Vërejtje” për:

4. z. R. K., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik, ku në **2 raste** vlerësimi i dokumentacionit të OE fitues është bërë në kundërshtim me kërkesat e vendosura në DST

5. z. E. Sh., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe kontrolluesit në procesin e miratimit të lejeve;

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik, ku në **3 raste** vlerësimi i dokumentacionit të OE fitues është bërë në kundërshtim me kërkesat e vendosura në DST, dhe për mangësitë e konstatuara në miratimin e lejeve të ndërtimit, ku në 7 raste, lejet e miratuara kanë mangësi që bien në kundërshtim me rregulloren e zhvillimit të territorit, sipas VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar dhe në 5 raste për përlogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë për

vlerën 5,735,388 lekë;

6. z. F. Z., në cilësinë specialistit të fushës pjesë e Njësisë së Prokurimit;

Për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku në 15 raste, kriteret janë jo në përputhje me natyrën e kontratës;

7. z. M. D., në cilësinë specialistit të fushës pjesë e Njësisë së Prokurimit;

Për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku në 3 raste, kriteret janë jo në përputhje me natyrën e kontratës; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 82-124 dhe pikën 2.5 faqe 125-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8. z. L. T., në cilësinë e ish – Kryeinspektorit të IMTV;

Për mangësitë e konstatuara përgjatë ushtrimit të detyrave të inspektimit dhe mbrojtjes së territorit që lidhen me mos mbajtjen e akteve të kontrollit për punimet me leje, aplikimi i gabuar i masës së gjobës për ndërtimet pa leje, mos ekzekutimi i vendimeve për prishje të ndëtimeve pa leje dhe mos marrja e masave për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 131-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

C.2. Për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kodin e Punës:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” shkronja (c), në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, neni 37 “Masat Disiplinore” dhe në kontratën individuale të punës, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Dibër, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallen e përgjegjësisë dhe të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit si më poshtë:

c- Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për:

9. z. R. D., me Detyrë Nën Kryetar i Bashkisë Dibër, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave;

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik, ku në **16 raste** vlerësimi i dokumentacionit të OE fitues është bërë në kundërshtim me kërkesat e vendosura në DST, si dhe mangësitë e konstatuara në afatet për kryerjen e vlerësimit për procedurat nën kufirin e lartë monetar ku në **10 raste** vlerësimi është kryer përtej afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2019 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;

d- Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

10. z. Q. S., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave;

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik, ku në **3 raste** vlerësimi i dokumentacionit të OE fitues është bërë në kundërshtim me kërkesat e vendosura në DST. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 82-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Dibër, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a.Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

b.Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e

ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLI I LARTË I SHTETIT